



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-8774 dt. 16.02.2023

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **23.02.2023** (e Enjte) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Znj Manushaqe Mulaku, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal Drenas, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës" duke zëvendësuar znj. Agnesë Kastrati-Bucolli e cila lirohet prej detyrës të anëtares së Kuvendit Komunal.
2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 25.01.2022.
3. Propozim vendim për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027.
4. Propozim vendim për miratimin e Projekt Rregullores nr.01/2023 për Menaxhimin e mbeturinave për Komunën e Glllogocit.
5. Raporti i Punës Janar-Dhjetor 2022 i Kryetarit të Komunës.
6. Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027.
7. Propozim vendim për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc.
8. Propozim vendim për vënien në diskutim publik e rregullores për Bonuset e Zonimit.
9. Plani i punës për vitin 2023, i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB)
10. Të ndryshme.

Drenas, 16.02.2022



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

KOMUNA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Januar		16.02.2023	
Nj. Org	Nr. Nën	Shprehja	Vlera
02	060/01	8774	



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 16.02.2023, si vijon:

-Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K. P. F-ca, për rendin e ditës kemi me një pikë shtesë, ku i pyeti të pranishmit nëse ka dikush debat rreth pikave të rendit të ditës mundet me marr fjalën, diskutime nuk pati, hedhi në votim rendin e ditës.

- Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

1. Znj Manushaqe Mulaku, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal Drenas, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës" duke zëvendësuar znj. Agnesë Kastrati-Bucolli e cila lirohet prej detyrës të anëtares së Kuvendit Komunal.

- Rekomandohet për Kuvend

2. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 18.01.2023.

- Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

3. Propozim vendim për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027.

- Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

4. Propozim vendim për miratimin e Projekt Rregullores nr.01/2023 për Menaxhimin e mbeturinave për Komunën e Glllogocit.

- Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

5. Raporti i Punës Janar-Dhjetor 2022 i Kryetarit të Komunës.

- Rekomandohet për Kuvend

6. Plani i Veprimt për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027.

- Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

7. Propozim vendim për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc.

- Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

8. Propozim vendim për vënien në diskutim publik e rregullores për Bonuset e Zonimit.

- Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

9. Plani i punës për vitin 2023,i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB)


Rekomandohet për Kuvend

10. Të ndryshme.

Pasi nuk pati diskutime mbledhja përfundoi në ora 8: 45.



Kryesuesi i Kuvendit
Milaim Hajdari



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 (pika c), të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 08.02.2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Znj.Manushaqe Mulaku**, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Glllogovc, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj.Agnesë Kastrati Bucolli.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj.Manushaqe Mulaku dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 06.02.2023, Nr.09-1-121-2023, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit Komunal znj. Agnesë Kastrati Bucolli, për arsye të zgjedhjes në pozitën Drejtoresh e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja në listën e rëndësimit është znj.Manushaqe Mulaku.


Kandidatja e radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë, me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 08.02.2023

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radonjic





REPUBLIKA E KOSOVES

KOMUNA E DRENASIT

Kuvendi i Komunës



Nr. _____ Dt _____ 2023

Bazuar në nenin 35.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet ta nënshkruajnë betimin solemn si në vijim.

Unë, _____, "betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej, me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Drenasit (Glogoc), në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë".

Vendi: _____

Datë: _____

Emri dhe Mbiemri i Anëtarit të Kuvendit të Komunës së Drenasit _____

Nënshkrimi



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-8775 dt. 16.02.2023

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **25.01.2023**

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 31 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Agnesë Kastrati (PDK), Albulena Saliuku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK), Valentina Leku (PDK), Sali Dvorani (DD), Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK).

Kuvendi filloi punimet më këtë :

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 24.11.2022,dhe procesverbali i mbledhjes së Jashtëzakonshme i dt.28.12.2022.
2. Draft Propozim i Planit të Veprimit për vitin 2023-2024 të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024 me ndryshim-plotësimin.
3. Propozim Vendim për miratimin e Simbolit Përkujtimor të Gjenocidit në Kosovë.
4. Raporti i përformancës të Komunës së Drenasit për vitin 2021.
5. Raporti vjetor i Komitetit për Komunitete dhe Kthim.
6. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizua për vitin 2022.
7. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për për Arsim Kulturë Rini dhe Sport për vitin 2022.
8. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2022.
9. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Komiteti për Barazi Gjinore për vitin 2022.
10. Raporti financiar Janar Dhjetor 2022.
11. Të ndryshme.

Të mekurën me dt. 25.01.2023 është mbajtur mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit, ku për diskutim ishin 11 pika për rend dite.

Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, ndërsa merrnin pjesë, kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale, anëtarët e Kuvendit, zyra e informimit.

Më poshtë ju elaborojmë pikat që janë diskutuar e miratuar me shumicë votash në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hadari- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi me rendin e ditës anëtarët e Kuvendit Komunal.

Arbër Halilaj, Ndryshimet klimatike tanimë evidente edhe tek ne, veprimet e dëmshme të faktorit njeri, si dhe problemet e ndryshme të planifikimit urbanistik, po na e shkaktojnë problemin e përmbytjeve pas reshjeve ekstreme, që i patëm këto ditë. Vërshimet e fundit, sidomos në komunën e Skënderajit, Mitrovicës, në disa pjesë tek ne në Drenas, Istog etj. e dëshmojnë këtë fakt, ku vetëm në Skënderaj dëmet e përafërta mbërrijnë në 10 milion euro. Thuajse një përrua shkaktoi tërë këtë shkatërrim në komunën fqinje, po ku jemi ne si Drenas me lumin që ka prurje dhe potencial edhe më të madh shkatërrues në kohë vërshimesh? Pavarësisht që përmbytjet zakonisht nuk mund të parandalohen, ka disa aktivitete që mund të ndërmerren, e të cilat do të zvogëlonin pasojat e kësaj fatkeqësie natyrore.

Ne si I.Q. “GREEN për Drenas” kemi qenë në vendin e ngjarjes në Skenderaj dhe me shqetësim të madh kemi diskutuar për nevojën që të propozojmë përpilimin e një Strategjie apo Plani Emergjent të veçantë për parandalimin dhe zvogëlimin e rreziqeve nga vërshimet në Komunën e Drenasit. Kurrë nuk është vonë, sepse këto situata do të na përsëriten, prandaj ky plan do të detajlohej edhe me involvimin e ekspertëve të fushave përkatëse.

Sot para jush dua të theksoj me bindje të plotë se përveç reagimeve individuale me njerëz dhe mjete apo makineri private, kapacitetet njerëzore dhe teknike si dhe gatishmëria reaguese në nivel lokal dhe të vendit dëshmonin për mungesë të një sistemi efikas të parandalimit dhe reagimin ndaj fatkeqësisë natyrore të vërshimeve.

Prandaj, si asamblist nga “GREEN për Drenas” kërkoj që për shkak të rëndësisë jetike dhe situatës emergjente që ka mundësi reale të na përsëritet, ta fusim si pikë shtesë të rendit të ditës “Përpilimi i Planit Emergjent Lokal për parandalimin dhe zbutjen e pasojave të vërshimeve”, bashkë me themelimin e një grupi punues për këtë qëllim.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, e falënderoj për propozimin që është adekuat, por mendoj se nuk është për këtë seancë, sepse duhet një përgatitje më e madhe, kërkoj që kjo pikë me hy si pikë e rregullt të rendit të ditës, por kërkoj që me hy në mbledhjen e shkurtit.

Arbër Halilaj, përveç propozimit i keni edhe disa pika shtesë në bazë të cilave kishim punuar në një plan të tillë, e rëndësishme është ta fusim në rend dite si diçka që ka të bëjë me jetën dhe pasurinë e qytetareve nëse nuk ka rendësi mundeni edhe ne seancën e shkurtit mirëpo është

prioritet të punohet në këtë drejtim, dhe do të jemi të përgatitur për pasojat e mundshme të fatkeqësive natyrore.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua rendi i ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 24.11.2022, dhe procesverbali i mbledhjes së Jashtëzakonshme i dt.28.12.2022.**

Labinot Halilaj, kërkoj që me i hedh në votim veç e veç procesverbalet, sepse ne nuk kemi qenë në mbledhje të jashtëzakonshme dhe nuk e votojmë një procesverbal që nuk kemi marrë pjese në seancë.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 24.11.2022.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së Jashtëzakonshme i dt.28.12.2022.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 23 anëtar, 7 vota kundër, abstenim nuk pati, u miratua procesverbali i mbledhjes së Jashtëzakonshme i dt.28.12.2022.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Draft Propozim i Planit të Veprimtë për vitin 2023-2024 të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024 me ndryshim-plotësimin.**

Labinot Halilaj, kërkoj që mos ta votoni këtë pikë të rendit të ditës për arsye se nuk ka drejtor drejtorja.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, akti i komunës duhet të votohet është në dorën e tuaj për me votu edhe kjo është në dorën tuaj nëse nuk votohet e dëmton procesin në grand të performances.

Mërgim Pirraku, konsideroj se kjo pikë e rendit të ditës duhet me u votu dhe i ftoj të gjithë për me e votu këtë pikë të rendit të ditës, unë do të votoj për.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 23 anëtar, 5 vota kundër, 1.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim Vendim për miratimin e Simbolit Përkujtimor të Gjenocidit në Kosovë.**

Egzona Tërdevci, a është kompetencë që na takon ne si nivel lokal a është më shumë kompetencë e nivelit qendror, nuk kam asgjë kundër vetëm se me duket se i është kompetence e nivelit qendër.

Beqir Kiqina, sa i përveç këtij propozim vendimi le të behet simbol unik i përkujtimit të gjenocidit në Kosovë në parim nuk jemi kundër, pajtohem me kolegen nga VV për arsye se duhet me shiku në aspektin ligjor.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, nuk na ndalon askush me miratu një vendim të tillë, nuk po bëjmë as një shkelje ligjore, është një ide e mirë.

Albulena Saliuku, derisa ka ardh edhe si kërkesë, duhet të votohet ky propozim vendim sa do që ndoshta i takon nivelit qendror pse mos ta bëjmë edhe në nivel lokal.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Raporti i performancës të Komunës së Drenasit për vitin 2021.**

Egzona Tërdevci, kur e kemi pranuar këtë raport se me duket pak e vonë me diskutua në vitin 2023 Raporti i performancës të Komunës së Drenasit për vitin 2021, në raport të ministrisë e pash që e kanë dorezu në vitin 2022 por nuk pash datë. Unë i kam disa tregues që qëndrojnë pak më keq, është treguesi për infrastrukturën rrugore ku jemi rendit si komunë e 14-të e 56.38 pikë vlerësimi, është treguesi për ujin e pijes ku e kemi ngrit si shqetësim vazhdimisht ku jemi rendit në vendin e 13-të nga komunat, është treguesi për kanalizim ku jemi renditur në vendin e 8-të nga komunat pjesëmarrës për grand të performances si dhe është, si dhe është menaxhimi një shqetësim që e kemi ngrit disa herë si shqetësim brenda kuvendit komunal, kërkoj një sqarim se ku kemi qalu në këto pika si dhe a kanë me qenë të njëjtit tregues ku kemi me qëndrua keq edhe për vitin 2022.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, kjo pikë e rendit të ditës ka qenë në mbledhjen të cilën e kemi përfunduar para kohe në të cilën nuk merrnin pjesë asamblistët në mbledhje prandaj kjo ka pas në muajin 11 me u diskutua por do të diskutohet tani, ne sigurisht qalojme dhe si rezultat i këtyre pikave nuk i kemi 90 pikë sa janë gjithsej por i marrim kësaj radhe i kemi 68 dhe jemi në vendin e parë për vitin 2021.

Meqë nuk pati diskutime, tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, dhe u miratua në mënyrë unanime kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Raporti vjetor i Komitetit për Komunitete dhe Kthim.**

Mehedin Salihu, kur jemi tek performanca e falënderoj punëtorët e QKMF-së të cilën e kanë zënë vendin e katërt, i falënderoj për punën dhe aktivitetet.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizua për vitin 2022.**

Ariana Isufi- përfaqësuese e i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2022, prezantoi raportin vjetor të punës për vitin 2022.

Florentina Elezi-Veliu, njëra nga prioritetet për vitin 2022 që e keni cek ju ka qenë bashkëpunimi me OJQ që përfaqësojnë personave me aftësi të kufizuara, a mundesh me tregu me cilat OJQ në Drenas keni pas bashkëpunim, dhe rezultatet e bashkëpunimit që kanë qenë? Tjetra që e ceke njëra prej prioriteteve ka qenë edhe bashkëpunimi me ordianca private për disa shërbime, për fizioterapi dhe Dentist, sipas informacioneve ofrohen këto shërbime në QKMF që janë falas, pse ka qenë e nevojshme të behën në ordianca private apo nuk ka pas kapacitet në QMF, meqë u realizu kjo objektivi sa fëmijë kanë marrë trajtime në fizioterapi dhe sa në klinika dentare? Gjithashtu tjetra që e ceke bashkëpunimi me zyrën e pensioneve për të identifikuar numrin e personave mbi moshën 18 vjeçare e ceke që nga 36 numri ka rënë në 32 a ka ndonjë arsye a keni marrë ndonjë evidencë?

Ariana Isufi- sa i përket bashkëpunimi me OJQ-të në Drenas, kemi bashkëpunuar me organizatën e HANDIKOS i keni edhe fotot e bashkangjitura të takimeve, edhe sa i përket shërbimeve dentare që kemi bashkëpunuar me ordiancat stomatologjike që kane ofruar shërbime falas ne kemi bashkëpunuar po me të njëjtën organizatë, dhe prej HANDIKOS-it kemi evidentuar më shumë se 50 persona të cilat kanë nevojë për shërbime dentare, këta nuk janë se nuk i kanë provuar me i marrë këto shërbime në shtëpinë e shëndetit në Drenas mirëpo ne dina që shërbimet në QKMF në Drenas janë sfiduese dhe mungesa e materialit dhe mungesa tjera i pamundësojnë marrjen e shërbimeve për këtë arsye e kemi pas si nevojë më bashkëpunua me punua me disa ordianca të cilat vullnetarisht ofrojnë këto shërbime falas për këta persona dhe që është në të mirën e personave me aftësi të kufizuara, ndërsa sa i përket shërbimeve fizioterapeutike janë 7 shërbime te cilat i kanë ofruar shërbime falas dhe është aktivitet të cilën planifikojmë. Sa i përket kërkesave të pensioneve rënia e numrit të kërkesave kjo nuk do të thotë që çdo vit me qenë numri i njëjtë mund me pas ndryshime.

Mehedin Salihu, pajtohem me kolegën paraprake se nuk ka pas nevojë për ordianca private për shërbime dentare sepse ka kapacitet QKMF-ja. A ka bisedua me menaxhmentin apo a ka bërë kërkesë për një gjë të tillë apo ju ka ardh më lehtë me shku në ordianca private se sa me ndjek rrugën e kërkesave.

Ariana Isufi- lidhjen me pyetjen e juaj ne nuk kemi bërë kërkesë por vet pacientet kanë kërkuar më i marr këto shërbime, rezultati ka qenë se ka kohë pas kohe mungesë të materialit për marrjen e shërbimeve dentare në QKMF dhe si rezultat i kësaj ne kemi menduar një procedurë tjetër që mundemi me ju ndihmuar përmes ordiancave stomatologjike private të cilët kanë zgjedh me bashkëpunu me neve dhe jemi falënderues.

Mehedin Salihu, sa janë të integruar në institucione personat me aftësi të kufizuara?

Ariana Isufi- shifrat i kemi ne dhe ato mbeten kofidenciale dhe as initiale dhe as shifra tjera nuk japim.

Filloreta Bujupi, ju e ceket që nuk keni bërë në bashkëpunim me HANDIKOS-in përmes marrëveshjen për me i dergu fëmijët për fizioterapi sa ka qenë e favorshme për atë fëmijë që i keni bërë fizioterapi nëpër ordianca private ndërsa HANDIKOS nuk ka qenë i njoftuar, a ka mundësi që ai fëmijë i ka bërë në të njëjtën ditë dy fizioterapi dhe sa ka qenë e dëmshme për atë fëmijë?

Ariana Isufi- sa i përket shërbimeve fizioterapeutike kanë qenë fëmijë që janë identifikuar edhe prej HANDIKOS-it mirëpo edhe nga asistentet e mësuesve mbështetës të shkollave të cilët kanë pas një raport mjekësor dhe i cili ka deshmu se ai fëmijë ka nevojë. Sa i përket shërbimeve se a ka marr shërbime në HANDIKOS dhe në një ordinancë private, ne e dina që HANDIKOS pavarësisht që ofron shërbime shumë shërbime tjera përbrenda objektit nuk i ka të gjitha pajisjet e duhura, mirëpo në momentin kur ai fëmijë i ka marr shërbimet fizioterapeutike në HANDIKOS dhe ju kanë dashur shërbime tjera për me i përmbush nevojat të cilat kanë qenë të shkruara në raportin mjekësor kjo mundet me qenë vetëm plus për atë fëmijë sepse në të kundërtën ish dasht me i marr dikun privat dhe me i pagu.

Filloreta Bujupi, HANDIKOS e ka protokollin që me punu me këta fëmijë dhe nëse ai fëmijë ka mundur me i kry fizioterapitë në HANDIKOS, ju e ceket që nuk ka mundur mirëpo ne kemi informata se ka mujt me i kry këto shërbime mirëpo ka shku në ordianca private ju që i keni udhëzuar pavarësisht kush i ka udhëzu, unë mendoj se nuk ka qenë e favorshme për ata kjo fizioterapi.

Ariana Isufi- unë mendoj se jeni keq informuar sepse ne këto shërbime i kemi ofruar në bashkëpunim me HANDIKOS dhe organizata tjera.

Filloreta Bujupi, a keni ndonjë dëshmi?

Ariana Isufi- secilin aktivitet që e realizojmë e kemi edhe një email e kemi një kërkesë tonën dhe e kemi listën që na dërgon HANDIKOS.

Florentina Elezi-Veliu, në raportin që e keni sjellë nuk keni askund fotografi që keni me HANDIKOS-in.

Ariana Isufi- po i keni edhe fotografitë e bashkangjitura të cilat kemi pas takime edhe me HANDIKOS-in

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: 7. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për për Arsim Kulturë Rini dhe Sport për vitin 2022.

Zyrafete Morina, përfaqësuese e Komitetit Konsultativ për Arsim Kulturë Rini dhe Sport për vitin 2022. Prezantoi raportin vjetor të punës për vitin 2022.

Egzona Tërdevci, njëra nder mbledhjet që keni mbajtur e dt. 23.11.2022 është dhënë një rekomandim që Komuna e Drenasit të mundësoj qasje në objektin e qendrës rinore të gjitha OJQ-ve që funksionojnë në komunën tonë e që në fokus e kanë rininë, besoj që jeni të informuar që Drenasi nuk ka qendër rinore, nuk po e kuptoj këtë rekomandim kur Drenasi nuk ka qendër të rinisë.

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka, kërkesat e re rinjëve ka qenë që me pas mundësi me i zhvillua aktivitetet dhe të gjitha ju kanë referuar qendrës të rinisë aty ku është vendos akademia “Flutura”, ky komitet kane kërkuar që me pas një hapësirë të dedikuar por me kërkesë paraprake, akademia “Flutura” ka qenë e gatshme çdo here me ju dhënë mundësi edhe organizatave tjera që me zhvillua ndonjë aktivitet por me koordinim paraprak për shkak që është edhe hapësira e nuk është e madhe në qendër.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2022.**

Fitore Sefiu, përfaqësuese e Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2022, prezantoi raportin e punës të vitit 2022 të këtij komiteti.

Florentina Elezi-Veliu –përshëndetje e nderuar, po me vjen keq me duhet me te kritikuar – Raporti tepër i dobët duke e pasur parasysh një pune e tepër te gjere kemi mujt me be shume ma shume janë tema tepër te gjera për me u kap, shpresoj qe herën tjetër te vini ma te përgatitur.

Fitore Sejdiu -për gabime teknike e kam vërejtur me vone masi e kame dorëzuar, mirëpo për i dobëte e di qe puna sivjet nuk ka qene sikur viteve tjera te këtij Komiteti se ju keni qene dëshmitar edhe ne raportimet e viteve të kalume ,besoj qe herëve tjera kemi me qene ma te përgatitur ,Ju Faleminderit

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Komiteti për Barazi Gjinore për vitin 2022.**

Arton Hasani, përfaqësues i Komitetit Konsultativ për Komiteti për Barazi Gjinore për vitin 2022, prezantoi raportin e punës të vitit 2022 të këtij komiteti.

Filloreta Bujupi, rekomandimet e juaja qe i keni dhanë sa janë realizuar ?

Arton Hasani-ndoshta ju kanë dukur jo te mira ose ka pasur diçka me te mire për me realizu.

Egzona Tërdeci, A kemi marr një email adrese se ai kane pëlqy qeto rekomandime për me i realizua?

Arton Hasani- pjesërisht kemi marr përgjigje mirëpo jo te gjithë.

Egzona Tërdevci-Faleminderit për raportimin tu kisha lut herëve tjera me qenë me serioz dimensionet si dhuna në familje, divorcet janë tema tepër të ndjeshme dhe prej kuvendit komunal nuk guxojmë me leshu nivelin ne diskutime sepse japin dhe shembull të keq të shoqëria nuk përçojmë mesash të mire të qytetaret, për herëve të tjera me mbajte në nivel pak ma serioz .

Arton Hasani-faleminderit shumë ne jemi mundu me jep ma te mirën nga ana jonë po kështu doli.

Arbër Halilaj, unë vetëm deshta të jap një sugjerim që të objektivat ose të strategjia e këtij komiteti të jetë ta zëmë krijimi i lehtësirave fiskale për grat dhe vajzat e reja që dëshirojnë të fillojnë biznes ose start UP sepse jo vetëm, të ky komitet po qellim strategjik i Komunës do të jetë sigurimi i mundësive buxhetore dhe i ndihmëse që grat, vajzat e reja të fuqizohen ekonomikisht dhe të pavarësohen, ndërsa secili komitet ka mundësi që të konsultohet edhe me ekspert ose me intelektual në shoqërinë civile që të merr praktika ose ide më të mira gjatë aktivitetit të tyre.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës. **10. Raporti financiar Janar Dhjetor 2022.**

Shyqiri Bublaku- Drejtori i Financave, kisha me i njoftu anëtarët e kuvendit se ku është bërë një ndryshim me të hyrat e Kuvendi Komunal për shkak të pranimit të raporti të fundit të gjobave të Komunikacionit dhe gjobave të gjykatave për 3 mujorin e fundit.

Egzona Terdevci, tek të hyrat nga qiraja ka pas rritje të theksume prej vitit 2021 nëse mundemi me ditë çka e ka shkaktë këtë ngritje të hyrave, të hyrat nga inspeksioni ka rënie nga viti 2021 nëse ka mundësi me ditë pse ka ndodh kjo? Të taksa në firma është një rritje shumë e madhe por e kuptoj që është për shkak që është fal gjatë kohës së pandemisë kërkoj një sqarim, si dhe këtë shfrytëzimi i pronës komunale ka rënie të të hyrave nga viti 2021 a ka ma pak prona që janë në shfrytëzim 2022 apo cila është arsyeja, apo ndoshta nuk janë tu i pagu obligimet të cilat i kanë ndaj Komunës, si të tek të hyrat nga donacionet nëse nuk i keni të gjithë emrat, por prej kujt kanë ardh këto donacione?

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës. **11. Të ndryshme.**

Egzona Terdevci, i kam disa shqetësime të banoreve që po i marrim vazhdimisht lidhur me gropat në rrugë e sidomos tani që i kanë heq pengesat dhe nuk ekziston kufizimi i shpejtësisë po i vërej me shumë gropat që janë gjatë rrugëve në Baicë dhe Tërdec, pres përgjigje në seancën e radhës nga Drejtori.

Shyqyri Bublaku- Drejtori i Financave, sa i përket qerasë ka pas rritje se janë dhënë disa prona që janë marr vendimet këtu në kuvend dhe ata i kanë bërë pagesat të qerasë të cilat i kane marr, të inspeksioni ka një rënie një muaj dite kemi qene në proteste d.m.th. nuk është punuar kjo ka ndiku jo vetëm në këtë sektorë kemi pas rënie të hyrave vetanake, sa i përket taksave komunale kemi një rritje në krahasim me vitin e kaluar ky është rezultat që kane fillu me i pagu edhe borgjet e vjetra dhe ato kanë ndikuar, sa i përket shfrytëzimit të pronave komunale kjo pjesë është të parku i biznesit kemi land me përmbarues dh presim që shuma prej 300

Filloreta Bujupi, kërkoj që me vendos një vendkalim të këmbësoreve në këtë rrugën që është ndërtuar me katër korsi, derisa është parkingu i automjeteve ndërsa vendkalim të këmbësoreve nuk ka është rrezik jeta e qytetareve që po e kalojnë rrugën.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, në momentin që behet përfundimi i asaj ruge besoj se do të behet edhe shenhezimi i rrugës, dhe do ta përcjellim tek drejtoria këtë kërkesë?

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 12:55 min.

Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 25.01.2023 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-it dhe në kanalën YouTube.

Procesmbajtëse: Liridona Fejza-Ajazi

Erlona Gashi

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Milaim Hajdari



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E GLLOGOCIT
ZYRA E KRYETARIT



Nr: 01.400-5580

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d i Ligjit nr 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", dhe nenit 10 paragrafi 2 dhe 5 i Ligjit 04/L-060 për Mbeturina dhe nenin 72, paragrafi nën (h) i Statutit të komunës nr.01-110-6904, Kuvendi i Komunës së Glogocit, në mbledhjen e mbajtur më _____, miraton këtë:

PROPOZIM VENDIM


Për Miratimin Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027

- I. Me këtë Propozim Vendim bëhet miratimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për komunën e Glogocit për vitet 2023-2027;
- II. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Drejtoria e Inspeksionit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës , konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja dhe publikimit në ueb-faqen e Komunës

Kryetari
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Draft Plani Komunal për Menaxhimit të Mbeturinave (PKMM) i Komunës së Gllogocit është dokument i hartuar në bazë të Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave të Republikës së Kosovës dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbeturinave në Republikën e Kosovës, dhe i cili ka kaluar në procedurat e konsultimit publik ashtu siç janë të parapara me ligj, atëherë kërkojmë nga kuvendi i komunës që të bëjë miratimin e këtij plani pesë vjeçar për Menaxhimin e Mbeturinave për Komunën e Gllogocit, që është edhe prioritet edhe nga Agjenda e përmbushjes së obligimeve komunale për integritet Evropian.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Hartimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave



Komuna Glogocit
Opština Glogoc
Municipality of Glogoc

PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

2023-2027

KOMUNA E GLLOGOCIT

1	<i>Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave</i>	7
1.1	Qëllimi dhe fushëveprimi i planit	7
1.2	Baza ligjore dhe institucionale për rishikimin e planit	8
1.3	Konteksti lokal	14
	BANIMI NË TERITORIN URBAN DHE RURAL	19
	SIPËRFAQET ME NDOTJE TË LARTË (HOT SPOTET)	26
	SHKALLA E PAPUNËSISË	27
	SHKALLA E PUNËSIMIT	28
	NIVELI I VARFËRISË	29
	AMBIENTI I BIZNESIT	30
1.4	Bujqësia	32
1.5	Turizmi lokal	33
1.6	Arsimi	34
1.7	Shëndetësia	36
2	<i>Gjendja ekzistuese e menaxhimit të mbeturinave</i>	39
2.1	Të dhënat për mbeturina në Komunë	39
2.2	Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave	39
2.3	Rishikimi i implementimit të planit	42
2.4	Performanca e shërbimit	47
2.5	Performanca financiare e MM	48
2.6	Infrastruktura për ndarje, riciklim dhe deponim të mbeturinave	49
2.7	Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave	51
3	<i>Objektivat e MM dhe plani operacional</i>	53
3.1	Vizioni i MM	53
3.2	Objektivat dhe caqet e MM	53
4	<i>Plani i MM në kushte emergjente</i>	69
5	<i>Plani i veprimit dhe i monitorimit</i>	70

Lista e shkurtesave:

AMMK	Agjencioni i Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës;
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës;
BE	Bashkimi Evropian;
BMZ	Ministria federale gjermane për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik ;
CEDE	Qendra për Edukim dhe Zhvillim të Mjedisit;
DRS	Sistemi i kthimit të depozitës;
ELV	Automobila mbeturinë;
EPR	Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit;
GIZ	Ministria federale gjermane për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik;
QeK	Qeveria e Kosovës;
ITMB	Impijanti për trajtimin mekanik biologjik;
SMIM	Sistemi i menaxhimit të integruar të mbeturinave;
JICA	Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar;
Kfw	Kreditanstalt für Wiederaufbau;
KIWER	Instituti i Kosovës për hulumtim të ujit dhe mjedisit;
KLMC	Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës;
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave;
MESPI	Ministria e mjedisit planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës;
MND	Mbeturina nga ndërtim demolimi;
MPEE	Mbeturina nga pajisje elektrike dhe elektronike;
MRF	Qendra e rikuperimit të materialit;
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik;
PKMM	Plani komunal për menaxhim të mbeturinave;
PPP	Partneriteti publik privat;
PZP	Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit;
SIMM	Strategjia e integruar e menaxhimit të mbeturinave;
WFD	Direktiva kornizë e mbeturinave;

Lista e tabelave

Tabela 1	Gjatësia kufitare e Glllogocit me komunat fqinjë;
Tabela 2	Të dhënat mbi popullatën;
Tabela 3	Regjistrimet e popullsisë në periudhat prej vitit 1948 – 2011;
Tabela 4	Shtimi natyror në vitin 2017 në komunën e Glllogocit (në promil);
Tabela 5	Fondi i banimit në raport me njësitë e banimit dhe tipologjinë e ndërtesave të banimit;
Tabela 6	Numri i njësive të banimit- shtëpive dhe banesave kolektive sipas vendbanimeve;
Tabela 7	Ndotësit kolektiv në Komunën e Glllogocit;
Tabela 8	Lokacioni dhe vendndodhja e metaleve të rënda;
Tabela 9	Numri i punëkërkueseve të regjistruar në zyrat e punësimit, shtator 2017;
Tabela 10	Numri i të punësuarve neper vite, 2011-2018;
Tabela 11	Numri i ndërmarrjeve sipas llojit të pronësisë, në % (Burimi: ATK, 2018);
Tabela 12	Ndërmarrjet ekonomike, sipas sektoreve ekonomik, 2011- 2018;
Tabela 13	Klasat e tokës ne Komunën e Glllogocit;
Tabela 14	Numri i institucioneve, edukatorëve, nxënësve dhe punëtorëve arsimor;
Tabela 15	Bilanci i mbeturinave komunale;
Tabela 16	Operatorët e mbeturinave nën përgjegjësi komunale;
Tabela 17	Operatorët tjerë të mbeturinave që operojnë në territorin e komunës;
Tabela 18	Mbulimi me shërbim në territorin e komunës;
Tabela 19	Mbulimi i ofrimit të shërbimit për EF sipas vendbanimit;
Tabela 20	Tipologjia dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit;
Tabela 21	Pajisjet për hudhjen dhe grumbullimin e mbeturinave;
Tabela 22	Pajisjet për grumbullim dhe transport të mbeturinave;
Tabela 23	Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM aktual;
Tabela 24	Efikasiteti i stafit të shërbimeve të MM;
Tabela 25	Performanca e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave;
Tabela 26	Shpenzimet e sistemit të MM;
Tabela 27	Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM;
Tabela 28	Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit;;
Tabela 29	Lista e objektivave të planit;
Tabela 30	Korniza strategjike e Objektivit 1;
Tabela 31	Korniza strategjike e Objektivit 2;

Tabela 32	Parashikimet demografike të populates;
Tabela 33	Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave;
Tabela 34	Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave sipas kompozicionit;
Tabela 35	Caqet e riciklimit;
Tabela 36	Orari i ndarjes së mbeturinave në burim;
Tabela 37	Korniza strategjike e objektivit 3 ;
Tabela 38	Strategjia e zgjerimit me shërbim ;
Tabela 39	Efikasiteti i stafit;
Tabela 40	Korniza strategjike e objektivit 4;
Tabela 41	Korniza strategjike e objektivit 5 ;
Tabela 42	Plani financiar, veprimit dhe monitorimit – Objektivi 1, Parandalimi dhe reduktimi ;
Tabela 43	Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektivi 2 Ripërdorimi dhe riciklimi;;
Tabela 44	Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektivi 3 Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme;
Tabela 45	Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektivi 4 Deponimi i sigurtë si mjeti i fundit;
Tabela 46	Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektivi 5 Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për MM;

Fjala e kryetarit

Qytetarë të komunës së Glogocit,

Administrata komunale është zotuar që me përkushtim të menaxhojë mbeturinat në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme. Hartimi i Planit Komunal për Menaxhim të Mbeturinave është pjesë e përkushtimit tonë në këtë fushë.

Nëpërmes këtij plani, komuna e Glogocit do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të investuar në mënyrë të planifikuar në sistemin e menaxhimit të mbeturinave në komunën tonë.

Planifikimi i tillë do të përmirësojë gjendjen e menaxhimit të mbeturinave dhe përfundimisht do të ndikojë edhe në gjendjen mjedisore në komunën tonë.

Rregullimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në komunë, gjithashtu, synon të krijojë kushte edhe për zhvillim ekonomik lokal, nëpërmes veprimeve për ndarje dhe riciklim të mbeturinave.

Ne, administrata komunale me përkushtim është duke bërë përpjekjet për të krijuar ambient sa më të pastër për qytetarët tanë. Kjo mund të arrihet vetëm me bashkëpunim të plotë të të gjithë akterëve në komunën tonë.

Në emër të qytetarëve të komunës së Glogocit, falënderoj kontributdhënësit gjatë hartimit të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, 2023-2027 në komunën e Glogocit, në veçanti GIZ-in Gjerman që ka mbështetur hartimin e këtij plani, KIWER, CEDE dhe Grupin Punues mbështetës teknik komunal, që këtë dokument strategjik ta konceptojmë si vlerë të përbashkët, e cila do të rrisë cilësinë e jetës me mjedis të pastër për të gjithë qytetarët e komunës së Glogocit.

Faleminderit për bashkëpunim!

Përzemërsisht,
Kryetari i Komunës së Glogocit
Ramiz Lladrovci

1 Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave

1.1 Qëllimi dhe fushëveprimi i planit

Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave (PKMM) i Glllogocit është dokument planifikimi për zbatimin e Strategjisë së Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Planin e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave në nivel lokal, duke kontribuar në zbatimin e politikave dhe përmbushjen e objektivave të strategjisë. Përmes PKMM-së, komuna mundëson një qasje të menaxhimit të integruar të mbeturinave, duke zbatuar një sërë masash, ku synimi kryesor është reduktimi i mbeturinave komunale që gjenerohen në burim, ngritja dhe zhvillimi i infrastrukturës për trajtimin e mbeturinave, aspektet financiare të sistemit, aspekte tjera siç janë monitorimi i gjendjes në këtë sektor, bashkëpunimi me të gjithë akterët, ndërgjegjësimi i popullatës etj.

PKMM përfshin:

- Përcaktimin e prioritetëve të sektorit me qëllim përmbushjen dhe përafrimin me objektivat e Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (SMIM) 2021-2030 dhe Planin e Veprimit për Menaxhimin e Mbeturinave (PVMIM) 2021-2023; përkatësisht ndërmarrjen e veprimeve konkrete në realizimin dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara;
- Vlerësimin e sistemit aktual të mbledhjes së mbeturinave, pajisjeve dhe personelit, duke e përkufizuar bazën e shërbimeve dhe aktivitetëve aktuale për menaxhimin e mbeturinave,
- Rregullimin e aspekteve organizative dhe operacionale në nivel të komunës në bashkëpunim me akterët tjerë të përfshirë në menaxhimin e mbeturinave komunale;
- Rolin dhe përgjegjësitë institucionale dhe rregullativen funksionale të sistemit të menaxhimit të mbeturinave;
- Ngritjen e kapaciteteve profesionale të kuadrit, me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të gjendjes në këtë sektor, rekomandimin e masave për përmirësimin e gjendjes etj.;
- Rregullimet financiare, duke pasqyruar nevojat financiare me qëllim arritjen e qëndrueshmërisë së sistemit të menaxhimit të mbeturinave, si dhe analizimin e burimeve financiare për investime në sektor.
- Përcaktimi i modelit të operimit, ku janë propozuar 4 modele:
 1. Mbështetja e njësisë së Kompanisë KRM"PASTRIMI", nga Komuna me paisje dhe forma të tjera të mbështetjes sipas marrëveshjes së nënshkruar në mes të Komunës dhe KRM"Pastrimi",
 2. Decentralizimi i kompanisë KRM"Pastrimi" nga njësi qendrore, në aspektin financiar,
 3. Krijimi i ndërmarrjes publike Lokale (NPL),
 4. Partneriteti publiko privat.

PKMM do të shërbej si kornizë planifikuese dhe vepruese për implementimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, hartimin e projekteve, buxheteve dhe planeve investuese, si dhe tërheqjen e mbështetjes financiare dhe profesionale.

1.2 Baza ligjore dhe institucionale për rishikimin e planit

Baza ligjore për hartimin e PKMM-së, është përcaktuar në Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, i cili rregullon aspektet e menaxhimit të mbeturinave. Ligji i Mbeturinave ofron rregullimet bazë mbi MM, duke përfshirë klasifikimin e mbeturinave, rolet dhe përgjegjësitë e akterëve kyq në menaxhimin e mbeturinave si dhe aspektet tjera që kanë të bëjnë me kushtet dhe standardet e operimit, licencimit të operatorëve për MM etj.

1.3 Korniza ligjore për MM

Ligji nr. 04/ L-060 për Mbeturinat është Ligji kornizë për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë, i cili rregullon aspektet e përgjithshme dhe specifike të menaxhimit të mbeturinave komunale dhe llojeve tjera të mbeturinave. Ligji në fjalë ofron parimet bazë mbi menaxhimin e mbeturinave përfshi rolet e përgjegjësive të institucioneve kyq në menaxhimin e tyre, si dhe aspektet e operimit, dhe licencimit të operatorëve publik dhe privat që menaxhojnë me mbeturina.

Në mënyrë specifike Ligji i Mbeturinave, përmes nenit 15 i përcakton kompetencat e komunave sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Komunitet sipas e nenit 10, paragrafit 2 dhe 5 dhe nenit 15 të ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e Planeve Komunale të Menaxhimit të Mbeturinave, krijimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, përzgjedhjes së operatorëve të licencuar si dhe përcaktimit të tarifave dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve. Ligji i mbeturinave është hartuar duke u bazuar në direktivat përkatëse të KE që e rregullojnë lëminë e menaxhimit të mbeturinave komunale dhe rrjedhave tjera të mbeturinave.

Korniza Ligjore përmban një numër të konsideruar të ligjeve tjera sektoriale të cilat në mënyrë indirekte rregullojnë menaxhimin e mbeturinave. Këto Ligje përfshijnë: Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 04/L-174, etj.

Baza ligjore për menaxhimin e mbeturinave në nivelin lokal të Komuna e Glllogocit, përveq dispozitave të ligjit për mbeturiuna përfshinë edhe Rregulloren Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Glllogocit;

Dokumentat tjera planifikuese për menaxhimi të mbeturinave është edhe **Strategjia (2021-2030) dhe Plani i Veprimt (2021-2023) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë**- dokument strategjik që synohet të arrij zhvillimin e integruar dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave dhe të ndikoj në ruajtjen e shëndetit publik, zhvillimin social dhe

ekonomik të vendit. Dokumenti synon ti trajtojë të metat dhe kufizimet aktuale në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, duke i përcaktuar dhe realizuar objektivat strategjike.

Dokumente strategjike në nivel lokal që rregullojnë dhe trajtonë aspekte të menaxhimit të mbeturinave janë edhe:

- **Plani Zhvillimor Komunal 2020-2028 i Komunës së Glllogocit** - Është bazë për zhvillim të qëndrueshëm në komunën e Glllogocit dhe synon ruajtjen e mjedisit, shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve për zhvillim ekonomik, për gjeneratat e ardhshme dhe balancimin e zhvillimeve hapësinore. Përmes këtij plani koordinohen kërkesat sociale dhe ekonomike për hapësirën me funksionet e saj kulturore dhe ekologjike.
- **Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2020-2025**- Dokument planifikues - strategjik, që adreson zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal për periudhën 5 vjeçare. Në një kapitull të vecantë ky dokument trajton edhe aspektet e menaxhimit të mbeturinave.

1.3.1 Korniza institucionale për MM

Autoritetet kryesore për menaxhimin e mbeturinave janë Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunitat e Kosovës.

Sipas ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturina, nenit 14 definojnë, kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat e Ministrisë dhe institucioneve tjera relevante në nivelin qendror janë si në vijim:

1. Kompetencat e Ministrisë për zbatimin e dispozitave të këtij ligji janë:

- 1.1. Përcaktimi i politikave të përgjithshme, hartimi i Strategjisë, akteve ligjore që rregullojnë menaxhimin e mbeturinave dhe rregullimin e sektorit për menaxhimin e mbeturinave në Republikën e Kosovës;
- 1.2. Nxjerrja e Planit të veprimit për menaxhimin e mbeturinave sipas nenit 10 të këtij ligji;
- 1.3. Ministria është përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë dhe planit të Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave;
- 1.4. Lëshimin e licencës për menaxhimin e mbeturinave dhe mbajtja e evidencës në regjistrin për licencë;
- 1.5. Dhënia e lejeve për import, eksport dhe kalim tranzit të mbeturinave;
- 1.6. Për menaxhim të mbeturinave ka drejt të licencohet çdo person i cili plotëson kushtet për menaxhim me mbeturina sipas këtij ligji;
- 1.7. Krijimin e bazës së shënimeve dhe sistemit informativ për menaxhimin e mbeturinave nga Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës në harmoni me legjislacionin mjedisor;
- 1.8. Hartimin e raporteve për menaxhimin e mbeturinave në Republikën e Kosovës nga Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës;
- 1.9. Zbatimi i marrëveshjeve në sferën e bashkëpunimit ndërkombëtar për menaxhimin e mbeturinave;

1.10. Marrja e masave të nevojshme për të siguruar, që brenda territorit të Republikës së Kosovës mbeturinat të menaxhohen nga personat e licencuar dhe në objekte të lejuara;

1.11. Mbulimin e shpenzimeve administrative dhe shpenzimeve për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme dhe mbeturinave të tjera të cilat nuk janë në kompetencë të komunës dhe zotëruesi i tyre nuk është i njohur;

1.12. Të merr pjesë në monitorimin e asgjësimit të mbeturinave nga bimët narkotike dhe substancat narkotike të konfiskuara, në bashkëpunim me institucionet kompetente;

1.13. Ministria në koordinim me Ministrinë e shëndetësisë dhe Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural, do të përshkruan në detaje mënyrën e menaxhimit të mbeturinave medicinale, respektivisht veterinare;

1.14. Me MPB bënë koordinimin në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore e të tjera dhe sipas nevojës cakton anëtarët pjesëmarrës në komisionin për vlerësimin e gjendjes apo dëmeve eventuale nga mbeturinat;

2. Në bazë të dispozitave të Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturina, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, në marrëveshje me Komunat përkatëse përcakton tarifat për deponimin e mbeturinave komunale në deponitë e caktuara;

3. Tarifat për deponimin e mbeturinave komunale i caktojnë Komunat.

4. Në bazë të dispozitave të këtij ligji, Policia e Republikës së Kosovës bashkëpunon me agjencionet dhe organizatat e vendeve tjera për identifikimin, luftimin dhe parandalimin e veprimeve të ndaluara dhe keqpërdorimit të mbeturinave.

5. Në bazë të dispozitave Ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturina, Dogana e Republikës së Kosovës, kryen kontrollin, evidentimin dhe mbikëqyrjen e importit, eksportit dhe kalimit transit të mbeturinave, mban evidencë për shkeljet doganore dhe bashkëpunon me Ministrinë.

6. Ushtron mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të masave dhe veprimtarive për menaxhimin e mbeturinave.

Ndërsa kompetencat dhe përgjegjësit për menaxhimin e mbeturinave komunale në nivelin lokal gjegjësisht të komunave janë të definuara në nenin 15 dhe 34 pa përjashtuar nenet tjera të ligjit ku pjesërisht rregullohen dhe përcaktohen përgjegjësisht e komunave për mbeturinat e veqanta.

Sipas dispozitave të Neni 15 , pika 1.Përgjegjësitë dhe detyrimet e komunës për zbatimin e dispozitave të këtij Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina janë:

1.1. Krijimi i sistemit për menaxhimin e mbeturinave bazuar sipas parimit të hierarkisë për menaxhimin e mbeturinave për territorin e tyre, hartimi i planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave, sipas nenit 10 të këtij ligji dhe krijimi i kushteve për zbatimin e tij;

1.2. Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave duhet të jetë në harmoni me planin nacional;

1.3. Përgjegjës për zbatimin e planeve komunale janë Komunat;

- 1.4. Të hartoj raportin vjetor për menaxhimin e mbeturinave Raporti vjetor duhet dorëzuar në Ministri, deri më 31 mars të vitit vijues;
 - 1.5. Rregullimi i përgjegjësive dhe detyrimeve për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, zbatimi i tyre organizimin dhe menaxhimin e mbeturinave në territorin e tyre;
 - 1.6. Mirëmbajtja dhe përkujdesja për sistemin e informimit të publikut dhe raportimit për kryerjen e punëve të përcaktuara me këtë ligj, si dhe aktet tjera ligjore për menaxhimin e mbeturinave;
 - 1.7. Duke zbatuar procedurat e prokurimit, përzgjedh personat e licencuar për mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe transportin e mbeturinave: inerte, komunale, komerciale, të vëllimshme, dhe mbeturinat nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore brenda territorit të tyre;
 - 1.8. Komuna cakton tarifat dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale.
 - 1.9. Evidentimi i vendeve të ndotura në territorin e tyre, hartimi i projekteve për sanimin e tyre me shënime për lokacionin, karakteristikat hapësinore gjeometrike, lloji i ndotjes, sasia e mbeturinave, afatet për përmirësimin e gjendjes dhe shënime të tjera me rëndësi për realizimin e projekteve.
 2. Dy apo më shumë komuna, kur është interesi i tyre, mund të bëjnë marrëveshje për menaxhimin e mbeturinave.
 3. Komuna ushtron mbikëqyrjen dhe kontrollin e masave dhe veprimeve gjatë menaxhimit të mbeturinave në territorin e vet, përmes inspektorit komunal për mjedis.
 4. Me kërkesë të Ministrisë, komuna jep informacionet dhe rekomandimet e kërkuara lidhur me menaxhimin e mbeturinave.
 5. Komuna është e detyruar të sigurojë largimin dhe përkujdesjen e mbeturinave të cilat janë hedhur në hapësira publike ose jashtë deponive të mbeturinave në territorin e saj.
 6. Nëse personi përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me përgjegjësitë ligjore nuk përkujdeset për mbeturinat e hedhura nga personi i pa njohur, përgjegjësinë për ato mbeturina e bartë komuna.
 7. Komuna nxjerr akte nënligjore me të cilat, rregullon funksionimin e organit kompetent komunal dhe standardet e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave.
 8. Pa përjashtuar paragrafët 1. deri 7. të këtij neni, kryerja e shërbimeve publike dhe ofrimi i infrastrukturës publike në fushën e menaxhimit të mbeturinave komunale është kompetencë ekskluzive e komunave në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.
- Ndërsa sipas dispozitave të nenit 34 të Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina, detyrat për Menaxhimin e mbeturinave komunale janë:
1. Mbeturinat komunale duhet të mblidhen, grumbullohen trajtohen dhe menaxhohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitave tjera ligjore për rregullimin e veprimtarive komunale.

2. Komunitat, me akt nënligjorë, përcaktojnë kushtet dhe rregullat për menaxhimin e mbeturinave nga sipërfaqet publike.
3. Mbeturinat komunale të përziera me mbeturina të rrezikshme, duhet të ndahen kur ekziston llogaria ekonomike, në të kundërtën konsiderohen mbeturina të rrezikshme.
4. Amvisëritë dhe prodhuesit tjerë të mbeturinave komunale detyrohen që mbeturinat e tyre t'i hedhin në vende të caktuara për grumbullimin e mbeturinave komunale, ndërsa mbeturinat e rrezikshme t'i ndajnë dhe t'i dorëzojnë në vendet e caktuara për to.
5. Komunitat janë të detyruara të organizojnë sistemin për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme.
6. Amvisëritë dhe prodhuesit tjerë të mbeturinave komunale, janë të detyruar të bëjnë ndarjen e mbeturinave në lloje, sipas kushteve të përcaktuara nga autoriteti kompetent, me qëllim të trajtimit dhe riciklimit të tyre.
7. Komunitat me akt të veçantë, rregullojnë sistemin dhe kushtet për mënyrën e mbledhjes, ndarjes, përpunimit dhe riciklimit, orarin për mbledhjen e mbeturinave, llojin, numrin dhe mënyrën e shpërndarjes dhe vendosjes së kontejnerëve për mbeturina, mirëmbajtjen e vendeve ku grumbullohen mbeturinat dhe mënyrat për transportim të mbeturinave komunale.
8. Menaxhimi i mbeturinave komunale nga komuna duhet të bëhet përmes kontratave të veçanta me një apo më shumë operator publik ose privat të licencuar për menaxhimin e mbeturinave.
9. Dy e më shumë komuna me marrëveshje, sipas nenit 15 paragrafit 2. të këtij ligji, përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet lidhur me sigurimin e kushteve për menaxhimin e mbeturinave, për shfrytëzimin e objekteve për deponim, për përpunimin dhe magazinim të mbeturinave, të drejtat dhe detyrimet e ndërmarrjeve publike për menaxhimin e mbeturinave, mënyrën e marrjes së vendimeve në rastet e ankesave për çështjet specifike që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave, si dhe çështje tjera të rëndësishme për organizimin dhe menaxhimin e mbeturinave.

Kompanitë rajonale të menaxhimit të mbeturinave

Këto kompani janë kompani publike përgjegjëse për kryerjen e shërbimeve të grumbullimit, bartjen e mbeturinave nga vendbanimet deri tek deponitë e mbeturinave. Kompanitë rajonale publike e ofrojnë shërbimin për disa komuna në një rajon të caktuar dhe komunitat mundësohen me shërbim nga këto kompani. Në komunën e Glogocit operon Njesia Operative në kuader të KRM "Pastrimi SH.A." – Prishtinë e cila kryen shërbimin publik për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave komunale prej komunës së Glogocit në deponin regjionale të Prishtinës në Mirash të Obiliqit.

Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës – KMDK – është kompani shtetërore dhe është përgjegjëse për menaxhimin e deponive regjionale të mbeturinave të komunale. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK SH. A.), është kompani e publike e nivelit Qendror për menaxhimin e deponive

sanitare regjionale të mbeturinave Komunale në Republikën e Kosovës, e korporatizuar dhe e regjistruar si Shoqëri Aksionare konform Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.


Kompanitë e licencuara, janë kompani nga sektori publik dhe privat të cilat licencohen nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të cilat ofrojnë shërbimet për grumbullimin, trajtimin, riciklimin, transportimin dhe deponimin e llojeve të ndryshme të mbeturinave.

1.4 Konteksti lokal

Pozita gjeografike:

Sipërfaqja e komunës, kufinjtë, relievi, klima të reshurat, etj.

Territori i komunës së Glllogocit shtrihet në pjesën e Kosovës qendrore, në luginën e Drenicës, 32 km nga Prishtina. Territori i saj shtrihet në mes të Rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit.



Territori i Komunës së Glllogocit është një urë lidhëse në mes të këtyre dy rajoneve.

Komuna e Glllogocit ka një sipërfaqe prej 275,63km² me një lartësi mbidetare prej: 575 m, pika më e ulët, dhe 1072 m, pika më e lartë.

Komuna e Glllogocit rrethohet me Malet e Berishës në pjesën Jug- Perëndimore, Kosmaqit në pjesën perëndimore, Qyqavicës në pjesën Veriore, Goleshit dhe Lipovicës (Blinajës) në pjesën Jug-Lindore. Këto male shtrihen në të dy anët e Luginës së lumit Drenica.

Sa i përket komunave fqinje, në veri kufizohet me Komunën e Skënderajit, në VL me atë të Vushtrisë, në lindje me komunën e Obiliqit dhe Fushë Kosovës, në JL me Lipjanin, në JP me komunën e Malisheves dhe në Perëndim me atë të Klinës.

Harta e Kosoves. Pozita e komunës së Glllogocit në Kosovë

Në tabelën e mëposhtme janë vendosur edhe gjatësitë kufitare në mes Glllogocit dhe tyre.

Kufizimi me komunat fqinje	Gjatësia kufizuese
Glllogoc-Obiliq	6.7km
Glllogoc-Fushë Kosovë	11.4km
Glllogoc-Malishevë	24.6km
Glllogoc-Lipjan	15.8km
Glllogoc-Klinë	0.6km
Total perimetri	98.5km

Kjo komunë, në pikëpamje të ndërlidhjes tokësore lidhet më pjesët tjera të Kosovës më anë të hekurudhës Fushë Kosovë-Pejë dhe rrugës magjistrale Prishtinë – Bushat (Komoran)-Pejë, dhe rrugët ndërkomunale Shalë- Lipjan dhe Bushat-Glllogoc-Skënderaj.

Tabela 1. Gjatësia kufitare e Glllogocit me komunat Fqinje.

Hidrografia- Lumi kryesor që kalon nëpër komunën e Glogocit është Drenica, e cila është degë e majtë e lumit Sitnica dhe i takon pelgut të Ibrit. Ajo buron në Bretenc te mali Cërralevë. Drenica që nga Glogoci e deri në Bardh i Madh, hyn në një pjesë të ngushtë, duke marrë pamjen e një gryke. Në këtë pjesë të lumit pjerrtësia është më e madhe, gjerësinë më të madhe (10 m) dhe me pjerrtësi të butë derdhet në Sitnicë. Prurja mesatare e lumit Drenica në Sitnicë është 2,0 m³/s. Drenica ka dhe degëzimet e veta siç është Verbofc. Në territorin e komunës së Glogocit ndodhet edhe Liqeni i Vasilevës. Gjithashtu, në territor të komunës gjendet edhe burimi i ujit mineral në Poklek me temperaturë 13.0°C, pH 6.3., rrjedhje 1.00l/sec dhe mineralizim 3.52 si dhe ai në Vërboc, lagjja Istog. Sipërfaqen e tokës pjellore të Luginës së Drenicës e mbulon sistemi i ujitjes “Ibër-Lepenc”.

Klima - Kushtet klimatike janë mjaft të përshtatshme. Rajoni ka një klimë të mesme kontinentale me dimra të ftohtë dhe verë të ngrohtë me ndikime të klimës mesdhetare. Kjo vë re nga pozita e komunës në mes të Rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit. Rrafshi i Dukagjini ka klime me ndikime mesdhetare nga deti Adriatik, kurse ai i Kosovës ka klime kryesisht kontinentale. Temperatura mesatare vjetore është 10.6 °C, ku muaji më i ftohtë është janari me 0.8°C, kurse muaji më i ngrohtë është korriku me 20.6°C. Sasia mesatare e të reshurave është afër 670 mm, kurse në sezonin e vegjetacionit (prej muajit të IV-IX) afër 330 mm.

Relievi - Lartësia mbidetare është prej 500-650m. Rreth 46% e sipërfaqes së territorit të komunës së Glogocit gjendet në lartësinë mbidetare rreth 650m, lartësi kjo që është njëra ndër më të përshtatshmet për zhvillimin e prodhimit bujqësor, ndërsa pika më e lartë është 1072m.

Pedologjia dhe gjeologjia - Tokat në këtë komunë janë mjaft heterogjene nga aspekti i krijimit, vetive fiziko-kimike, përkatësisë tipologjike, pjellorisë potenciale, problemeve melioruese etj. Tokat në territorin e Komunës së Glogocit sipas përbërjes pedologjike janë të përfaqësuara nga: tokat e murrme në shtresa kompakte, tokat e mesme të kuqërremtë, tokat e kuqe, tokat smonicë, tokat rendezinë, tokat ranker, tokat pseudogleje, tokat e livadheve, tokat diluviale dhe tokat aluviale etj.

Resurset natyrore:

Përveç xehes së Feronikelit e cila është duke u eksploatuar dhe përpunuar në minierën e Çikatovës së vjetër dhe Gllavicës në Lipjan, si dhe përpunimin e tyre në shkretoren e Feronikelit, në teritorin e Komunës së Glogocit janë të identifikuara edhe rezerva të konsiderueshme të Kromit, Lignitit, Hekurit, Donitit, Guri gëlqeror, Uji mineral etj. të cilat ofrojnë mundësi për zhvillimin e kapaciteteve të eksploatimit dhe përpunimit të tyre, të cilat njëkohësisht sjellin një mundësi për zhvillim ekonomik dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve minerale dhe industria minerare janë ndër ndotësit më të mëdhenj të mjedisit në Komunën e Glogocit. Operatorë më të mëdhenj të eksploatimit të gurit në komunën e Glogocit janë ata që operojnë në: Çikatovë e Vjetër, Korroticë e Lartë dhe Baicë.

Komuna e Glogocit është e pasur me resurse pyjore dhe përfshin një sipërfaqe prej 11,355.00 ha. Zona malore është shpallur zonë me prioritet për mbrojtjen e natyrës, ri-pyllëzim, rekreacion dhe turizëm. Zonat me të rëndësishme pyjore shtrihen në malet e Berishës,

Kosmaç dhe në Çyçavicë. Në territorin e Glllogocit janë zhvilluar pyjet gjetherënëse, termofile dhe mezofile. Komuna është e kufizuar me dhënie e lejeve për ndërtim në këto zona. Pyjet luajnë një rol të rëndësishëm për florën dhe faunën në komunë, për klimën dhe ekonominë lokale. Druri këtu përdoret për ndërtim, artizanate tradicionale, përpunime industriale dhe ngrohje. Konsiderohet se pjesët e prera të pyjeve në vitet e fundit duhet ri-pyllëzuar.

Komuna e Glllogocit ka rezerva të pamjaftueshme ujore, ngaqë i takon pjesës qendrore të Kosovës, si rajon që njihet për reshje me të pakta. Drenica paraqet lumin kryesor të Komunës së Glllogocit dhe mbledh të gjitha rrjedhat tjera ujore. Ai buron në malin e Carralevës (Komuna e Shtimes). Llapushniku dhe Vërbovci konsiderohen degët kryesore të Lumit Drenica. Është me rëndësi të përmenden disa nga burime të rëndësishme të ujit që derdhen në Lumin Drenica, siç janë: Kroi i Mbretit, Burimi i ujit mineral në Paklek, etj. Sasia e ujit që rrjedh në Pellgun e Lumit Drenica gjatë vitit është $294.88 \text{ m}^3 \times 106$. Nga kjo sasi, $74.87 \text{ m}^3 \times 106$ (25.4 %) vinë nga reshjet dhe $220.01 \text{ m}^3 \times 106$ (74.6 %) nga burimet.

Sipas të dhënave të stacioneve hidrometrike në vendosura në territorin e komunës së Glllogocit, niveli më i ulët i ujit në lumin Drenica ka qenë në vitin 1963 (24 cm), ndërsa niveli më i lartë në vitin 1969 (90 cm), ndërkohë që mesatarja vjetore e nivelit të ujit të lumit është 56.6 cm. Gjatë vitit niveli më i ulët mesatar i ujit është në muajin shtator (34.3 cm), ndërsa më i larti në shkurt (85.1 cm) dhe mars (81 cm). Përbërja gjeologjike e terrenit ka kushtëzuar që pjesa dërmuese e këtyre ujërave të jenë sipërfaqësore, por pa përjashtuar edhe praninë e ujërave nëntokësore dhe të burimeve termominerale. Shkëmbinjtë ujëmbajtës kanë bërë që të krijohet një liqen i vogël me 17.59 ha në Vasilevë, i cili shfrytëzohet më së shumti nga vizitorë të ndryshëm për peshkim gjatë fundjavave. Ka plane për shfrytëzimin e tij për turizëm. Gjithashtu, në territor të komunës gjendet edhe burimi i ujit termal në Poklek me temperaturë 13.0°C , pH 6.3., rrjedhje 1.00 l/sek. dhe mineralizim 3.52.

Kohëve të fundit (dimri 2018-19) për shkak të punimeve joadekuate në kanalizim, burimi është dëmtuar dhe më nuk është i përshtatshëm për pije dhe nuk ka karakteristikat që i ka pasur. Me qëllim të rritjes së kapaciteteve akumuluese të ujërave në territorin e saj, Komuna e Glllogocit ka marrë vendim për shpalljen e interesit publik për lokacionin ku ndodhen ngastrat kadastrale në fshatin Verboc për ndërtimin e pendës për liqenin akumulues të Verbovcit, i cili planifikohet të shfrytëzohet për pije dhe ujitje. Monitorimi i cilësisë dhe sasisë së ujërave sikurse edhe në gjithë territorin e Kosovës bëhet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës/IHMK, ndërsa monitorimin e cilësisë ujit të pijshëm e bën Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik IKSH. Gjithashtu, ekzistojnë burime të tjera të ujit që nuk janë të shfrytëzuara, mirëpo që paraqesin një mundësi për përmirësimin e furnizimit të ujit në Glllogoc. Këto burime janë: Baica – 6 l/s, Nekoc - 4 l/s, Llapushnik - 2 l/s, Arllat – 2 l/s, Verbovc - 3 l/s, si dhe dy (2) burime të njohura të ujit mineral njëri në “Paklek të Vjetër” (2 l/s) dhe tjetri në Verboc (0.3 l/s).

Popullsia**Tabela 2: Të dhënat mbi popullatën**

Regjistrimi ASK 2011		Vlerësimi ASK 2021	
Numri i populates	Numri i amvisërive	Numri i popullatës	Ngritje
58531	8786	60721	3.7 %

Analiza e zhvillimit demografik shqyrton të dhënat nga regjistrimet e popullsisë për periudhën e viteve 1948-2011. Regjistrimi i vitit 2011 ka regjistruar vetëm banorët e përhershëm të komunës, duke mos i kalkuluar banorët e përkohshëm, studentët dhe të punësuarit të cilët përkohësisht jetojnë në komunë.

Viti	Popullsia		Ekonomitë Familjare (EF)		Madhësia e Familjes (numri i anëtareve në EF)		Pjesëmarrja e qytetit në komunë (%)	
	Komuna	Qyteti	Komuna	Qyteti	Komuna	Qyteti	Komuna	Qyteti
1948	16177	558	2106	77	7.7	7.2	3.7	3.4
1953	17683	658	2295	95	7.7	6.9	4.1	3.7
1961	21125	836	2631	138	8.0	6.1	5.2	4.0
1971	28188	1343	3264	167	8.6	8.0	5.1	4.8
1981	39141	2440	4138	318	9.5	7.7	7.7	6.2
1991 ¹	53618	4499	5906	560	9.1	8.0	9.5	8.4
2011	58531	6143	8786	1047	6.7	5.9	11.9	10.5

Tabela 2. Regjistrimet e popullsisë në periudhat prej vitit 1948 – 2011

Numri i banorëve - Nga të dhënat e paraqitura të regjistrimeve të popullsisë rezultojnë që numri i popullsisë në Komunën e Glllogocit nga viti 1948 deri në vitin 2011 ka shënuar një rritje të konsiderueshme me 42354 banorë. Në bazë të kësaj rritjeje, brenda periudhës kohore 63 vjeçare, del se mesatarisht në qytet popullsia ka shënuar rritje prej rreth 672 banorë në vit. Përderisa ka rritje paralele në qytet si dhe vendbanimet tjera kur shikohen si vlera në %, por duke i analizuar numrat e banorëve si njësi – numri i banorëve në vendbanimet tjera të komunës së Glllogocit është dukshëm më i madh se rritja e numrit të banorëve në qytet të Glllogocit. Kështu në qytet Glllogoc nga viti 1948 deri në vitin 2011 numri banorëve ka shënuar një rritje të konsiderueshme me 8228 banorë duke u rrit me më shumë se 10 fish sa ishte në vitin 1948, pra vendbanim me vetëm 558 banorë. Ndërsa, rritja e popullsisë është evidentuar të jetë edhe më e madhe në vendbanimet tjera të komunës së Glllogocit. Nga 15619 banorë që jetonin në vendbanimet përreth qytetit të Glllogocit në vitin 1941, ky numër është rritur në 52388 banorë.

Fenomeni i urbanizimit të qyteteve që vërehet në shumicën e qyteteve në Kosovë, sidomos në periudhën e pasluftës, pra migrimi i brendshëm fshat-qytet - nuk duket të jetë aq i theksuar në Komunën e Glllogocit.

Dendësia e popullsisë Glllogocit është rreth 212 banorë në 1 km², që është mbi mesataren në nivel vendi prej 165 banorë në 1 km². Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë dhe e kundërta në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël.

Nga harta vërehet se dendësia më e lartë e popullsisë e është në qytetin e Glllogocit ku mesatarisht jetojnë rreth 1651 banorë në një km². Gjithashtu ekzistojnë edhe disa vendbanime të tjera të cilat kanë dendësi të madhe siç janë: Shtrubullova (395 b/km²), Komoran (389.5 b/km²), Çikatovë e Re (363.1 b/km²), Nekoc (301.3 b/km²), Gllabar (300.4 b/km²), etj. Vendbanimet me shkallë më të vogël të dendësisë së popullsisë janë: Vasilevë (65.7 b/km²), Gradicë (68.7 b/km²), Vuçak (80.6 b/km²), Godanc (96.5 b/km²), etj.




Tabela 4. - Grafiku për shtimin natyror në vitin 2017 në komunën e Glllogocit (në promil)

Shtimi natyror i popullsisë

Të dhënat e shtimit natyror për vitin 2017 janë vlerësuar duke i shfrytëzuar të dhënat për lindjet dhe vdekjet nga Agjencia e Statistikës së Kosovës për vitin 2017 për komunën e Glllogocit. Për vitin 2017 është vlerësuar se në komunën e Glllogocit jetojnë 61133 banorë. Gjatë vitit 2017 në komunën e Glllogocit janë shënuar 1009 lindje dhe 249 vdekje. Bazuar në këto të dhëna është llogaritur shkalla e natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror në promil dhe në përqindje për komunën e Glllogocit.

Siç shihet edhe nga grafiku, shkalla e natalitetit në komunën e Glllogocit është 16.5 %, kurse shkalla e mortalitetit është 4.07 %. Në bazë të këtyre shkalleve të natalitetit dhe mortalitetit del se shtimi natyror i popullsisë në komunë është 12.43 %.

Banimi - në Komunën e Glllogocit në pjesën dërmuese ka tipologji rurale dhe dendësi të ulët. Shumica e fondit të banesave janë të reja, kryesisht të ndërtuara pas luftës. Ndërtimet nuk janë përcjellë gjithmonë shërbime adekuate publike, duke ndikuar edhe në kushtet sanitare dhe mjedisore. Numri i njësive të banimit për ndërtesat individuale është 11348 sosh . Ndërtesa kolektive janë 31. Në kuadër të vendbanimeve, banimi si funksion përfshinë sipërfaqen më të madhe. Sipërfaqja e gjithëmbarshme e banimit është 1600 ha, që përbën 5.8% të territorit komunal. Pothuajse e tërë sipërfaqja e banimit përbëhet nga banimi individual - 1,590.9 ha (5.77%), derisa ai në bashkëpronësi përfshinë 9.10 ha (0.03%)². Vendbanimet që dallohen për nga sipërfaqet më të mëdha të banimit janë Tërsteniku - 124 ha, Glllogoci - 120 ha, Komoran -113 ha, Llapushniku - 111 ha.

² Sipas kategorizimit të HILUCS

Banimi në teritorin urban dhe rural

Sa i përket numrit të njësive të banimit, profili komunal i referohet regjistrimit të popullsisë së v. 2011.

Bazuar në të dhënat e ASK-së³, del se komuna e Glogocit në vitin 2011 ka 58.531 banorë të cilët jetojnë në 8.786 ekonomi familjare, 1,444 prej të cilave janë në zonën urbane ndërsa 10,565 në zonën rurale.

Numri i përgjithshëm i njësive të banimit në Kosovë është 412.884, prej të cilave 175.942 (43%) janë në zonën urbane, ndërsa 236.942 (57%) në zonë rurale. Në komunën e Glogocit, numri i gjithmbarshëm i njësive të banimit është 12,009⁴. Pak më ndryshe nga Kosova, pjesa më e madhe e njësive të banimit gjenden në zonën rurale të komunës - 1,444 (12%), ndërsa në atë rurale - 10,565 (88%).

Numri i banorëve		Ekonomitë familjare	Njësitet e banimit	Ndërtesat e banimit
	Nr.	Nr.	Nr.	Nr.
Komuna e Glogocit	58,531	8.786	12,009 (100%)	8 096
Zona urbane	6,143	1,047	1,444 (12%)	807 (10%)
Zona rurale	52,388	7,733	10,565 (88%)	7,289 (90%)

Tabela 5. Fondi i banimit në raport me njësitet e banimit dhe tipologjinë e ndërtesave të banimit

Banimi në ndërtesa banimi me shumë njësi, natyrisht se është më i koncentruar në zonën urbane, ku edhe gjenden afro 90% e ndërtesave të tilla në komunën e Glogocit.

Emri i Vendbanimit / Zonës kadastrale	NR I NJËSIVE TË BANIMIT		Emri i Vendbanimit / Zonës kadastrale	NR I NJËSIVE TË BANIMIT	
	Shtëpi	Banesa kolektive		Shtëpi	Banesa kolektive
Glogoc	1229	25	Korroticë e Epërme	284	
Komoran	788		Krajkovë	263	
Tërstenik	793		Tërdec	235	
Llapushnik	629		Shtrubullova	264	
Arlat	475		Zabel i Ulët	104	
Nekoc	508		Fushticë e Ulët	158	
Baicë	464		Polluzhë	217	
Çikatovë e Re	401	2	Fushticë e Epërme	151	

³ ASK, vjetari statistikor i Republikës së Kosovës 2018

⁴ ASK, Banesat dhe Ndërtesat, sipas komunave, 2013.

Poklek	524	4	Korroticë e Ulët	228
Abri e Epërme	265		Shtuticë	187
Gllanasellë	357		Gradicë	212
Negroc	203		Domanek	152
Gllobar	313		Vasilevë	117
Kishnarekë	220		Likoshan	153
Dobroshec	314		Zabel i Epërm	261
Sankoc	257		Vuçak	51
Çikatovë e Vjetër	223		Godanc	89
Vërboc	259		TOTAL	11348
				31

Tabela 6. Numri i njësive të banimit- shtëpive dhe banesave kolektive sipas vendbanimeve⁵

Bazuar në parashikimet për rritje të popullsisë (kaptina për demografi), deri në vitin 2028 parashikohet rritje përafërsisht prej 14,692 banorë në zonën rurale, dhe 3,415 banorë në zonën urbane (duket llogaritur edhe Çikatovën e Re në zonën urbane). Numri i ekonomive familjare në qytet parashikohet të rritet përafërsisht për 476 ekonomi familjare, ndërsa në fshatra për 2939 ekonomi familjare.

Giendja e mjedisit dhe e biodiversitetit

Natyrë dhe biodiversiteti - Trashëgimia natyrore i referohet biodiversitetit duke përfshirë florën dhe faunën, ekosistemet dhe strukturat gjeologjike. Mbrojtja dhe shfrytëzimi i natyrës është i rregulluar sipas ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës. Sipas këtij ligji, inventarizimin e të gjithë përbërësve të larmisë biologjike, gjeologjike e peizazheve - llojet, tipit të vendbanimeve, gjeolokaliteteve dhe të peizazheve paraqitjen hartografike të llojeve të kërcënuara, gjeolokaliteteve dhe tipat e vendbanimeve etj. bëhet nga ana e Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Që nga themelimi i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) janë marrë nën mbrojtje ligjore shumë zona, monumente dhe vlera tjera të natyrës në mesin e të cilave janë edhe asetet e trashëgimisë natyrore të komunës së Glllogocit.

Në territorin e Komunës së Glllogocit shtrihen edhe Liqejt e Vasilevës, që karakterizohen me një biodiversitet të pasur bimor, shtazor dhe peisazhor. Për shkak të këtyre vlerave që disponon kjo zonë, Instituti për Mbrojtjen e Natyrës së Kosovës, ka hartuar një arsyeshmëri dhe ka propozuar shpalljen e kësaj zone si Peisazh i Mbrojtur i Natyrës. Zona e propozuar për mbrojtje e Peisazhit të Mbrojtur “Liqejt e Vasilleves” përfshin një sipërfaqe të përgjithshme prej 320.9 ha. Edhe pse këto janë liqene artificiale të krijuara me depozitimi i materialit (dheut) nga mihjet sipërfaqësore në Bardh dhe Mirash nga Korporata Elektroenergjetike e Kosovës në vitet e ‘60 të shekullit të kaluar, ato paraqesin zonë të rëndësishme të natyrës dhe me potencial për zhvillimin e turizmit. Një zonë tjetër natyrore me rëndësi për Komunën e

⁵ Burimi: Drejtoria e Urbanizmit, Glllogoc dhe ASK

Glllogocit janë Bjeshkët e Çyçavicës. Kjo zonë përmes një memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar nga komunat ku shtrihen këto bjeshkë (Glllogovc, Obiliq, Skenderaj, Mitrovicë dhe Vushtrri) është shpallur si zonë e interesit të përgjithshëm me qëllim të menaxhimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore të kësaj zone.

Flora dhe vegjetacioni i territorit të Komunës së Glllogocit - Territori i komunës së Glllogocit zë një vend të rëndësishëm në Kosovë nga aspekti floristik dhe vegjetativ. Sipas të dhënave që disponojmë, territori i komunës së Glllogocit i takon Rajonit Eurosiberiko – Amerikanoverior i cili përfshinë viset kontinentale të vendit, e që ndahen ndërmjet rajoneve kufitare mediterane nga njëra anë dhe majave më të larta të masiveve malore të cilat i takojnë regjionit Alpiko – Nordik nga ana tjetër. Ky regjion, prezantohet me dy provinca fitogjeografike të cilat janë: 1. Provinca Mezike, e cila përfshinë shpatet e Malit të Çyçavicës në kuadër të së cilës hyjnë pyjet lëvorbardha dhe pyjet lëvorzeza të brezit malor (montan) dhe paramalor (submontan) e që në këtë territor paraqitet konkretisht me pyje të bungut dhe shkozës (Querco – Carpinetum Rud.) dhe pyjet kodrinore dhe malore të ahut (Fagetum montanum Rud.), dhe Në bazë të kësaj që u përmend më lart, mund të konstatohet se në territorin e Glllogocit janë zhvilluar pyjet gjetherënëse, termofile dhe mezofile; të prezantuara në bashkësi të ndryshme të cilat ndërmjet tyre dallohen në bazë të përbërjes floristike si pasojë e kushteve të ndryshme ekologjike. Në territorin e Glllogocit janë prezente këto bashkësi (asociacione) pyjore: • Ass. Carpinetum orientalis scardicum, Krasniqi (Bashkësia e shkozë së zezë), • Ass. Quercetum farnetto – cerris scardicum, Krasniqi (Bashkësia e shpardhit dhe qarrit), e përhapur kryesisht në lartësi mbidetare deri në 750 m, • Ass. Quercetum montanum, Çer. et Jov. (Bashkësia e dushkut malor), në lartësi mbidetare prej 630 – 960 m, e përfaqësuar kryesisht nga bunga (Quercus petraea), • Ass. Fagetum montanum Rud. (Bashkësia e ahut). Në zonën përreth Guri i Gradinës në të gjitha ekspozicionet është prezentë fitocenoza Fagetum Montanum me rreth 47 lloje që kanë një shtrirje mjaft të gjerë përreth monumentit. Në bazë të kësaj pasqyre floristike dhe vegjetative të territorit të Glllogocit mund të konstatohet se: territori i Glllogocit ka florë dhe vegjetacion relativisht të mirë mirëpo në degradim e sipër si pasojë e veprimit negative të faktorit antropogjen (sidomos në hapësirat rreth vendbanimeve) dhe se në shumë lokalitete të territorit të Glllogocit duhet të bëhen intervenime pozitive drejt normalizimit të gjendjes natyrore duke bërë pyllëzimin me llojet adekuate.

Fauna në territorin e Glllogocit - Si rezultat i aktiviteteve antropogjen e sidomos ato gjatë shndërrimit të hapësirës natyrore në territor agrikulturor, industrial apo territor për banim disa lloje shtazore të cilat kanë ekzistuar në këto zona janë zhdukur ose zhduken. Lloje të cilat janë zhdukur kohë më parë nga këto terrene janë: dreri, dhia e egër, pulelegra etj. Llojet prezente janë më rezistente ndaj kushteve të ofruara apo të imponuara por edhe te këto lloje vërehet zvogëlimi i numrit të tyre. Llojet të cilat ende hasen në territorin e Glllogocit janë: ariu (Ursus arctos), ujku (Canis lupus), dhelpira (Vulpes vulpes), qelbësi i rëndomtë, derri i egër (Sus

scrofa), vjedulla (*Meles meles*), ketri (*Sciurus vulgaris*), sqarhi (*Martes foina*), vidra, lepu (i) (*Oryctolagus cuniculus*), disa lloje të brejtësve të vegjël, gjeraqina, skiftori i përhimtë, petriti (*Falco tinnunculus*), kukuvajka, huti (*Bubo bubo*), harabeli, thëllënza (*Alectoris graeca*), pëllumbi i egër, kumria, disa lloje të korbave, çukapiku (*Dendrocopus major*), qyqja (*Cuculus canorus*), lauresha, borësi, rosat e egra (*Anser anser*), patat e egra (*Anas platyrhynchos*), lejlekët (lloje kalimtare dhe hasen rrallë), breshka e kënetave, breshka e pyjeve, hardhuca e përhimë, hardhuca e mureve, hardhuca e gjelbër, neperka, gjarpëri i larmë, gjarpëri i ujit (johelmues), picrraku (*Salamandra atra*), tritoni (*Triturus vulgaris*), bretkosa e gjelbërt, bretkosa dregëzore, krap (i) (*Cyprinus caprio*), fildishi, skobusi, shumë lloje të pakurrizorëve etj. Në zonën përreth Guri i Gradinës, sipas të dhënave që posedon IKMN në këtë hapësirë hasen këto lloje shtazore: 8 lloje gjitarësh, ndërsa dy lloje të tjera të gjitarëve janë zhdukur, 9 lloje shpendësh, 4 lloje zvarranikësh, 2 lloje ujë-tokësor. Viteve të fundit nga territori i komunës së Glllogocit janë raportuar disa gjetje të reja të insekteve ujore për faunën e Kosovës. Nga rendi i inskteve Plecoptera 6 lloje (*Nemoura anas*, *Nemoura peristeri*, *Nemoura asceta*, *Nemoura vinconi*, *Protonemura beaumonti* dhe *Brachyptera macedonica*) janë gjetja të reja për faunën e Kosovës të mbledhura në Bjeshkët e Berishës. Keto lloje kanë përhapje të kufizuar dhe janë shumë të rralla. Lloji *Limnephilus fuscicornis* është gjetje e re për faunën e Kosovës nga rendi i insekteve Trichoptera i mbledhur në lumin Drenica, gjithashtu nga ky rend i inskteve lloji *Limnephilus bipunctatus* është raportuar gjetje e re për faunën e Kosovës (i mbledhur në fshatin Shtuticë).

Ndotja e mjedisit është rezultat i shumë faktorëve si: industria, ndërtimet ilegale, infrastruktura joadekuate, shtimi i numrit të automjeteve, importimi i automjeteve të vjetruara në Kosovë, importi i vajrave dhe derivateve të kualitetit të dobët (me sasi të lartë të sulfurit), deponimi joadekuat i tyre, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, prerja e pakontrolluar e pyjeve, akumulimi i plehrave urbane si pasojë e menaxhimit të dobët, mungesa së riciklimit, etj. Duke konsideruar prezencën e shumicës së faktorëve të lartpërmendur, gjendja e mjedisit në komunën e Glllogocit nuk mund të konsiderohet në nivel të kënaqshëm. Industria e prodhimit të metaleve (NeËCo Feronikeli) është një nga industritë me ndikim më të madh mjedisor në Kosovë, edhe pse vërehet ulje e emisioneve që vijnë si rezultat i aktiviteteve të tyre⁶. Sektori i transportit dhe infrastrukturës së tij është një ndër sektorët që ka ndikim mjaft negativ në gjendjen e mjedisit ngase ndikon në fragmentimin dhe degradimin e habitateve (biodiverzitetit), ndryshimin e peizazhit, shfrytëzimin e tokës dhe trashëgiminë kulturore. Kjo gjendje e kërcënon mjedisin duke shkaktuar ndotjen e ujit, ujërave nëntokësorë, ajrit dhe dheut. Si pasojë kemi dëmtimin e resurseve natyrore dhe humbje të tokës bujqësore. Shfrytëzimi joracional dhe pa kritere të ujit, tokës si dhe pyjeve është një tjetër çështje që duhet të

⁶Draft raporti i Gjendjes së Mjedisit 2017, AMMK

konsiderohet si çështje serioze në të ardhmen. Është përgjegjësi komunale që të mbrojë dhe ruaj mjedisin natyror dhe jetësor (urban dhe rural) nga dëmtimi, degradimi apo ndotja si pasojë e veprimtarisë njerëzore ose të ndikimit natyror.

Ndotja e ajrit - Cilësia e ajrit në Glllogoc monitorohet përmes stacionit në Glllogoc nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, i cili raporton në Agjencinë për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës. Stacioni i vendosur në Glllogoc është reprezentativ për cilësinë e ajrit në sfondin urban. Matjet behën vetëm në sfondin urban e jo në tërë territorin e komunës. Nga të dhënat për matjen e përqendrimit SO_2 , CO , NO_2 , dhe O_3 shihet se nuk janë regjistruar tejkalime të vlerave mesatare vjetore (VML) në stacionin monitorues për vitin 2017.

Është vërejtur se gjatë sezonës vjeshtë-dimër-pranverë kishte tejkalime të përqendrimit të pluhurit në formë të PM_{10} dhe $\text{PM}_{2.5}$ që janë rezultat i aktiviteteve të Feronikelit, transportit rrugor dhe amvisërive, të cilat gjatë sezonit të ngrohjes përdorim lëndë djegëse që lirojnë emisione të cilat shkaktojnë ndotjen e ajrit.

Emisionet në ajër nga NeëCo Feronikeli- Përmbajtja e metaleve të rënda në xehen fillestare, si Fe-hekur, Ni-Nikel, Co-Bakër, Cd-Kadmijum, Cr-Krom, As-Arsenik, Pb -Plumb etj. dhe proceset metalurgjike që e shoqërojnë procesin e tërësishëm e karakterizojnë Feronikelin ndotës të kategorisë A (sipas Kriteve për VNMBEZH dhe BB). Emisionet në ajër lirohen veçanërisht nga furrat rrotulluese, furrat elektrike, konvertori dhe ngrohtorja. Matjet nuk bëhen në mënyrë të vazhdueshme, por vetëm kohë pas kohe. Sipas një projekti të financuar nga UNDP për nivelin e ndotjes së ajrit në zonën Glllogocit⁷ janë regjistruar tejkalime të vlerave të lejuara kryesisht gjatë muajve tetor, nëntor dhe dhjetor 2015 në të katër lokacionet e mostrimeve (Çikatovë e vjetër, Çikatovë e Re, Gillobar dhe Lagja e Feronikelit).

Ndotja e ujit - Monitorimi i gjendjes së ujërave (cilësinë - ndotjen dhe sasinë) e bënë IHMK/AKMM, IHMK bën monitorimin e sasisë së ujërave ndërsa monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm e bën IKSHP. Komuna është kompetente për mbrojtjen e shtretërve, brigjeve të ujë rrjedhave, kanaleve, tuneleve dhe akumulimeve ujore brenda zonave urbane. Përmes rrjetit hidrometrik i cili përbëhet nga një numër i stacioneve matëse nëpër lumenj kryhen matje të sasisë së ujit. Në këto stacione matet Niveli (h) dhe Prurja (Q). Në Glllogoc sasia minimale e prurjes është $0.02 \text{ m}^3/\text{s}$, mesatarja $1.52 \text{ m}^3/\text{s}$ dhe ajo maksimale është $32.80 \text{ m}^3/\text{s}$. Në komunën e Glllogocit lumenjtë kryesor janë Drenica me gjatësi 50km dhe Vërboci dhe në anën tjetër kanali i Ibër-Lepencit i cili nuk është lum. Monitorimi i lumit Drenica bëhet nga Pjetërshtica dhe para bashkimit me Sitnicën në Vragoli. Gjatë pranverës në stacionin e parë ka një cilësi më të mirë përderisa në stacionin e dytë në Vragoli gjendja pëson ndryshime të theksuara p.sh. përçueshmëria elektrike rritet për disa qindra njësi si rezultat i shkarkimeve të ujërat të mihjeve sipërfaqësore të KEK-ut.

⁷UNDP/IHMK, "Monitorimi i PM_{10} në ajër dhe përcaktimi i metaleve të rënda në PM_{10} në zonën e Glllogocit, Tetor 2015 – Mars 2016"

Të gjitha ujërat e kanalizimeve të qytetit dhe fshatrave të Glllogocit derdhen në Lumin Drenica. Në komunën e Glllogocit me efekt të madh të ndotjes duhet veçuar New Co Feronikeli, i cili shkarkon ujëra me ngarkesë termike, ujëra të procesit dhe ujëra sanitar dhe nuk ka impiant për pastrimin apo para-trajtimin e tyre.⁸

Sipas të dhënave New Co Feronikeli, gjatë vitit 2013 janë shfrytëzuar rreth 1.2 milion m³ ujë, që shënon një rënie të ndjeshme krahasuar me vitin paraprak.⁹

Vendbanimi	Nr, banorëve	Vendshkarkimi
Qyteti	9500	Drenica
Arllat	3199	Drenica
Damaneku	847	Drenica
Glllogari	1628	Drenica
Komoran 1	1699	Drenica
Komoran 2	1213	Drenica
Llapushnik	3585	Drenica
Nekoc	3230	Drenica
Pokleku i ri	900	Drenica
Pokleku i vjetër	1265	Drenica
Shtrubullojë	1287	Drenica
Tërsteniku	1958	Drenica

Tabela 7.3 Ndotësit kolektiv në komunën e Glllogocit

Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujore dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve ujore. Megjithatë, burimet e ndotjes kryesore të ujit shkaktohen për shkak të mungesës së trajtimit të ujërave të zeza dhe hedhjes së mbeturinave të ngurta (AMMK)¹⁰. Sa i përket Feronikelit, posedon sistem të brendshëm të trajtimit, por derdhja në lumin Drenica pas trajtimit bëhet në mënyrë nëntokësore dhe vështirëson monitorimin. Transportimi në kamionë pa mbulesë i mbetjes xehërore pas përpunimit bëhet në Çikatovë të Vjetër afërsi të kanalit të Ibër-Lepencit për ujitje, dhe ka shumë mundësi që i njëjti ndotet.

Në territorin e komunës së Glllogocit ndodhet Liqeni i Vasilevës. Ka plane¹¹ për shfrytëzimin e tij për turizëm. Gjithashtu, në territor të komunës gjendet edhe burimi i ujit termal në Poklek me temperaturë 13.0°C, pH 6.3., rrjedhje 1.00l/sec dhe mineralizim 3.52 g/l. Kohëve të fundit (dimri 2018-19) për shkak të punimeve joadekuate në kanalizim, burimi është dëmtuar dhe më nuk është i përshtatshëm për pije dhe nuk ka karakteristikat termale që i ka pasur. Nevojiten veprime konkrete në mbrojtjen e të gjithë ujërave në komunë.

Ndotja e tokës - Faktorët që më së shumti dëmtojnë sipërfaqe të tëra të tokës në Glllogoc janë: Vendbanimet (ndërtimet pa leje dhe të pa planifikuara), Industria (mbeturinat industriale, mihjetsipërfaqësore), Mbeturinat komunale, Deponitë, Eksploatimi i drurit (erozionet), Eksploatimi i zhavorrit (përmytjet), Përdorimi i plehrave dhe i pesticideve për qëllime bujqësore. Monitorimin e ndotjes së tokave në nivel vendi e bën Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Deponia Industriale e

⁸ Raporti Kadastr i Ndotësve të Ujërave të Kosovës

⁹ Raporti i ujërave 2015

¹⁰ Draft raporti i Gjendjes së Mjedisit 2017, AMMK8

¹¹ IDENTIFIKIMI I PRODUKTIT TURISTIK NË RAJONIN E PRISHTINËS, MTI 2017

Feronikelit ndodhet në Çikatovë dhe ka një sipërfaqe prej 24ha, ndërsa zona e ndikimit të saj është 71.37ha. Ky trend i ndotjes dhe degradimit të tokës akoma është në rritje, përkundër shumë masave të ndërmarra nga institucionet lokale dhe qendrore.

Përgjatë rrugëve kryesore tokat e shumta janë duke u zënë nga objektet afariste pa një strukturë të mirëfillte të planifikimit. Mungesa e planeve, mungesa e kontrollit tëzbatimit në hapësirat ku ka pasur plane (Qendra e Glllogocit), konsiderohet të jetë në favor të ndotjes së tokës. Ndotja nga metalet e rënda dhe shumë komponime organike është praktikisht e pakthyeshme (Komisioni Evropian, 2012). Dheu ka aftësi të kufizuar për të përpunuar kemikalet, për shembull nëpërmjet filtrimit apo transformimit¹². Sipas hulumtimit të bërë nga profesorët Muhamet Zogaj, Musaj Paçarizi, Rolf-Alexander Duerling me 20 mostra të dheut nga horizontin punues i tokave bujqësore dhe 20 mostra të bimëve në Komunën e Glllogocit janë marrë dhe analizuar për përmbajtjen e Ni, Cr, Pb, Zn, Cd, Cu, As. Është raportuar përmbajtja e metaleve të rënda në tokat bujqësore të Glllogocit. Cd në mostrat e dheut nën kulturën e grurit kanë treguar vlera deri në 0.48 mg . kg⁻¹, me një mesatare 0.08 mg . kg⁻¹ ndërsa në tokat nën kulturën e misrit deri 0.08 mg . kg⁻¹, me një mesatare prej 0.01 mg . kg⁻¹. Krahësuar me standardet e BE për vlerat e lejuara të Cd në tokë (3 mg . kg⁻¹, EC 1986), mostrat e analizuar janë brenda standardeve. Përmbajtja e Cr ka variuar nga 47.87 deri në 532.59 mg . kg⁻¹ në tokat nën kulturën me grurë, me një mesatare prej 219.39 mg . kg⁻¹ dhe median dukshëm me të ulët prej 153.85 mg . kg⁻¹. Në mostrat e dheut nën kulturën me misër, po ashtu Cr ka treguar variacione mjaft të shprehura prej 95.89 deri 315.27 mg . kg⁻¹, mesatarja e të cilave ka qenë 153.92 mg . kg⁻¹ dhe median 136.71 mg . kg⁻¹. Rreth 20 % e mostrave të analizuar të dheut në tokat nën kulturën e grurit i kanë tejkaluar vlerat e lejuara sipas standardit holandez (380 mg . kg⁻¹, Deutch list 1996), ndërsa tokat nën kulturën me misër kanë treguar vlera më të ulëta se vlera kritike. Sasia e Cu në tokë ka qenë nën pikën kritike të vlerave të lejuara sipas standardit evropian (140 mg . kg⁻¹, EC 1986), përkatësisht është sjell nga 18.76 deri në 83.31 mg . kg⁻¹ në tokat nën kulturën me grurë dhe 17.10 deri 32.35 mg . kg⁻¹ në tokat nën kulturën me misër, me një mesatare 33.65 mg . kg⁻¹ dhe median 28.25 mg . kg⁻¹, respektivisht 24.95 mg . kg⁻¹ dhe median 27.61 mg . kg⁻¹. Edhe përmbajtja e Ni ka treguar një variacion të gjërë prej 50.99 deri 583.66 mg . kg⁻¹ në tokat nën kulturën me grurë (mesatarja 232.67 mg . kg⁻¹ dhe median 153.56 mg . kg⁻¹), respektivisht 63.38 deri 596.28 mg . kg⁻¹ në tokat nën kulturën me misër (176.58 mg . kg⁻¹ dhe median 119.48 mg . kg⁻¹). 70% e mostrave të dheut nën kulturën e grurit dhe 90 % e mostrave të dheut nën kulturën e misrit e kanë tejkaluar pragun kritik sipas standardit të BE (75 mg kg⁻¹, EC 1986). Pb në tokat nën kulturën e grurit ka treguar vlera prej 40.24 deri në 87.11 mg . kg⁻¹ (mesatarisht 58.07 mg . kg⁻¹ dhe median 55.87 mg . kg⁻¹), ndërsa në ato nën kulturën e misrit 38.62 deri 64.11 mg . kg⁻¹ (mesatarisht 50.30 mg . kg⁻¹ dhe median 50.69 mg . kg⁻¹), duke mos i tejkaluar vlerat kritike sipas BE (300 mg . kg⁻¹).

¹²Studimi mbi Ndotjen e Tokës Bujqësore (SNTB) në Kosovë, Identifikimi i burimeve të ndotjes dhe propozimet për masat e përmirësimit, Janar 2015



Figura 8. Lokacioni dhe vendndodhja e metaleve të rënda

Po ashtu edhe përmbajtja e Zn në mostrat e dheut të analizuara nuk e ka tejkaluar pragun kritik spas BE (300 mg . kg⁻¹), duke u sjell nga 45.71 deri 110.32 mg . kg⁻¹ në tokat nën kulturën e grurit (mesatarisht 77.12 mg . kg⁻¹ dhe median 73.68 mg . kg⁻¹), përkatësisht 40.59 deri 82.48 mg . kg⁻¹ në tokat nën kulturën e misrit (mesatarisht 59.75 mg . kg⁻¹ dhe median 59.27 mg . kg⁻¹).

Eksplotimi i zhavorrit është shumë i shfaqur në Komunën e Glllogocit dhe atë shpesh guroret ndodhen në afërsi ngjitur me lumin Drenica, siç është rasti në Lagjen Cërvadiku, në zonën kadastrale të Poklekut dhe Çikatovë të Vjetër. Ndotja shkaktohet edhe nga deponitë ilegale që ndodhen në Abri e Epërme, Glllogoc, Gradicë, Komoran, Korroticë e Epërme, Korroticë e Poshtme, Krajkovë, Likoshan, Llapushnik, Negoc, Poklek, Polluzhë, Sankoc, Shtrubullojë, Shtuticë, Tërdec, Tërstenik, Vasilevë, Verboc, Vuçak dhe Zabel i Poshtëm dhe numri i tyre në disa vende është më i madh se 1 ndonëse numri i tyre është zvogëluar dukshëm viteve të fundit. Lokacioni i tyre është i paraqitur në hartë. Nga 80 deponi që janë eliminuar, mbesin edhe rreth 50 sosh ekzistuese¹³ në territor të komunës.

Ndotja nga zhurma - Ndotja akustike në komunën e Glllogocit është prezentë dhe kryesisht vjen nga rrugët nacionale, autoudha dhe hekurudha që kalojnë nëpër komunë, të cilat nuk kanë kurrfarë barrierash për mbrojtjen nga zhurma. Kjo manifestohet edhe si rezultat i veprimtarive të ndryshme të punës si aktivitetet e ndërtimit, gurëthyesit, pajisjet industriale, etj.

Komuna nuk ka të hartuar Planin e Veprimt dhe Hartën e zhurmës, me të cilat obligohet sipas Ligjit për mbrojtje nga zhurma Nr. 02/L-102. Këto dokumente duhet të identifikojnë lokacionet të nënshtruar zhurmës, prezantimin e tyre në hartë dhe propozimin e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes nga zhurma.

SIPËRFAQET ME NDOTJE TË LARTË (HOT SPOTET)

Kompleksi i industrisë së Feronikelit daton që nga viti 1984 dhe ka funksionuar deri në vitin 1998. Është pronësi private dhe llogariten si njëra ndër ndërmarrjet më të mëdha në Kosovë që bën prodhimin e hekurit dhe nikelit. Mbetjet hidhen në një hapësirë afër lumit Drenica duke krijuar kodra të skories. Deponia ka një sipërfaqe prej 24ha ndërsa zona e ndikimit 45 ha dhe konsiderohet si burim i ndotjes. Gjenerohen mesatarisht 1 milion ton m³ skorie në vit që ka përbërje kimike SiO₂, MgO, FeO dhe CaO.

¹³Raporti i performances komunale, Glllogoc 2017

Të dhënat mbi ekonominë lokale

Pasojat ekonomike të luftës të fundit kanë qenë të rënda dhe kanë ndikuar në shkatërrimin e shumë ndërmarrjeve në pronësi shoqërore dhe pasurinë e qytetarëve. Shumica e ndërmarrjeve ndërprenë aktivitetin e tyre dhe disa prej tyre nuk u riaktivizuan në nivelin e para-luftës. Ndërsa Kompleksi i Ferronikelit, pas luftës iu nënshtrua procesit të privatizimit. Bazuar në të dhënat rreth strukturës së eksportit, Ferronikeli kontribuon me mbi 50% të eksportit të gjithëmbarshtëm të Kosovës. Xehet eksportohen në mbarë botën: Itali, Gjermani, Belgjikë, Spanjë, Indi, Kinë dhe Kore¹⁴.

Pas fazës së rindërtimit komuna e Glogoc gradualisht ka filluar me rimëkëmbjen ekonomike dhe sociale. Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe krijimi i bizneseve të vogla, priten të luajnë rol thelbësor në rrugën drejt një ekonomie moderne të tregut të lirë dhe si rrjedhim edhe drejt zhvillimit dhe rritjes ekonomike.

Deri në fund të vitit, të vitit 2018 raportohet se në Komunën e Glogocit, janë **2,021**¹⁵, me rreth 90% prej tyre të regjistruar si mikro-ndërmarrje. NVM-te përbëjnë motorrin e zhvillimit ekonomik dhe pritët që do të sigurojnë vende të reja të punës, rritje dhe prosperitet ekonomik nën kushtet e një kornizë të favorshme ligjore dhe institucionale që mundëson treg të lirë dhe konkurrencë të barabartë. Komuna e Glogocit, ngjashëm me komunat e tjera të Kosovës, ende nuk ka arritur t'i tejkalojë problemet e papunësisë dhe varfërisë.

Shkalla e papunësisë

Shkalla e lartë e papunësisë, vazhdon të jetë një nga sfidat kryesore të ekonomisë së Kosovës, e cila reflektohet me probleme të shumta në shoqëri. Shkalla e papunësisë në nivel të Kosovës sipas Anketës së Fuqisë Punëtore 2017¹⁶ është 30.5% dhe llogaritet të jetë më e larta në rajon. Në këtë mes, niveli i papunësisë është më i lartë për femrat se sa për meshkujt dhe qëndrojnë në raport 36.6 % krahasuar me 28.7 %. Të gjithë parametrat kryesore ekonomik, janë të publikuar në nivel të Kosovës, dhe nuk ka të dhëna të sakta mbi shkallën e papunësisë në nivel komunal. Megjithatë, hulumtimet e ndryshme vlerësojnë se papunësia edhe në nivel të komunës është e lartë.

Në anën tjetër faktorët social i kanë ndihmuar kësaj gjendjeje të papunësisë ku niveli i ulët i arsimimit (me theks të veçantë tek femrat), familjet e mëdha në numër dhe popullsia kryesisht agrare.

¹⁴ Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Glogocit 2015-2019

¹⁵ Administrata Tatimore e Kosovës, 2018

¹⁶ Anketa e Fuqisë Punëtore 2017, ASK

Gjinia	Numri i punëkërkuessve të regjistruar	%
Meshkuj	2,061	57,4
Femra	1,527	42,5
Gjithsej	3,588	

Tabela 9. Numri i punëkërkuessve të regjistruar në zyrat e punësimit, shtator 2017

Bazuar në të dhënat nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës, numri kumulativ i punëkërkuessve të regjistruar në Komunën e Glllogocit, në shtator të vitit 2017 ishte 3,588 persona. Megjithatë, ky numër mendohet të jetë më e lartë për faktin se një numër i konsiderueshëm i personave të papunë nuk paraqiten në këtë zyre. Ndërsa bazuar në Raportin Puna dhe Punësimi në Kosovë¹⁷, ky numër në vitin 2018 ishte 3,067.

Kur të analizohet struktura e punëkërkuessve sipas gjinisë, vërehet se papunësia më e lartë është e shprehur tek gjinia mashkullore, me 57,4% të kontingjentit të përgjithshëm të punëkërkuessve.

Shkalla e punësimit

Në Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP), për vitin 2017 është 29.8%, apo 357,651 persona. Punësimi me i lartë është te meshkujt (46.6%), ndërsa punësimi te femrat është 12.7%. Femrat janë të punësuar, kryesisht në sektorët e arsimit, kujdesit shëndetësor dhe tregtisë, me 48.4 % të tyre, ndërsa meshkujt janë kryesisht të punësuar në sektorët e ndërtimtarisë, tregtisë dhe prodhimit, me 45.9%. Ngjashëm sikurse me shkallën e papunësisë, Anketa e Fuqisë Punëtore (2017) nuk ofron informacion mbi nivelin e punësimit në nivel komunal. Sigurimi i shifrave të përafërta të punësimit, në komunë të Glllogocit ngjashëm sikur se edhe në komunat tjera mbetet sfidë. Të dhënat e siguruar nga Komuna e Glllogocit, dëshmojnë që aktualisht në Komunën e Glllogocit janë të punësuar rreth 6,235 persona. Bazuar në regjistrimin në teren të zhvilluar në 2019 nga DZHE, del se numri i të punësuarve në sektorin privat është 2841, duke mos e përfshirë numrin e saktë të të punësuarve në sektorin e ndërtimtarisë, për shkak se një pjesës së bizneseve të tilla nuk i dihet adresa e saktë. Ashtu siç, prezantohet në grafikun në vijim punësimi në këtë komunë ka pasur një trend pozitiv duke u rritur nga viti në vit. Siç mund të vërehet në mes të vitit 2013 dhe 2018 punësimi në këtë komunë është rritur për mbi 20%, nga 5,206 të punësuar në vitin 2013 në 6,235 në vitin 2018. Edhe pse shifra e raportuar e të punësuarve në krahasim me numrin e përgjithshëm të popullsisë së Glllogocit, vazhdon të jetë ende ulët. Ajo çfarë mund të shihet në tabelën e mëposhtme është se, sektori i "Tregtisë me shumicë dhe pakicë" punëson numrin më të madh të të punësuarve në këtë komunë (30%), pasuar nga sektori i "Xeheroreve dhe Gurethyesit" (15%), ku përfshihet punësimi në NewCo Ferronikel. Ndërsa, sektori i "Transportit dhe magazinimit" përfaqëson sektorin e tretë ekonomik sipas numrit të të punësuarve me 12.0%. Këto të dhëna dëshmojnë për një ndërrim në strukturën e të punësuarve në Komunën e Glllogocit, krahasuar me vitet e 90-ta, nga sektori i prodhimit/ industrisë nxjerrëse në atë të

¹⁷ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Social, Agjencia e Punësimit

tregtisë. Ajo çfarë bie në sy është që numri i të punësuarve në sektorin e bujqësië vazhdon të jetë ende i ulët, me vetëm 4%. Poashtu të dhënat e prezentuara nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, tregojnë që struktura e punësimit sipas sektorëve nuk ka pësuar ndryshime të theksuara në mes të viteve 2013 dhe 2018.




Tabela 10. - Grafiku për numrin e të punësuarve nëpër vite, 2011-2018

Ndërsa analizuar në aspekt gjinor, vërehet se ekziston një pabarazi e lartë e punësimit, në favor të gjinisë mashkullore. Rreth 84 % e të punësuarve i takojnë gjinisë mashkullore ndërsa vetëm 16% asaj femërore¹⁸. Nga regjistrimi i bizneseve i zhvilluar në teren në verën e vitit 2019 nga DZHE, vërehet se kjo pabarazi ka filluar të zvogëlohet, ku del se rreth 7% e të punësuarve janë burra, kurse 28% e tyre janë gra. Ky numër i grave ka mundësi të jetë pak më e vogël, kur merret parasysh që gjatë regjistrimit nuk ka mundur të përfshihet numri i saktë i të punësuarve në sektorin e ndërtimtarisë (ku dominon gjinia mashkullore), sepse se një pjesës së bizneseve të tilla nuk i dihet adresa e saktë.

Niveli i varfërisë

Një prej parametrave thelbësor për mirëqenien e një vendi është shkalla e punësimit. Niveli i lartë i papunësisë në vend është një prej katalizatorëve kryesor të zgjerimit të varfërisë në vend. Duke u bazuar në të dhënat e Mirëqenies Sociale nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2017 në komunën e Glogocit, janë gjithsej 1,223 ekonomi familjare të përfshira në programin për asistencë sociale, apo gjithsej 5,459 persona. Kjo, shifër paraqet rreth 9% të gjithë popullësisë së vlerësuar në Glogoc (Glogoc) (59, 752¹⁹). Gjatë vitit 2018, sipas të njëjtit burim, ka pasur mesatarisht 1,189 ekonomi familjare të përfshira në skemën për ndihmë sociale. Në të njëjtën kohë, bazuar në gjendjen e muajit dhjetor 2017, Komuna e Glogocit, paraqet komunën me numrin më të madh të përfituesve nga skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës. Numri i përfituesve në këtë komunë ishte 1,245 apo 9.9 % e numrit të përgjithshëm të përfituesve në nivel të Kosovës.

Sipas të të dhënave nga regjistrimi i vitit 2011, vetëm 12% e banorëve mbështeten në të hyrat nga punësimi, që është për 10.4% nën nivelin e Kosovës. Të ardhurat nga skema e pensioneve dhe mirëqenies sociale janë gjithë shumë të ulëta - 4.9% e banorëve mbështeten në të hyrat

¹⁸Regjistrimi i Popullësisë nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës, 2011

¹⁹ Regjistrimi i Popullësisë 2011, ASK

nga pensionet bazë (2016), e 9% në ndihma sociale (2017). Shikuar përgjithësisht, niveli i varfërisë në komunë mbetet i lartë.

Ambienti i biznesit

Në vitet e fundit qeverisja lokale në Glllogoc ka zbatuar një sërë masash reformuese me qëllim të përmirësimit të ambientit të biznesit në komunë. Si rrjedhojë e këtyre reformave, tani NMV-të regjistrohen përmes Qendres Komunale për Regjistrimin e Bizneseve. Politikat zhvillimore lokale në komunën e Glllogocit kanë luajtur rol thelbësor në përmirësimin e ambientit të të bërit biznes. Bashkëpunimi i pushtetit lokal me bizneset e vogla dhe të mesme vlerësohet si çelës i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik lokal, e në këtë segment Komuna e Glllogocit ka bërë disa përmirësime në aspektin ligjor dhe administrativ. Një prej zhvillimeve të rëndësishme në drejtim të krijimit të ambientit të përshtatshëm për biznes ishte vendimi për themelimin e Parkut të Biznesit. Nga viti 2012 deri në vitin 2014 Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë në bashkëpunim me Komunën e Glllogocit ka vazhduar me investimet e veta për të ofruar kushte më të mira për të bërë biznes brenda Parkut të Biznesi. Sot ky park është funksional, dhe vetëm në këtë Park janë të vendosura 43 biznese, që operojnë në sektorin e prodhimit dhe shërbimeve. Çdo ngastër ka qasje direkte në rrugët kryesore të Parkut si dhe ka kycjen individuale në rrjetin kryesor të parkut me kanalizim, ujë, telefoni, internet, etj. Poashtu, Komuna ka hartuar dhe plotësuar një mori rregulloresh, që ndërlidhen me mjedisin afarist- si uljen dhe heqjen e taksës komunale, lehtësira për të hapur biznese të reja dhe disa hapa të tjerë të politikave biznesore mbrenda kompetencave të saja, në interes të Komunitetit të Biznesit.

Në rregullorën komunale për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa, të aprovuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit janë liruar nga taksa komunale këto veprimtari²⁰:

- Të gjitha bizneset e vogla të kësaj katgorie si: DPT, DPSH, DPZ, DPH etj;
- Zejet e vjetra - artizanatet
- Të gjitha biznesët e lëmisë së Bujqësisë
- Për një vit të gjitha biznesët e regjistruara në vitin e parë të afarizmit;
- Për 3 vite të gjitha biznesët fillestare prodhuese

Bazuar në shënimet e siguruar nga Administrata Tatimore e Kosovës gjatë vitit 2018, në Komunën e Glllogocit kanë qenë rreth 2,056 tatimpagues aktiv, përfshirë këtu edhe OJQ-te, organizatat buxhetore dhe ndermarrjet në pronësi publike dhe shoqërore. Ndërsa numri i ndërmarrjeve aktive në pronësi private, gjatë vitit 2018 ishte rreth 2021. Nga këto kompani, pjesa dërmuese e tyre rreth 84% janë biznese individuale/persona fizik. Ndërsa rreth 15% të bizneseve janë të regjistruara si shoqëri me përgjigjësi të kufizuara. Pjesëmarrja e formave tjera të bizneseve të regjistruara është e ulët.

²⁰ Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Glllogocit 2015-2019

Nr.	Lloji i pronësisë	Numri ndermarrjeve	i %
1	Biznes individual	1,693	84%
4	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K)	295	15%
2	Ortakëri e përgjithshme dhe e kufizuar	5	0%
5	Kompani e huaj	8	0%
6	Te tjera	19	1%
	Gjithsej	2,021	

Tabela 11. Numri i ndërmarrjeve sipas llojit të pronësisë, në % (Burimi: ATK, 2018)

Ndërsa në bazë të regjistrimit në teren të bërë në vitin 2019 nga ana e zyrtarve të DZHE, del se janë 950 biznese aktive të cilave iu dihet adresa e saktë. Ky numër mund të jetë paksa më i madh, duke qenë se nuk dihet numri i biznese aktive që merren me ndërtimtari sepse nuk i dihet adresa dhe rrjedhimisht nuk kanë mundur të regjistrohen. Analizuar në aspekt të sektorëve ekonomik, shihet se numri më i madh i ndërmarrjeve, rreth 38% të tyre janë të regjistruara në sektorin e “Tregtisë dhe shumicë dhe pakicë”, pasuar nga sektori i “Ndërtimtarisë” (15%) dhe “Transporti dhe magazinimi” (13%). Kjo strukturë e ndërmarrjeve vërehet se nuk ka ndryshuar shumë ndër vite, dhe është e ngjajshme me strukturën e regjistrimit të ndërmarrjeve në nivel të Kosovës. Ngjajshëm sikur në analizën e punësimit, ajo çfarë bie në sy është fakti që përfaqësimi i bizneseve në sektorin e “Bujqësisë, Pylltarisë dhe Peshkimi”, gjatë vitit 2018, ka qenë në nivel të ulët si për nga numri i kompanive që kanë po ashtu edhe për nga numri i punëtorëve (Tabela numër 4 në Aneks). Përderisa në të kaluarën, bartëse kryesore e zhvillimit të ekonomisë në Glllogoc ka qenë Industria përfshire sektorin e xeheroreve, me një pjesëmarrje relativisht të lartë të të punësuarëve në këtë sektor. Sot në sektorin e industrisë përpunuese se bashku me xeherore aktualisht janë të regjistruara rreth 300 ndërmarrje ose 7% e totalit të ndërmarrjeve të regjistruara. Në këto dy sektore janë të punësuar mbi 20% të të punësuarve në këtë komunë. Feronikeli luan një rol të rëndësishëm, duke punësuar numrin më të madh të qytetarëve të kësaj komune në këtë sektor. Ndërsa që Sektori i Tregtisë, prinë për nga numri i të punësuarëve me 30% e të punësuarëve në sektorin privat.

Seksioni- Titulli	Ndermarrje (%)			
	2011	2012	2013	2018
A- Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	4%	6%	6%	5%
B- Xeheroret dhe gurëthyesit	0%	0%	0%	0%
C- Industria përpunuese	6%	8%	9%	7%
D- Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim	0%	0%	0%	0%
E- Furnizimi me uje; kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet	0%	0%	0%	0%
F- Ndërtimtaria	13%	14%	14%	15%
G- Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe	41%	36%	36%	38%
H- Transporti dhe magazinimi	11%	11%	11%	13%

I- Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	7%	7%	6%	6%
J- Informimi dhe komunikimi	2%	2%	2%	2%
K- Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	0%	0%	0%	0%
L- Aktivitetet e patundshmërive	0%	0%	0%	0%
M- Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	0%	0%	0%	0%
N- Aktivitetet administrative dhe shërbimet mbështetëse	1%	1%	1%	1%
O- Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i obligativ	0%	0%	0%	0%
P- Arsimi	1%	1%	1%	1%
Q- Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	1%	1%	1%	1%
R- Arte, argëtimi dhe rekreimi	2%	2%	2%	1%
S- Aktivitetet tjera shërbyese	10%	10%	10%	10%
T- Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; mallera të	0%	0%	0%	0%
U- Aktivitetet e organizatave dhe organeve të huaja	0%	0%	0%	0%
Gjithsej	100%	100%	100%	100%

Tabela 12. Ndermarrjet ekonomike, sipas sektoreve ekonomik, 2011- 2018

1.5 Bujqësia

Të dhënat për bujqësinë lokale sipas kulturave bujqësore, pemëtaria, perimet, blegtoria, etj. Poashtu ndonje informatë që ka referencë për mbeturina është e dobishme të ceket.

Bujqësia, pemtaria dhe blegtoria - Bazuar në analizat hipsometrike të territorit të komunës, dy të tretat e territorit të komunës janë pjesë rrafshinore. Pjesa e rrafshët e komunës e sidomos lugina përgjatë lumit “Drenica” është tokë me potenciale të mundshme për zhvillimin e bujqësisë intensive dhe zhvillim të agro-industrisë. Lumi “Drenica”, kanali i sistemit ujitës Ibër-Lepenc si dhe lumi Verbofc janë faktorë të rëndësishëm në zhvillimin e bujqësisë. Klima kontinentale me të reshura mesatare krijojnë kushte shumë të volitshme për zhvillimin e bujqësisë.

Vlerësimi i tokës bujqësore - Toka në komunën e Glogocit dallon nga ajo e punueshme deri të pyjet. Bazuar në të dhënat që posedon Komuna, gjatë vitit 2017 kjo komunë ka pasur rreth 14,389.00 ha tokë bujqësore, përkatësisht 52.21% të territorit të komunës dhe 9,885.40 ha tokë pyjore. Nga sipërfaqja e tokës bujqësore (ara dhe kullosa), toka bujqësore e kultivuar përfshinë 8182 ha, përkatësisht 0.13 ha për kokë banori, bazuar në të dhënat nga Regjistrimi i Bujqësisë, i zhvilluar nga Agjencia i Statistikave të Kosovës (2014). Nga mënyra e shfrytëzimit me të mbjella mund të thuhet se drithërat kultivohen në sipërfaqe më të madhe, prej rreth 75% të totalit të tokës së punueshme. Sipërfaqet me peme dhe perime përfshijnë 159 ha, ose 0.6% të territorit të komunës. (perime 47 ha, pemë 112 ha).

	Sip ha	%	Boniteti - Sa i përket cilësisë së tokës, përkatësisht përshtatshmerisë, Glogoci karakterizohet me tokë cilësore me rreth 61.2 %, që është tokë e cilësisë së mirë e kategorisë I-IV, që përfshinë kryesisht pjesët qendrore dhe veriore të komunës. Pjesa tjetër e territorit, 38.7 %, është tokë e
Klasa 2	9007	32.7	
Klasa 3	1876	6.8	
Klasa 4	6002	21.8	

Klasa 5	1635	5.9	cilësisë më të ulët me kategori V-VIII, që përfshinë kryesisht pjesët perendimore dhe jugore të komunës. Në komunën e Glllogocit dominon sipërfaqja e tokës me kategorinë nr. 2, 6 dhe 4. Në tabelë janë të paraqitura sipërfaqet dhe përqindjen.
Klasa 6	8169	29.6	
Klasa 7	874	3.2	
Total:	27563	100.0	

Tabela 13. Klasat e tokës në komunën e Glllogocit

Lavërtaria - Ndër kulturat bujqësore me dominuese në Komunën e Glllogocit janë kulturat tradicionale gruri dhe misri, produkte këto me të cilat arrihen rendimente të larta. Grafiku në vijim, dëshmon që prodhimtaria në secilën prej kulturave të drithërave ka shënuar ngritje. Në përgjithësi, prodhimi drithërave në Komunën e Glllogocit, ndjeke mesataren e prodhimit të drithërave në nivel të Kosovës.

Pemtaria - Bazuar në të dhënat nga Regjistrimi i Bujqësisë për vitin 2014, janë rreth 112 ha apo rreth 155,227 trupa të pemëve, që mbillen me pemë në Komunën e Glllogocit. Rreth 75% e kësaj sipërfaqe është e mbjellë me Mollë, që paraqet llojin më të shpeshtë të kultivuar. Ngjashëm me rastin e drithërave dhe perimeve, trend pozitiv vërehet edhe në rritjen e prodhimtarisë së pemëve nga viti në vit. Në total, është shënuar rritje prej afër 40% në rendimentin e pesë kulturave kryesore të pemëve (t/ha) në vitin 2018 krahasuar me vitin 2013. Shprehur në vlerë prodhimtaria e pemëve në këto pese kultura (Molla, dardha , kumbull, arra dhe dredhëza) është rritur nga 65t/ha në vitin 2013 në 90 t/ha në vitin 2018.

Blegtoria - Kualiteti i tokës, kushtet klimatike, burimet me ujë dhe struktura e popullsisë paraqesin potencial për zhvillimin blegtorisë. Gjedhet, delet dhe dhitë- prodhimi i mishit dhe bylmetit, paraqesin një prej prioritetëve të zhvillimit agro-ekonomik të komunës së Glllogocit. Zhvillimi i kësaj veprimtarie primare do të mundësoj edhe zhvillimin ekonomik të vendbanimeve të kësaj ane, por njëkohësisht do të mundësoj edhe zhvillimin e bizneseve në zonën aktive zhvillimore për shkak të posedimit të kushteve më të përshtatshme infrastrukturore. Bazuar në të dhënat nga Regjistrimi i Bujqësisë për vitin 2014, Glllogoci posedon rreth 6,692 ha me livadhe dhe kullota. Kjo sipërfaqe, paraqet potencial të kënaqshëm të kësaj komune për zhvillimin e blegtorisë.

1.6 Turizmi lokal

Të përshkruhet turizmi lokal, natyra e tij, të dhëna të kapaciteteve dhe pushuesve, sezona turistike, etj.

Komuna e Glllogocit karakterizohet me potenciale të shumta të zhvillimit të turizmit vikendor, natyror, kulturore dhe rural. Gjeomorfologjia e territorit të komunës së Glllogocit e karakterizuar me masive malore, Çyçavica, Vargmalet e Berishës e Kosmaçi i japin vlerë konkurruese komunës së Glllogocit në Kosovë për zhvillimin e turizmit. Pozita qendrore e komunës së Glllogocit si dhe lokacionet interesante turistike sikurse janë Kalaja e Verbovcit,

Liqeni i Vasilevës, lumenjtë Drenica dhe Verbica, Gryka e “Gurit të Plakës”. Guri i Gradinës, Kalaja e Vuçakut, Pishat e Gilobarit etj, janë vetëm disa nga resurse të vlefshme dhe mjaft atraktive për zhvillimin e turizmit. Komuna e Glllogocit ka potencial shumë të mirë edhe për zhvillimin e turizmit të shpellave për faktin se në territorin e kësaj komunë shtrihen disa shpella interesante sikurse janë: Shpella e Peshterrit në Nekovc, Shpella e Kizharekës, Shpella e Kokilit në Verboc, Shpella e Baicës dhe Shpella e Gllanasellës. Gjithashtu, edhe hoteleria është mjaft e zhvilluar, ku në komunën e Glllogocit janë rreth 60 biznese hoteliere, që prezantojnë një infrastrukturën aktuale për pritjen dhe sistemimin e turistëve. Rëndësi dhe vlera tjera turistike në komunën e Glllogocit janë edhe objektet ose monumentet e trashëgimisë kulturore, të cilat janë të krijuara në periudha të ndryshme historike si Kalaja e Verbocit dhe Kalaja e Vuçakut etj. Gjithashtu vlerësohet edhe trashëgimia më e re që ka vlerë të veçantë si shumë lapidare të tërënëve për çlirimin e Kosovës, komplekse memoriale dhe monumente tjera të ndryshme që pasqyrojnë ofertën turistike në këtë komunë. Glllogoci është njohur edhe për organizimin e ngjarjeve të ndryshme kulturore që mund të tërheqin turistë të ndryshëm. I tillë është Festivalit të grupeve kulturo-artistike mbare shqiptare që është pa dyshim një prej manifestimeve më të vjetra si dhe Festivali i Grupeve Kulturo-artistike të shkollave fillore. Edhe pse turizmi ka rëndësi të madhe në zhvillimin ekonomik dhe atë kulturor të një zone, zhvillimi i tij i pakontrolluar ka ndikim negativ në mjedis e ne veçanti në ekosistemet natyrore si rezultat i hedhjes së pakontrolluar e mbeturinave, dëmtimit të resurseve natyrore dhe biodiversitetit. Me qëllim të zvogëlimit të këtij ndikimi krahas aspektit ekonomik, turizmi duhet ti kushtojë vëmendje edhe mbrojtjes së mjedisit, andaj si një formë e avancuar e turizmit sot njihet ekoturizmi apo turizmi i qëndrueshëm. Duhet theksuar se Liqeni i Vasilevës është potencial që gjeneron mundësi të jashtëzakonshme për zhvillim të ekoturizmit ku mund të organizohet peshkimi dhe ecja në natyrë.

1.7 Arsimi

Të dhënat për arsimin publik dhe privat, përgjegjësia institucionale, numrin e institucioneve shkollore të të gjitha niveleve, numrin e nxënësve dhe studentëve, etj. Ndonjë e dhënë për menaxhim të mbeturinave është me interes që të ceket.

Organizimi i arsimit në komunën e Glllogocit realizohet në katër nivele edukativo-arsimore: parashkollor-0, fillor-1, arsimi i mesëm i ulët-2 si dhe i mesëm i lartë-3. Në komunën e Glllogocit gjatë vitit 2018-2019 janë përfshirë në sistemin arsimor 136 fëmijë dhe 13,088 nxënës. Ndërsa, personel të angazhuar si mësues, arsimtar dhe profesorë janë 954 të punësuar (418 gra dhe 846 burra), derisa 168 të angazhuar të tjerë janë punëtor teknik.

Komuna e Glllogocit përfshin 33 institucione arsimore publike, si dhe 2 qerdhe private (shih shtojcën). Duke u bazuar në Norma Teknike të Planifikimit Hapësinor ²¹komuna e Glllogocit plotëson kriterin e mbulueshmërisë (shih hartën). Për të gjithë nxënësit të cilët janë në largësi

²¹<https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14822>

më shumë se 4 km komuna mundëson ofrimin e transportit. Numri i nxënësve është në rrënjë ku në vitin shkollor 2017/2018 kishte 150 nxënës më pak se vitin shkollor paraprak.

Përshkrimi	QEAP-Qerdhe	Institucione parashkollore	Shkolla fillore	Shkolla mesme	të
Institucione	2	30	30	2	
Edukator / Arsimitarë / Profesore	22	49	555	171	
Fëmijë / Nxënës	136	1052	9,984	3,108	
Punëtor administrativ			37		

Tabela 4. Numri i institucioneve, edukatorëve, nxënësve dhe punëtorëve arsimor

Gjatë kohës së hartimit të këtij dokumenti është duke u realizuar ndërtimi i shkollës së mesme profesionale “FehmiLladrovi” në Komoran që përfshin 24 klasë me nga 8 paralele, profilet profesionale nuk janë të caktuara. Sistemi i mësimi parafillor është i organizuar në kuadër të shkollave dhe funksionon sipas normave në fuqi. Në total është 1 qerdhe publike në Glllogoc dhe një pjesë e saj në Komoran, 2 qerdhe private në komunën e Glllogocit dhe një e re do të ndërtohet në Glllogoc, për të cilën është siguruar donacioni nga komisioni Evropian. Lokacioni i shkollave është i mirë dhe i qasshëm, përjashtim bëjnë shkollat në Zabel, Polluzhë, Tërstenik të cilat ndodhen në afërsi të rrugëve me frekuentim të lartë. Gjendja fizike e objekteve të mirë, mirëpo duhet theksuar që atyre iu mungon infrastruktura për një shkollë moderne. Vetëm shkolla profesionale do të posedojë palestër sportive, përderisa në 3 shkolla tjera janë të ndërtuara palestrat sportive (“Xheladin Gashi”, “Hasan Prishtina” dhe “7 Marsi”).

Analfabetizmi në komunë është prezentë edhe pse nuk dëshmohej me të dhëna statistikore. Nuk është shënuar ndonjë praktikë e braktisjes së shkollimit dhe nuk ka të dhëna për nxënës të cilët nuk kanë shkuar në shkollë fare. Komuna e Glllogocit ka 57 nxënës me nevoja të veçanta dhe shpërndarja e tyre është pothuajse në tërë komunën. Transporti i tyre mundësohet nga komuna por duhet t’iu sigurohet mësues mbështetës dhe integrimi social. Sa i përket cilësisë në arsim, 85% është kalueshmëria e testit të maturës në gjimnaz, ndërsa në SHMP rreth 61%.

Në tërësi, institucionet arsimore mbulojnë rreth 47.96 ha (apo 470,960m²), të cilat janë në shërbim të numrit përgjithshëm të banorëve (58,531sipas regjistrimit zyrtar në vitin 2011). Duke iu referuar normave minimale (normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve të arsimit para-universitar: ndërtesat e shkollave fillore 1.60 m²/banor; ndërtesat e shkollave të mesme të ulëta 1.20 m²/banor; si dhe ndërtesat e shkollave të mesme të larta 1.00 m²/banor) është bere kalkulimi i hapësirës ekzistuese dhe çdo kërkesë për rritje në të ardhmen.

1.8 Shëndetësia

Gjendja ekzistuese dhe problemet - Komuna e Gllogocit sa i përket shëndetësisë ofron kujdesin parësor për gjithë territorin e komunës dhe në total janë: 1 Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF); 5 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF), 7 Ambulanca të Mjekësisë familjare (AMF) apo Ambulantë siç njihet në termin më të zakonshëm.

Edhe pse i gjithë territori është i mbuluar me shërbime, QKMF në Gllogoc është e mbingarkuar me pacientë për shkak që mjeku në QMF-të dhe AMF-të punon një herë në javë.

Në Kujdesin Parësor Shëndetësor (KPSH) në Gllogoc, numri i mjekëve është 39 plus 5 mjekë në marrëveshje me Caritas Kosova për kohë të caktuar (3 vite), 119 infermierë dhe 3 stomatologë. Sipas Udhëzimit Administrative duhet të jetë 1 stomatolog në 6000 banorë. Kujdesi shëndetësor dytësor ofrohet në komunën e Prishtinës.

Përkujdesja Sociale - Qendra për Punë Sociale (QPS) gjendet në qendër të qytetit në një objekt të vjetër që nuk përmbush normat për funksionin që ka. Këtu kryhen të gjitha shërbimet sipas mandatit të kësaj qendre nën administrimin e DSHMS në vijë të drejtë me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Hendikosi operon si OJQ dhe është e vendosur në një hapësirë provizore brenda hapësirave të QKMF-së dhe subvencionohet nga komuna.

Sa i përket banimit social janë 2 objekte shumë banesore në gjendje jo shumë të mirë dhe që shfrytëzohen nga familjet/banorët me asistencë sociale. Në të ardhmen duhet të punohet më shumë në integrimin e familjeve me asistencë sociale dhe të shmanget banimit social kolektiv ngase është duke ndikuar negativisht në shtimin e numrit të këtyre familjeve dhe mos-interesimin e tyre për punësim.

Gllogoci nuk ka jetimore e as shtëpi të pleqve. Qendra për Punë Sociale fëmijët jetim i strehon tek familjet strehuese ose tek të afërmit ndërsa të braktisur apo të dhunuar dërgohen në strehimore për mbrojtjen e gruas dhe fëmijëve në Prishtinë, në koordinim me Departamentin e Politikave Sociale Familjare (DPSF).

Nën menaxhimin e Ministrisë Për Punë dhe Mirëqenie Sociale është objekti i shtëpisë integruese, institucion i cili ofron shërbime mjekësore për trajtimin e personave me probleme mendore/rehabilitim të rasteve me sëmundje mentale (qëndrim ditorë). Në objektin e vjetër të komunës është e vendosur "Qendra për rehabilitimin e grave të dhunuara" e para e këtij lloji në Kosovë.

Institucionet publike

Komuna e Gllogocit ka një numër të objekteve të cilat administrohen nga administrata komunale. Përpos dy objekteve të komunës i vjetri dhe i riu, komuna administron me qendrën e shërbimit të zjarrfikësve, qendrën për të riatdhësuar, qendrën rinore, zyrat e gjendjes civile në 5 nën qendrat e komunës (në Arllat, Komoran, Tërstenik, Dobroshec, Abri e Epërme).

Pjesë e administratës publike që gjendet nën menaxhim të ministrive të linjës janë stacionet policore të cilat gjenden në qytetin e Glogocit dhe një nënstacion në Komoran.

Dokumentet relevante komunale

Planet e mëposhtme duhet të përshkruhen për qfarë periudhe janë dhe a përmbajnë ndonjë element sa i përket MM.

- Plani i zhvillimit komunal

I hartuar për periudhën kohore 2020 – 2028, **me vizionin:** “ Të gjitha rrugët kalojnë nëpër Glogoc “. Në zemër të Kosovës, Glogoci me ekonomi të bazuar në zhvillim të qëndrueshëm rural, përkrahje të bizneseve, industrisë dhe infrastrukturës funksionale. Banim e shërbime cilësore, ku qytetari është në qendër të vëmendjes e rinia e aftësuar profesionalisht; Mjedis të qëndrueshëm e shfrytëzim racional të resurseve natyrore, promovim të trashëgimisë kulturore, turizmit e sportit. Në kuadër të këtij plani është përfshirë **qëllimi** “përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në tërë territorin e komunës”, **objektiva:** “Ngritja e kapaciteteve teknike të kompanisë operuese publike në 3 vitet e ardhshme”.

- Plani i mbrojtjes së mjedisit

Komuna e Glogocit ka të përpiluar Planin Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM) i cili është dokument planifikues - strategjik, për të adresuar zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal. Duke u bazuar në këto probleme mjedisore në të cilën janë përcaktuar prioritetet mjedisore për periudhën 5 vjeçare (2020 – 2024). Qëllimi i Planit Lokal për Veprim në Mjedis është që të identifikoj dhe ofrojë zgjidhje për problemet prioritare mjedisore në Komunën e Glogocit, duke synuar në një menaxhim efektiv të tyre, duke i vendosur ato në agjendën e institucioneve përgjegjëse dhe duke marrë në konsideratë në mënyrë të vazhdueshme opinionin e publikut. Objektivat specifike të Planit Lokal për Veprim në Mjedis janë: Të bëjë vlerësimin e gjendjes ekzistuese të mjedisit dhe ndikimeve në mjedis nga sektorët e ndryshëm zhvillimor, të identifikoj dhe përcaktoj problemet kryesore mjedisore në territorin e Komunës së Glogocit, të identifikoj dhe përcaktoj prioritetet kryesore që do të adresohen në kuadër të PLVM-së për periudhën 5 vjeçare, të planifikohen dhe përcaktohen afatet, aktivitetet dhe projektet që do të ndërmerren për zbatim në adresimin e prioriteteve të identifikuara. Vizioni i këtij plani, synon qytetin e Glogocit me një mjedis të pastër, zhvillim ekonomik të qëndrueshëm me prioritet zhvillimin e bujqësisë, si dhe promovim të trashëgimisë kulturore dhe turizmit. Ky vizion është në harmoni edhe me dokumentet tjera të Komunës së Glogocit e veçanërisht me Planin Zhvillimor Komunal 2020 -2028.

- Harta zonale

Harta Zonale të Komunës (HZK) 2022-2030, i ofronë qeverisjes komunale një instrument për planifikim të qëndrueshëm hapësinor dhe për kontroll të zhvillimit. HZK është dokument multi-sektorial me karakter rregullues, përmes së cilës definohet në hollësi ndarja e territorit të komunës së Glogocit në zona (të tilla si hapësirat e lira, banim, industri, bujqësia, aktivitetet

ekonomike, etj.), ku për secilën zonë përcaktohen shfrytëzimet e lejuara dhe ato të ndaluara të tokës, kushtet zhvillimore dhe ato të ndërtimit si dhe masat e veprimit për periudhën së paku 8 vjeçare.

2 Gjendja ekzistuese e menaxhimit të mbeturinave

2.1 Të dhënat për mbeturina në komunë

Gjenerimi dhe kompozicioni i mbeturinave:

Nga analizimi dhe përpunimi i të dhënave të raporteve nga komuna dhe operatori për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave komunale KRM "Pastrimi" Sh. A. njësia operative në Glllogoc janë nxjerr të dhënat për sasinë e grumbulluar të mbeturinave komunale gjatë vitit 2021. Duhet të cekim se nuk janë bërë analiza për kompozicion të mbeturinave në nivel të komunës. Bazuar në raportin e komunës dhe operatorit, prej sasisë totale 7458 tonë të mbeturinave të grumbulluara nga 7447 ekonomi familjare të shërbyera që është vlerësuar në 60721 banorë, rezultojnë se gjenerimi i mbeturinave komunale për kokë banori në komunën e Glllogocit për vitin 2021 të jetë përafërsisht 123kg/banor/vit.

Tabela 15: Bilanci i mbeturinave komunale

Kategoria	Mënyra e përcaktimit të sasisë	Mbeturinat e grumbulluara			Mbeturinat e dorëzuara		
		Nga operatorët e grumbullimit	Nga ricikluesit	Nga deponitë ilegale	Mbeturinat e ricikluara	Mbeturinat e tregtuara	Mbeturinat e deponuara
Letër dhe karton							
Qelq							
Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat							
Tekstil dhe veshjet							
Pllastika							
Metal							
Mbeturina mikse komunale	ton	7458					7458
Mbeturinat tjera komunale ²²							
Total:							

2.2 Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Operatorët e shërbimit të grumbullimit dhe transportit

Aktualisht shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në tërë teritorin e komunës së Glllogocit ofrohet nga operatori KRM "Pastrimi" SH.A., njësia operative në Glllogoc.

Tabela 16: Operatorët e mbeturinave nën përgjegjësi komunale

	Emri i operatorit (biznesit)	Forma e pronësisë	Kategoria e menaxhimit të mbeturinave	Mbulimi me shërbim %	Statusi i kontraktimit (po/jo)
Operatori 1	Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" SH.A.	Aksionar	Mbeturina Komunale	84.76	Po

²² Mbeturinat bio-degraduese nga parqet, mbeturinat nga tregjet, etj.

Operatori 2				
Tabela 17: Operatorët tjerë të mbeturinave që operojnë në territorin e komunës				
	Emri i operatorit (biznesit)	Forma e pronësisë	Kategoria e mbeturinave të menaxhuara	Sasia e mbeturinave të menaxhuara
Operatori 1	Princi Company	Kompani Private e kontraktuar	Medicianle (shiringa, gjilpëra etj.) dhe organike (placenta etj.)	3,545.85 kg
Operatori 2				

Mbulimi me shërbim:

Shërbimi themelor që komuna dhe operatori aktualisht e ofrojnë për qytetarët sa i përket mbeturinave komunale, është mbledhja, transporti dhe deponimi përfundimtar në deponin regjionale të Prishtinës në Mirash-Obiliq.

Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave për ekonomitë familjare deri në fund të vitit 2021 në komunën e Gllgocit ka arritur në 84.76 %.

Tabela 18: Mbulimi me shërbim në territorin e komunës						
Emri i operatorit	Numri i EF	Numri i EF të shërbyera	Numri i bizneseve aktive	Numri i bizneseve të shërbyera	Numri i institucioneve	Numri i institucioneve të shërbyera
Operatori Nr.1	8786	7447	1596	645	68	68

Mbulimi me shërbim i mbledhjes së mbeturinave komunale në të gjitha lokalitetet e komunës së Gllgocit është dhënë në tabelën në vijim

Tabela 19: Mbulimi i ofrimit të shërbimit për EF sipas vendbanimit							
Nr.	Vendbanimi	Numri i EF	Numri EF të shërbyera	Mbulimi me shërbim %	Numri EF me ndarje në burim	EF me ndarje në burim %	Lloji i ndarjes së mbeturinave ²³
1	Gllgoc (bloqet, Drenasi 1 & 2, Lagjia Feronikelit)	1018	1009	99.1	102.85	657	65%
2	Llapushnik	522	417	79.9	0	0	0
3	Arllat	415	344	82.9	0	0	0
4	Negroc	193	165	85.5	0	0	0

5	Vuçak	52	35	67.3	0	0	0	0
6	Baicë	356	278	77.8	0	0	0	0
7	Abri e Epërme	250	143	57.2	0	0	0	0
8	Tërdec	159	127	79.9	0	0	0	0
9	Damanek	100	81	81.0	0	0	0	0
10	Çikatovë e Re /Drenas 3	330	328	99.4	157.04	329	73.76 %	Leter, Plastike dhe Metal
11	Globar	229	182	79.5	0	0	0	0
12	Krojkovë	181	156	86.2	0	0	0	0
13	Shtrubullova	175	148	84.6	0	0	0	0
14	Gllanasellë	243	168	69.1	0	0	0	0
15	Dobroshec	215	176	81.9	0	0	0	0
16	Çikatovë e Vjetër	188	143	76.1	0	0	0	0
17	Gradicë	132	38	28.8	0	0	0	0
18	Likoshan	88	46	52.3	0	0	0	0
19	Godanc	57	33	57.9	0	0	0	0
20	Komoran	806	664	82.4	89.04	135	25.56%	Leter, Plastike dhe Metal
21	Nekoc	452	377	83.4	0	0	0	0
22	Kishnarekë	217	167	77.0	0	0	0	0
23	Sankoc	205	137	66.8	0	0	0	0
24	Fushticë e Ulët	129	108	83.7	0	0	0	0
25	Fushticë e Epërme	127	94	74.0	0	0	0	0
26	Zabel i Epërm	72	63	87.5	0	0	0	0
27	Tërstenik	541	417	98.0	0	0	0	0
28	Vërboc	173	125	72.3	0	0	0	0
29	Polluzhë	136	109	80.1	0	0	0	0
30	Shtuticë	139	77	55.4	0	0	0	0
31	Poklek	322	299	92.9	78.68	65	21.73 %	Leter, Plastike dhe Metal
32	Korroticë e Epërme	184	163	88.6	0	0	0	0
33	Zabel i Ulët	140	138	98.6	0	0	0	0
34	Korroticë e Ulët	151	125	82.8	0	0	0	0
35	Vasilevë	89	62	69.7	0	0	0	0

Tipologjia e ofrimit të shërbimit:

Tabela në vijim e ndanë zonën e shërbimit në dy seksione: zona urbane qendra, zona periurbane dhe zona rurale. Informacioni duhet të ofrojë pasqyrën mbi tipologjinë e ofrimit të shërbimit dhe frekuencën e ofrimit të shërbimit.

Tabela 20: Tipologjia dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit

Vendbanimi	EF të shërbyera derë më derë %	Frekuenca e shërbimit	EF të shërbyera me shporta / kontejnerë të përbashkët %	Frekuenca e shërbimit
Zona urbane qendra ²⁴	30%	7/ javë	30%	7/ javë
Zona rurale	70%	1/ javë	70%	1/ javë

Asetet e hudhjes, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale:

²⁴ Ndërtesa shumëkatëshe me banim kolektiv

Në tabelën në vijim janë listuar të gjitha asetet që janë në përdorim në komunën e Glllogocit.

Tabela 21: Pajisjet për huthjen dhe grumbullimin e mbeturinave

Lloji i kontejnerit	Numri	Gjendje të mire %	Gjendje funksionale %	Gjendje jo të mire %
Shporta 120 l	8068	90%	100%	10%
Shporta 240 l	1661	90%	100%	10%
Kontejnerë 1.1 m3 metalik	101	30%	100%	70%
Kontejnerë 1.1 m3 plastikë	16	30%	100%	70%
Kontejnerë 5.1 m3	1	50%	100%	50%
Kontejnerë 7.1 m3	11	20%	100%	80%
Kontejnerë 30 m3 – Transfer	5	40%	100%	60%

Në tabelën në vijim janë listuar të gjitha kamionet që janë në përdorim në komunën e Glllogocit për grumbullim dhe transport të mbeturinat komunale përfshi edhe atë të stacionit transfer për mbeturina.

Tabela 22: Pajisjet për grumbullim dhe transport të mbeturinave

Brendi	Tipi	Kapaciteti ton apo m3	Viti i prodhimit	Targat	Gjendja (e mirë / funksionale/e keqe)
Man	Kamion	4.5 ton	2001	01-358-KL	E keqe / jofunksionale
Isuzu	Kamion	3.5 ton	2018	01-320-LT	Funksionale
Isuzu	Kamion	3.2 ton	2018	01-348-PG	Funksionale
Iveko	Kamion	4.5 ton	2001	01-425-DF	E keqe / jofunksionale
Mitsubish	Kamion	4 ton	2009	01-684-BS	Funksionale
Volvo	Kamion	11.7 ton	2009	01-685-IF	Funksionale
Mercedes	Kamion	16 m ³	2009	01-116-OI	Funksionale
Mercedes	Kamion	7 m ³	2001	01-142-CN	E mire / Funksional
IMT 539	Traktor	2 ton	2003	IMT 539 DR1	E mire / Funksional
IMT 539	Traktor	2 ton	2003	IMT 539DR2	E mire / Funksional
Man	Kamion për stacion transfer	16 ton	1999	01-368-OA	E keqe / Jo funksionale
Mercedes NEW 2022	Kamion	16 m ³	2022	01-240-SN	E mire / funksionale;
Mercedes NEW 2022	Kamion	16 m ³	2022	01-240-SN	E mire / funksionale;

2.3 Rishikimi i implementimit të planit

Komuna duhet të bëjë një analizë të realizimit të objektivave të planit aktual para se të fillojë me hartimin e objektivave të rinjë dhe caktimin e caqeve të performancës.

Tabela në vijim duhet të plotësohet duke i listuar objektivat e planit, treguesit e suksesit, caqet e planifikuara, realizimin e tyre dhe të gjitha këto të përcillen me komente sidomos kur nuk kanë pasë sukses apo progres.

Komentet më shumë duhet të fokusohen në leksionet e mësuara të cilat do të na shërbejnë për rishikimin e planit.

Psh., nëse një cak nuk është realizuar në vlerën e planifikuar: si psh., mbulimi me shërbim atëherë të jepet komenti se pse nuk është arritur ky objektiv. A nuk ka pasur kamionë të mjaftueshëm, kontejnerë, apo ndonjë arsye tjetër.

Ka raste kur një objektiv nuk është realizuar fare: edhe në këto raste duhet të jepen arsyet se pse nuk është realizuar dhe çka duhet të ndryshoj në planin aktual.

Tabela 23: Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM aktual

Objektiva e MM	Treguesi i performances	Gjendja fillestare	Caku	Realizimi	Koment
1. Ndërtimi i kapacitetit njerëzor dhe institucional dhe partneritetet e suksesshme që garantojnë menaxhimin e mbeturinave mjedisore dhe mbulimi i plotë i shpenzimeve sipas parimit 'ndotësi paguan'.	1.- % e realizimit të masave rregullatore në fushën e MM; 2.- % e të anketuarve që shprehin "të kënaqur" ose "shumë të kënaqur" mbi punën e sektorit të 1, MMN dhe 2, mbeturinave në anketimin vjetor; 3.- nr. i inspektimeve nga inspektorati komunal për shkelje ligjore mjedisore;		1.-Zbatimi i legjislacionit; 2.-Përmirësimi i politikave lokale për MMN; 3.-Përmirësimi i njohurive dhe kapaciteteve komunale mbi MMN;		Sfidë mbetet mbulimi në shërbim të mbeturinave për amviseri në shkallën 100 %. Rekomandohet të rishikohet rregullorja komunale për menaxhimin e mbeturinave, qytetaret obligohen të hyjnë në sistemin e menaxhimit të mbeturinave në ato zona ku ofrohet shërbimi dhe kryhet sipas itinerarit.
2. Mbledhja dhe transporti i mbeturinave për të gjithë banorët dhe bizneset e komunës së Glllogocit	1.- % e sip. rrugëve, trotuareve, shesheve që pastrohen dhe % e mbulimit me shërbimin e largimit të mbeturinave a) të ekonomive familjare b) të bizneseve c) të institucioneve;		1.- Zgjerimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave;	E realizuar	Sfidë mbetet edhe kyqja e të gjitha bizneseve në menaxhimin e mbeturinave kjo për shkak të listave jo të sakta lidhur me regjistrin bizneseve aktive dhe rritje e kapaciteteve të kompanise (makineri) për kryerje të shërbimit.

Hartimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave

3.	Krijimi i një sistemi modern, të integruar dhe efektiv të menaxhimit të mbeturinave që është efikas për nga kostoja dhe që e siguron vlerën më mirë për paratë publike	1.- nr. i ankesave mbi ofrimin e shërbimit; 2.- % e të anketuarve që vlerësojnë "sh.mirë" dhe "mire" shërbimin e pastrimit dhe largimit të mbeturinave;	1.- Mbledhja dhe largimi i mbeturinave; 2.- "Pastrimi" i rrugëve, parqeve, etj.	E realizuar	
4.	Largimi i sigurt i mbeturinave të rrezikshme, kryesisht mbeturinave të kafshëve dhe mjekësore	1.- nr. i lejeve (mjedisore) për thertore që citojnë detyrimin mbi asgjësimin e eshtrave; 2.- nr. i pikave të grumbullimit për pajisjet elektrike dhe elektronike; 3.- % e institucioneve shëndetësore (farmaci dhe qendra shëndetësore) që dorëzojnë mbeturinat në Incinerator.	Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme;	E realizuar pjesërisht	Grumbullimi i mbeturinave mjekësore bëhet nga kompani të licensuara e cila ka kontratë me QKMF dhe AMF dhe kompani private. Forma aktuale e menaxhimit të mbeturinave shtazore është kontraktimi i një operatori ekonomik i cili bënë propojen e kafshëve të ngordhura. Sistem të mirë organizuar dhe të integruar për menaxhimin e mbeturinave shtazore mbetet sfida për shkak të mungesës dhe interesimit të operatorëve ekonomik për realizim të këtij shërbimi. Përmes pilotimit të projekteve ndarja e mbeturinave të riciklueshme në burim dhe kompostimi shtëpiak në zonën urbane dhe suburbane qytetare ju është ofruar infrastruktura për ndarjen e mbeturinave. Aktualisht ndarja e mbeturinave letër, plastikë dhe metal nuk është duke funksionuar në qendrën e stacion transferit për shkak të defekteve në makineri nga kompania KRM Pastrimi. Stacion transferi posedon makinerin prese për paketimin e mbeturinave të riciklueshme.
5.	Reduktimi i sasisë së mbeturinave që shkon në deponi përmes trajtimit, ripërdorimit dhe përgatitjes për riciklimin e mbeturinave, duke krijuar dobi mjedisore dhe financiare për komunitetin dhe bizneset.	1.- % e mbetjeve të gjeneruara që shkojnë në deponi 2.- % e mbeturinave të trajtuara 3.- % e mbeturinave të ndara 4.- % e mbetjeve të biodegradueshme shkon në deponi	1.- Regjistrimi i llojeve të mbeturinave; 2.- Ndarja e mbeturinave biodegraduese dhe lëndëve dytësore bazë; 3.- Kompostimi;	E realizuar - Pilotim i projekteve për reduktimin e sasisë së mbeturinave	

Hartimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave

6.	Deponimi i mbeturinave sipas standardeve që garantojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut, mjedisit dhe biodiversitetit	1.- ulja e koston së transportit; 2.- % e deponive ilegale të rehabilituara;	4.- Riciklimi i lëndëve bazë dytësore; 1.- Stacioni i transferimit dhe transporti në distancë; 2.1- Rehabilitimi i deponive ilegale; 2.2- Mbeturinat inerte dhe të ndërtimit; 2.3- Depozitimi i mbeturinave të rrezikshme;	E realizuar		Sfidë mbetet depozitimi i mbeturinave të rrezikshme duke mos poseduar një lokacion në nivel regional për depozitim të këtij lloji të mbeturinave.
7.	Përfshirja aktive e komunitetit dhe partnerëve në reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe në menaxhimin e mbeturinave në mjedis.	1.- % e qytetarëve që marrin njohuri për menaxhimin e mbetjeve; 2.- nr. i bashkëpunimeve qytetar –institucione; 3.- nr. i broshurave ndërgjegjëse të përgatitura për publikum; 4.- nr. (ose buxheti) i nismave komunitare mbështetur nga komuna;	1.- Rritja e ndërgjegjësimit mbi MMN; 2.- Ndërgjegjësim dhe informim mbi mbetjet specifike me prodhuesit;	E realizuar pjesërisht		

2.4 Performance e shërbimit

Efikasiteti i stafit të ofruesit të shërbimeve:

Stafi i angazhuar në ofrimin e shërbimeve përfshin stafin direkt e angazhuar në operime si dhe stafin indirekt dhe administrativ të cilët i mbështesin ofrimin e shërbimit të MM. Stafi indirekt dhe administrativ raportohet 100% tek kompanitë në pronësi 100% të komunës ndërsa nëse kompania është regjionale atëherë ky staf duhet të raportohet në bazë të angazhimit të tij për komunën në fjalë. Kjo në të shumtën e rasteve është e barasvlershme me % e pronësinë e komunës në ndërmarrjen regjionale. Psh nëse komuna zotëron 20% të aksioneve atëherë stafi i administratës qendrore raportohet duke ia zbatuar këtë %.

Tabela 24: Efikasiteti i stafit të shërbimeve të MM

Kategoria	Numri i stafit
Stafi direct	
Kryepunëtorë	1
Shoferë	11
Punëtorë	21
Total staf direkt:	33
Staf indirekt dhe administrative	
Drejtorët e bordit	1
Menaxhmenti i lartë ²⁵	1
Zyrtarë të rangut të mesëm	10
Staf teknik	0
Zyrtarë të rangut fillestar	5
Staf tjetër	1
Total staf indirekt dhe administrative:	18
Total staf të MM	51
Mbeturina të grumbulluara	7458.10 ton gjatë vitit 2021
Efikasiteti i stafit / ton mbeturina të grumbulluara	234t/v/staf
EF të shërbyera	7447 gjatë vitit 2021
Efikasiteti i stafit / EF të shërbyera	225.6 EF/vit/staf

Performanca e aseteve të grumbullimit dhe transportit:

Asetet komunale për menaxhim të mbeturinave, që tregojnë efikasitet të kënaqshëm në realizimin e shërbimit për çka janë të dedikuara, janë mjeti elementar për arritjen e përmbushjes së objektivave të një komune lidhur me menaxhimin e mbeturinave.

²⁵ KE, ZKF, drejtorët e departamenteve, dhe pozita tjera të larta.

Asetet komunale janë të gjitha pajisjet të cilat janë në pronë të komunës apo janë pronë e kompanisë publike (në të cilën komuna ka pronësi). Sa më e lartë performanca e aseteve aq më e vogël do të jetë kostoja e ofrimit të shërbimit të hudhjes, mbledhjes dhe transportit të mbeturinave.

Tabela 25: Performanca e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Kategoria	Performanca
Kamionët në operim	5
Kapaciteti maksimal operues (ton)	28
Mbeturinat e Grumbulluara (ton/vit)	7458.10 ton gjatë vitit 2021
Xhiro (xhiro/vit)	4681 gjatë vitit 2021
Kilometrazhi (km/vit)	255912 gjatë vitit 2021
Konsumi i naftës (l/vit)	72546.27 gjatë vitit 2021
Efikasiteti i Shfrytëzimit %	
Efikasiteti i shfrytëzimit të kamionëve	1491.6t/kamion/vit
Konsumi i naftës l/100km	28.35
Konsumi i naftës l/ton	9.73

2.5 Performanca financiare e MM

2.5.1 Shpenzimet e shërbimit të MM

Shpenzimet janë ndarë në shpenzime të pagave, shpenzime të materialit direkt dhe shpenzimet indirekte dhe administrative.

Shpenzimet indirekte dhe administrative përfshijnë zërat si: tatimi mbi fitimin; tatimi mbi pronë; sigurimi; pagesa e licencave; shërbime komunale; kostot e komunikimit; kostot e trajnimit; shpenzimet e përfaqësimit; qeraja; kostot e transportit; të konsumueshme dhe shpenzime të tjera administrative.

Tabela 26. Shpenzimet e shërbimit të MM

Kategoria e kostove dhe shpenzimeve	Kostot (€ /vjet)	Pjesëmarrja %
Shpenzimet e pagave	216,492.05	57.84
Shpenzimet e materialit direkt ²⁶	129,474.10	34.59
Shpenzimet indirekte dhe administrative	21,830.16	5.83
Amortizimi	6473.7	1.73
Total:	374,270.01	100%

²⁶ Nafta, pagesa e deponisë, mirëmbajtja dhe riparimet e kamionëve dhe kontejnerëve, regjistrimi i kamionëve, etj.

2.5.2 Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM

Të hyrat iu referohen të hyrave operative primare dhe sekondare.

Tabela 27: Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM

	Të hyrat	Arkëtimi
Të hyrat operative		
-Amvisëritë	53,813.52	50,877.57
-Bizneset	5,346.84	5,976.54
-Institucionet	164,119.15	132,135.84
-Nga shërbimet tjera të kontraktuara	400,374.20	358,976.53
Total:	623,653.71	547,966.48

2.5.3 Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit

Hapi final është krahasimi i kostove dhe të hyrave si dhe kalkulimi i treguesve përfundimtar të performancës si në tabelën në vijim:

Tabela 28: Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit

Kostot e MM	164,119.56
Të hyrat e MM	459,434.56
Arkëtimi	547,966.48
Shkalla e mbulimit nga faturimi %	100%
Shkalla e mbulimit nga arkëtimi %	87.84

2.6 Infrastruktura për ndarje, riciklim dhe deponim të mbeturinave

Qendrat e transferit dhe të riciklimit

Komuna e Drenasit posedon një stacion transfer të mbeturinave i cili ndodhet në fshatin Çikatovë e Vjetër, në distanc 3 km nga qendra e Drenasit. Stacion transferi shërben për deponim të përkohshëm të mbeturinave (shiko foto 1 dhe 2), të cilat më pastaj transportohen në deponinë sanitare në Mirash. Ky stacion pas funksionalizmit ka filluar të përdoret edhe si qendër për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme ku mbeturinat e grumbulluara me shërbim të veçant janë ndarë dhe presuar (shiko foto 3 dhe 4), e gjithë kjo me qëllim të reduktimit të sasisë së mbeturinave të cilat shkojnë për deponim në deponinë regjionale, ruajtjen e mjedisit dhe profit ekonomik. Në të ardhmen ky stacion transfer ka kapacitet që përmes investimeve të përdoret si qendër për ndarjen e mbeturinave.




Foto 1 & 2 – Stacion transferi për deponim të përkohëshëm të mbeturinave.





Foto 3 & 4 – Stacion transferi si qendër për selektim dhe presim të mbeturinave të riciklueshme.

Bazuar sipas marrëveshjes së lidhur ndërmjet dyja palëve “K.R.M. Pastrimi” dhe “Komuna Drenas” më datën 27.01.2020, lidhur me ofrimin e shërbimeve primare të menaxhimit të mbeturinave, stacion transferi i mbeturinave është në shfrytëzim dhe menaxhohet nga kompania KRM Pastrimi - njësia Drenas. Vlen të theksohet se Kompania Pastrimi - njësia Drenas nga viti 2021 po ballafaqohet me defekte në makineri që ka rezultuar në grumbullimin e mbeturinave në stacion transferin e mbeturinave në Çikatovë të Vjetër dhe mos funksionimin e tij si qendër për ndarjen e mbeturinave.

Deponia

Komuna e Glllogocit përmes vendimit të Kuvendit Komunal ka të caktuar lokacionin për deponimin e mbeturinave nga ndërtim - demolimi. Deponia e mbeturinave ndodhet në fshatin Llapushnik, e caktuar për hudhjen e mbeturinave nga ndërtim demolimi me qëllim që mbeturinat e këtij lloji të dërgohen dhe deponohen në këtë hapësirë. Fillimisht deponia para shfrytëzimit është kufizuar me rrethojë metalike me qëllim që të mos frekuentohet nga kafshët dhe personat e tjerë të pa autorizuar. Në pjesën hyrse të deponisë është vendosur porta me mundësi qasje për

hudhjen e mbeturinave nga ndërtim demolimi. Deponia ka filluar së funksionalizuari duke u hudhur mbeturinat ndërtimore nga operatorët ekonomik dhe qytetarët. Në kuadër të funksionalizimit të kësaj deponie e njejta është mirëmbajtur vazhdimisht (shiko foto 4 dhe 4) me qëllim që mbeturinat ndërtimore të cilat janë dërguar të sistemohen brenda deponisë. Foto 4 dhe 5. Mirëmbajtja e deponisë.



Kohëve të fundit nga vizitat në teren dhe raportimet e qytetarëve vërejmë se nga persona të pa përgjegjshëm po bëhet hudhja e mbeturinave të llojeve të tjera për cka nuk është e destinuar hapësira e deponisë në fshatin Llapushnik. Si DSHPE vazhdimisht përmes njoftimeve në rrjetet sociale (uebfaqe të komunës) dhe vendosjes së tabelave informuese në deponi kemi njoftuar dhe apeluar tek qytetarët që të mos i hudhin llojet e tjera të mbeturinave përpos atyre nga ndërtim demolimi, si dhe mbeturinat e këtij lloji të hudhen në pjesën e brendshme të deponisë e jo në hyrje.

2.7 Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave

Jep të dhënat esenciale se si menaxhohen kategoritë e mëposhtme të mbeturinave:

- Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme

Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme në Territorin e Komunës së Glllogocit realizohet për ekonomitë familjare të cilat janë në zonën qendër të qytetit të Glllogocit dhe Komoran nga kompania KRM Pastrimi. Vlen të theksohet se në nivelin regjional mungon lokacion për trajtimin e këtij lloji të mbeturinave.

- Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtim demolimi:

Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtim demolimi funksionon përmes hudhjes së mbeturinave nga vetë qytetarët në deponin e caktuar nga komuna.

- Menaxhimi i mbeturinave shtazore

Sfidë për komunën e Glllogocit mbetet menaxhimi i mbeturinave shtazore. Forma aktuale e menaxhimit të mbeturinave shtazore është se komuna ka kontraktuar një operatori ekonomik i cili bënë groposjen e kafshëve dhe shpezve të ngordhura.

- Menaxhimi i mbeturinave medicinale

Menaxhimi dhe grumbullimi i mbeturinave mjekësore bëhet nga kompani të licensuara, gjithsej 3,545.85 kg mbeturina medicinale për vitin 2021 nga kompania "Prince Company" e cila ka kontratë me QKMF dhe AMF. Ndërsa mbledhja e mbeturinave mjekësore nga ordinancat private bëhet nga kompani të tjera private të licensuara për menagjimin e mbeturinave mjekësore.

- Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave

Për kategoritë tjera të mbeturinave që gjenerohen në komunën e Glllogocit, siq janë bateritë, vajrat mbeturinë, mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike, nuk kemi ndonjë të dhënë se si qëndron gjendja e tyre, andaj, është e domodoshme që në të ardhmen të hulumtohet gjendja dhe të adresohet zgjidhja e menaxhimit të këtyre mbeturinave të dëmshme për mjedisin.

3 Objektivat e MM dhe plani operacional

3.1 Vizioni i MM

Komuna e Glllogocit synon që të ofrojë shërbime të menaxhimit të mbeturinave gjithë qytetarëve të saj. Krahas këtij veprimi komuna synon që të ngrisë kualitetin e shërbimeve duke bashkëpunuar me qytetarët e saj dhe akterët tjerë relevant.

Duke promovuar konceptin 3R dmth reduktim, ripërdorim, dhe riciklim , komuna gradualisht ka filluar të ndajë mbeturinat (nga ekonomit familjare, tek shkollat ,institucionet dhe bizneset), të edukojë qytetarët rreth përfitimeve për ndarje të mbeturinave dhe të krijojë infrastrukturë për zhvillim ekonomik lokal, pra të krijojë mundësi qytetarëve që të krijojnë biznese financiarisht të qëndrueshme në sektor. Përfundimisht, komuna synon që të krijojë një mjedis më të pastër për qytetarët e saj, gjë që do të ndikonte në ngritjen e mirëqenies për qytetarë.

3.2 Objektivat dhe caqet e MM

Formati i standardizuar i PKMM përmban pesë objektiva të paraqitur në tabelën e mëposhtme (edhe pse lista nuk është e kufizuar):

Tabela 29: Lista e objektivave të planit

Numri objektivit	Emërtimi
Objektivi 1	Parandalimi dhe minimizimi i gjenerimit të mbeturinave
Objektivi 2	Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave
Objektivi 3	Ofrimi i shërbimeve cilësore, efektive dhe efikase të shërbimeve
Objektivi 4	Eliminimi i deponive ilegale
Objektivi 5	Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave

3.3 Objektivi 1: Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave

Komuna e Glllogocit është e përkushtuar që të bëjë hapa të vendosur në parandalimin respektivisht reduktimin e gjenerimit të mbeturinave. Parandalimi dhe reduktimi i gjenerimit të mbeturinave shkon në linjë me hierarkinë e prioriteteve të menaxhimit të mbeturinave të sanksionuar me ligj dhe strategji.

Tabela 30: Korniza strategjike e Objektivit 1

Nr.	Aktiviteti / masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
			2022	2023	2024	2025	2026	2027
1.1	Mbeturina të grumbulluara për kokë banori (kg /ditë)	Sasia e mbeturinave të grumbulluara për banor (kg /ditë)	0.34	0.40	0.45	0.50	0.55	0.60
1.2	Riorganizimi i shërbimit për të mundësuar	Shërbimi është riorganizuar për të bërë	-	-	1	-	-	-

	matjen e mbeturinave të grumbulluara	matjen e mbeturinave në pikën e grumbullimit					
1.3	Zbatimi i tarifave volumetrike	Tarifat volumetrike janë miratuar dhe po aplikohen	-	-	1	-	-
1.4	Futja e pakos stimuluese	Pako stimuluese është hartuar dhe miratuar	-	-	1	-	-
1.5	Shpërndarja e komposterëve individual	Numri i komposterëve individual të shpërndarë për EF dhe biznese „zero ëaste“	-	-	50	60	80
1.6	Zbatimi i fushatës informative për parandalimi dhe minimizim të gjenerimit të mbeturinave	Fushata informative po zbatohet	-	1	1	1	1

3.3.1 Masat dhe aktivitetet për zbatimin e Objektivit 1

Riorganizimi i shërbimit për të mundësuar zbatimin e tarifave me bazë matjen:

Mënyra e organizimit të tanishëm të shërbimit përveq bizneseve të mëdha dhe institucioneve nuk bazohet në matjen e mbeturinave të gjeneruara për grumbullim. Edhe tek rasti i grumbullimit derë më derë për amvisërit në zonat rezidenciale dhe rurale prap nuk bëhet matja për amvisëri të shërbyer. Kjo mënyrë e shërbimit e pamundëson zbatimin e tarifave në bazë të matjes dhe si e tillë duhet të transformohet. Poashtu ofruesit e shërbimeve nuk e kanë teknikën e as kapacitetin për ta zbatuar volumetrinë.

Për të riorganizuar shërbimin nevojitet:

- **Plani i riorganizimit të shërbimit** i cili do të mundësoj zbatimin e matjes së mbeturinave në pikën e grumbullimit;
- Sigurimi i infrastrukturës për matjen e gjenerimit të mbeturinave të grumbulluara;
- Trajnimi i stafit të ofruesit të shërbimeve për të zbatuar skemën PAYT.

Zbatimi i tarifave volumetrike bazuar në matje

Tarifat aktuale janë të përcaktuara në bazë të sasisë së paramenduar të gjenerimit të mbeturinave për amvisëritë dhe bizneset. Problemi me këto tarifa është se nuk e promovojnë reduktimin e gjenerimit të mbeturinave përmes pagesës ndërsa disa konsumatorë me gjenerim më të madh përfitojnë nga pagesa më e ulët se kostoja e shërbimit. Për të kaluar në tarifat volumetrike nevojiten aktivitetet sa vijon:

- Kalimi i tarifave të shërbimit në bazë të matjes;
- Azhurnimi i softuerit të faturimit që të mundësoj tarifën e bazuar në matje;
- Zbatimi i tarifave PAYT.

Nxjerrja e pakos stimuluese për bizneset me „zero ambalazhim“ dhe „zero mbeturina“:

Komuna ka interes që të zhvilloj ekonomi lokale të bazuar në ekonomi qarkore dhe bazë të qendrueshme. Ideja është që këto biznese të veprojnë në drejtim të minimizimit dhe reduktimit të mbeturinave. Në vendet e BE-së dhe më gjerë po hapen dyqane të cilat shesin produktet e tyre pa ambalazhim si dhe restorantet të cilat i kompostojnë mbeturinat e tyre nga ushqimet.

Ideja është që këto dyqane të jenë më konkurente me çmime më të lira të cilat do i bënin atraktive për konsumatorët. Poashtu konsumatorët me vetëdije më të lartë mjedisore do tu ofrohej mundësia që të i kryenin furnizimet në këto dyqane.

Komunat mundën të luajn rolin e tyre që të i promovojnë këto biznese dhe përmes lehtësimeve fiskale të e lehtësojnë afarizmin e tyre. Disa nga masat të cilat do ti ndërmerr komuna janë:

- Studimi i mënyrës së futjes së stimujve fiskal dhe kostove dhe përfitimeve;
- Futja e stimujve të përshtatshëm fiskal përfshi tarifatat preferenciale;
- Analizë e zbatimit të prokurimit të gjelbër për këto subjekte;

Shpërndarja e komposterëve për shtëpi rezidenciale dhe restorante “zero mbeturina”:

Komuna do të shpërndaj falas apo me bashkëfinancim komposterë individual të cilët do të reduktojnë mbeturinat që do të hudhen në kontejnerët apo shportat që do të grumbullohen dhe transportohen nga operatori.

Rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për çështjet e minimizimit dhe reduktimit të gjenerimit të mbeturinave përmes fushatave informuese.

Komuna do të organizoj fushatë informuese për qytetarët bizneset dhe institucionet mbi rëndësinë e parandalimit dhe reduktimit të gjenerimit të mbeturinave si dhe këshillat për ta arritur këtë objektivë.

3.4 Objektivi 2: Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave

Fokusi primar i këtij objektivi ka të bëjë me ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale si dhe kategorive tjera të mbeturinave nën kompetencë komunale me theks të veçantë në MND, mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturinat komerciale.

Edhe pse gomat, produktet elektrike dhe elektronike, bateritë etj., nuk janë kompetencë komunale, megjithatë duke iu referuar kuadrit ligjorë dhe praktikave të jashtme, komuna do të organizoj skemën e grumbullimit të organizuar të këtyre mbeturinave në kuadër të skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

Tabela në vijim jep kornizën strategjike për objektivin 2 së bashku me disa masa aktivitete të propozuara:

Tabela 31: Korniza strategjike e Objektivit 2

Nr.	Masat / aktivitet / treguesi i performancës	Treguesi	Vlera bazë		Caku				
			2022	2023	2024	2025	2026	2027	
2.1	Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit të mbeturinave komunale	Analiz e gjenerimit dhe kompozicionit është zbatuar	-	-	1	-	-	1	
2.2	Studimi i fizibiliteti për modelin e operimit të qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit	Studimi i fizibilitetit është zbatuar	-	-	1	-	-	-	
2.3	Zgjerimi i infrastrukturës ndarëse të mbeturinave në burim	% EF me ndarje në burim	0 %	5 %	10 %	20 %	30 %	40 %	
2.4	Riciklimi i mbeturinave të riciklueshme jo-degraduese	% e riciklimin të letres, kartonit, plastikes, metalit dhe qelqit	0 %	5 %	10 %	20 %	25 %	30 %	
2.5	Riciklimi i mbeturinave bio-degraduese	% e riciklimin të mbeturinave ushqimore dhe mbeturinave tjera biodegraduese	0 %	5 %	10 %	20 %	25 %	30 %	
2.6	Kontraktimi i operatorit të licencuar për grumbullimin dhe transportin dhe riciklimin e mbeturinave bio degraduese	Operatori është kontraktuar			1				
2.7	Studimi i fizibiliteti për modelin e operimit të qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit	Studimi i fizibilitetit është zbatuar				1			

2.8	Funksionalizimi i deponisë së MND	Procedurat administrative për funksionalizimin e deponisë janë zbatuar	1		
2.9	Studimi i fizibilitetit për modelin e operimit të grumbullimit, transportimit dhe riciklimit të MND në komune.	Studimi i fizibilitetit është zbatuar	1		
2.10	Kontraktimi i operatorit privat për MND	Operatori është kontraktuar	1		
2.11	Kontraktimi i operatorit privat për grumbullimin dhe transportin dhe riciklimin e mbeturinave të reciklueshme jo degraduese	Operatori është kontraktuar	1		

Analiza e potencialit të gjenerimit, kompozicionit dhe riciklimit të mbeturinave në komunë

Analiza në fjalë nisët nga parashikimet demografike të popullatës.

Tabela 32: Parashikimet demografike të popullatës

Vendbanimi	Numri i popullatës					
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Qyteti (rritje / zbritje)	Rritje	Rritje	Rritje	Rritje	Rritje	Rritje
Qyteti (banorë)						
Zona ruarë (rritje / zbritje)	Rritje	Rritje	Rritje	Rritje	Rritje	Rritje
Zona ruarë (banorë)						
Total banorë	58,531	52,500	52,800	53,000	53,500	54,000

Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave është dhënë në tabelat në vijim i bazuar në studimin e kompozicionit të mbeturinave nga komuna e Pejës.

Tabela 33: Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave

	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Popullata në zonën urbane	6,143	6,180	6,250	6,350	6,750	7,050
Gjenerimi për kokë banori ZU (kg/v)	322.07	322.78	323.26	323.65	323.88	323.94
Gjenerimi i mbeturinave ZU (kg/v)	1,978,476.01	1,994,780.40	2,020,375.00	2,055,177.50	2,186,190.00	2,283,777.00
Popullata në zonën rurale	52,388	52,500	52,800	53,000	53,500	54,000

Gjenerimi për kokë banorë ZR (kg/v)	301.1	301.76	302.21	302.58	302.79	302.85
Gjenerimi i mbeturinave ZR (kg/v)	15,774,027	15,842,400	15,956,688	16,036,740	16,199,265	16,353,900
Totali i gjenerimit vjetor i mbeturinave (kg/v) (ZU dhe ZR)	17,752,502.81	17,837,180.40	17,977,063.00	18,091,917.50	18,385,455.00	18,637,677.00

Parashikimi i kompozicionit të mbeturinave të gjeneruara është dhënë në tabelat në vijim i bazuar në studimin e kompozicionit nga komuna e Drenasit

Tabela 34: Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave sipas kompozicionit

		2023	2024	2025	2026	2027
%	Fraksioni					
	Letër dhe karton	19.15%	19.19%	19.22%	19.24%	19.26%
	Qelq	6.45%	6.46%	6.47%	6.48%	6.49%
	Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat	34.45%	34.53%	34.58%	34.62%	34.64%
	Tekstil dhe veshjet	5.85%	5.86%	5.87%	5.88%	5.88%
	Plastika	19.45%	19.49%	19.52%	19.55%	19.56%
	Metal	1.05%	1.05%	1.05%	1.06%	1.06%
	Të tjera	13.60%	13.63%	13.65%	13.67%	13.68%
	Letër dhe karton	3,399.60	3,422.95	3,455.19	3,480.88	3,541.04
	Qelq	1,145.04	1,257.93	1,259.82	1,261.33	1,262.22
ton	Mbeturina bio-degraduese ²⁷	6,115.74	6,159.18	6,216.47	6,263.42	6,368.72
	Tekstil dhe veshjet	1,038.52	1,045.26	1,055.25	1,063.80	1,081.06
	Plastika	3,452.86	3,476.47	3,509.12	3,536.97	3,596.19
	Metal	186.40	187.29	188.76	191.77	194.89
	Të tjera	2,414.34	2,431.21	2,453.87	2,473.17	2,515.13

Në tabelën në vijim janë dhënë caqet preliminare të komunës karshi ripërdorimit / riciklimit të fraksioneve të caktuara të mbeturinave komunale si letra, plastika, qelqi, plastika dhe metali si dhe mbeturinat biodegraduese.

Tabela 35: Caqet e riciklimit

Fraksioni	2023	2024	2025	2026	2027
Të riciklueshmet jo-degraduese %	8 %	15 %	20 %	25 %	30 %
Të riciklueshmet jo-degraduese (ton)					
Të riciklueshmet biodegraduese %	5 %	10 %	15 %	20 %	25 %
Të riciklueshmet biodegraduese (ton)					

Megjithatë për caqe më të sakta të ripërdorimit dhe riciklimit komunat do të zbatoj studimin e gjenerimit dhe kompozicionit si dhe një studim të fizibilitetit të ndarjes së mbeturinave në burim dhe riciklimit.

²⁷ Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat

Avancimi i sistemit të ndarjes dhe riciklimit të mbeturinave komunale:

- **Zgjerimi i infrastrukturës për ndarje në burim të mbeturinave komunale;**

Komuna e Glllogocit është e përkushtuar që të bëjë ndarjen në burim të mbeturinave komunale. Format e ndarjes varen nga faktorë të ndryshëm dhe mundë të marrin forma sa vijon:

- Ndarja në dy fraksione „thatë dhe të lagësht“ me grumbullim derë më derë;
- Ndarja në tre fraksione „recikluese jo-biodegraduese, „biodegraduese dhe mbeturinat e tjera“ me grumbullim derë më derë;
- Ndarja në dy fraksione „thatë dhe të lagësht“ me grumbullim me kontejnerë të përbashkët;
- Ndarja në tre fraksione „recikluese jo-biodegraduese, „biodegraduese dhe mbeturinat tjera me grumbullim me kontejnerë të përbashkët;
- Ndarja në mbi tre fraksione „letër – qelq – plastikë - metal, „biodegraduese dhe mbeturinat e tjera“ me grumbullim me kontejnerë të përbashkët.

Forma e ndarjes kushtëzohet nga tipi i vendëbanimit (rezidencial dhe banim kolektiv), kapaciteti buxhetorë, infrastruktura ricikluese e të ngjashme.

Megjithatë tipi i ndarjes së mbeturinave do të përcaktohet nga **plani i riorganizimit të shërbimit** që do ta zhvilloj komuna.

Në tabelën në vijim jepet orari i shtrirjes së ndarjes së mbeturinave në burim:

Tabela 36: Orari i ndarjes së mbeturinave në burim						
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Mbulimi total me shërbim	85 %	90 %	95 %	100 %	100 %	100 %
Mbulimi me ndarje në burim	-	10 %	15 %	20 %	30 %	40 %

- **Zbatimi i skemës së grumbullimit të ndarë, transportit dhe riciklimit të mbeturinave të riciklueshme jo të degradueshme;**

Komuna e Glllogocit do të zbatojë një **studim të fizibilitetit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale i cili përfshin si fraksion të ndarë mbeturinat e riciklueshme jo-biodegraduese**. Studimi do të bazohet në analizën e kompozicionit, tregun e të riciklueshmeve dhe sektorin e ricikluesve privat dhe poashtu do të marr parasysh kërkesat ligjore dhe politikat kombëtare të menaxhimit të mbeturinave si dhe praktikën më të mira.

Sipas strategjisë së mbeturinave 2021 – 2030 parashihet të zbatohet skema e sistemit të kthimit të depozitës për ambalazhet e pijeve tek prodhuesit dhe tregëtarët e pijeve që paraqet një përqindje të konsiderueshme të këtyre mbeturinave. Poashtu strategjia e mbeturinave parasheh operimin e qendrave të riciklimit ku do të dërgohen këto mbeturina.

Megjithatë deri sa të zbatohet skema e kthimit të depozitës dhe funksionalizohet qendra e riciklimit komuna do të tentoj të bëjë partneritet me ricikluesit privat për të bërë grumbullimin dhe transportin e të riciklueshmeve jo-biodegraduese.

Pra komuna sa i përket mbeturinave të riciklueshme jobiodegradues do të zbatoj:

- studimin e zbatimit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave të riciklueshme të padegradueshme
- zhvillimi i partneritet me ricikluesit privat për grumbullimin dhe transportin e këtyre mbeturinave
- Zbatimi i skemës së grumbullimit të ndarë, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale biodegraduese

Ngjashëm si me mbeturinat e riciklueshme jo të degradueshme, komuna do të zbatoj një **studim të fizibilitetit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale i cili përfshion si fraksion të ndarë mbeturinat biodegraduese**. Mbeturinat që do të përfshihen në këtë fraksion do të jenë mbeturinat nga ushqimet, vajrat e përdorura ushqimore, dhe mbeturinat nga parqet, tregjet e gjelbërta dhe hapësirat publike.

Sipas strategjisë secili rajon do të ketë një qendër të kompostimit të centralizuar ku do të dërgohen **mbeturinat biodegraduese ushqimore**. Por deri sa të ndërtohet dhe funksionalizohet kjo qendër komuna do të konsideroj zhvillimin e skemës lokale të kompostimit përmes angazhimit të operatorëve privat të interesuar që të grumbullojnë dhe transportojnë këto mbeturina.

Komuna do të ndërtoj skemën lokale të kompostimit për **mbeturinat biodegraduese nga parqet, tregjet e gjelbërta dhe hapësirat publike** të cilat për shkak të specifikave të tyre duhet të kompostohen lokalisht meqë transportimi i tyre është i kushtueshëm dhe joefikas.

Sa i përket **vajërave të përdorura ushqimore** komuna do të u kërkoj objekteve gastronomike që i prodhojnë këto vajëra me shumicë të lidhin kontrata valide me operatorët të licencuar të vajërave ushqimore nga MESPI të cilët do të bëjnë grumbullimin e organizuar të këtyre vajrave. Komuna do të organizoj mbikëqyrjen dhe inspektimin e mbarëvajtjes së kësaj skeme të organizimit dhe do të shqiptoj dënime në rast të shkeljeve.

Pra komuna sa i përket mbeturinave biodegradues do të zbatoj:

- studimin e zbatimit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave komunale biodegraduese
- zhvillimi i skemës lokale të kompostimit në partneritet me ricikluesit privat
- inspektimin e lokaleve sa i përket vajrave mbeturinë

Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale:

- Hapja e qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit:

Komuna e Glllogocit planifikon të hap **qendrën e grumbullimit dhe ripërdorimit të mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale**. Për hapjen e kësaj qendre komuna do të caktoj lokacionin për këtë qëllim.

Në këtë objekt qytetarët do të dërgojnë artikujt e padëshiruar të tyre sa vijon:

- Mobilje dhe orendi
- Tekstil dhe veshëmbathje
- Pajisje shtëpiake dhe mbeturina tjera të vëllimshme

Përpos këtyre artikujve të padëshiruar qytetarët mund të dorëzojnë edhe gomat, bateritë, vajrat mbeturinë dhe mbeturina tjera.

Komuna duhet përmes një **studimi të fizibilitetit të modelit të operimit** të qendrës të analizoj dhe të vendos se a ta menaxhoj këtë vetë këtë qendër apo ta angazhoj një operatorë privat.

Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi:

Sa i përket MND ligji parasheh caktimin e lokacionit të deponisë që është një zgjidhje e përkohshme dhe ndërtimin dhe funksionalizimin e qendrës së grumbullimit dhe riciklimit të këtyre mbeturinave e cila sipas strategjisë së mbeturinave do të organizohet në formë rajonale.

Komuna sipas ligjit e kontraktos shërbimin me operator të licencuar, cakton tarifat e shërbimit dhe se ndërtuesit kanë të drejtë që ti ndajnë dhe riciklojnë mbeturinat e tyre në kantierin e punimit si dhe ti transportojnë mbeturinat deri te destinacioni i autorizuar.

Komuna jonë tashme e ka caktuar lokacionin e deponisë. Komuna do të dërgoj mbeturinat në këtë lokacion i cili do të operohet nga kontraktori i licencuar i cili poashtu do të kontraktohet nga komuna siq e parasheh ligji.

Komuna do të shqyrtoj bazën ligjore në mënyrë që të instaloj një sistem i cili në kuadër të lejes ndërtimore do të kërkoj që ndërtuesi të ketë edhe një plan të menaxhimit të mbeturinave ku parashihet sasia e mbeturinave që do të deponohen. Lokacioni ku do të dërgohen mbeturinat e KD është caktuar nga komuna në Llapushnik. Inspeksioni do të mbikëqyrë këtë deponi dhe të parandaloj hudhje e këtyre mbeturinave në vendë tjera të papërshtatshme.

Në momentin e funksionalizimit të qendres rajonale komuna do të dërgoj mbeturinat tek kjo qendër. Poashtu tarifat do të caktohen në nivel të komunes të cilat do të shërbehen nga kjo qendër e grumbullimit dhe riciklimit të MND.

Megjithatë komuna do të zbatoj një **studim fizibiliteti të modelit të operimit të grumbullimit dhe transportit të MND si dhe të riciklimit të tyre nga ndërtuesit.**

Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave nga kujdesi shëndetësor:

Komuna, respektivisht Drejtorati për Shëndetësi, por edhe Drejtorati i Inspeksionit, do të monitoroj menaxhimin e mbeturinave spitalore sipas legjislacionit në fuqi.

Inpektori komunal i mjedisit do të bëjë mbikqyrje inspektive mbi menaxhimin e mbeturinave edhe atyre medicinale në këtë rast, bazuar në Nenin 62, 63, 65, dhe 66 të Ligjit për Mbeturina.

Komuna - Drejtoria përgjegjëse për shëndetësi do të siguroj dhe vendos kontejnerë për hedhjen e barnave të papërdorura dhe me afat të skaduar direkt nga qytetarët.

Prodhuesit e mbeturinave medicinale publik dhe privat gjatë aktivitetit të tyre të kujdesit shëndetsorë, do të hudhin mbeturinat e tyre në mënyrë të klasifikuar mbeturinat sipas llojeve në

kontejnerë, enë apo thasë përkatës të siguruar nga vetë ata, deri sa të grumbullohen nga operatori i licencuar që i përpunon dhe i menaxhon ato. Inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë do të siguroj zbatimin e këtij obligimi ligjor.

Operatorët publik dhe privat si prodhues të mëdhenj të mbeturinave medicinale të rrezikshme do të hartojnë planin për menaxhimin e mbeturinave medicinale dhe ekzistenca e këtij plani dhe zbatimi i tij do të kontrollohen nga inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë.

Nëse institucionet shëndetësore nuk i trajtojnë vet mbeturinat spitalore që i krijojnë, atëherë duhet të kenë kontratë me operatorët e licencuar për trajtimin e këtyre mbeturinave. Inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë do të kontrollojë nëse këto kontrata janë të lidhura dhe po zbatohen.

Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave shtazore nga thertoret:

Sipas strategjisë së mbeturinave, mbeturinat shtazore nga thertoret do të dërgohen tek qendra e grumbullimit dhe riciklimit në Korroticë të Eperme të ndërtuar nga BE. Megjithatë kjo qendër ende nuk po funksionalizohet që po na e pamundëson organizimin e kësaj skeme.

Komuna do të organizoj këtë shërbim për fazën tranzitore deri në funksionalizim të qendrës duke i dërguar këto mbeturina nga operatori i kontraktuar për të bërë varrimin e tyre të gëlqelosur dhe njëkohësisht të shikoj mundësin e angazhimit të operatorëve privat të licencuar nga AVUK që të bëjnë grumbullimin e organizuar të këtyre mbeturinave tek impijantet e tyre.

Mishtoret, therrëtoreset dhe industritë përpunuese të mishit duhet të sigurojnë kontejnerë hermetik të ndarë ku do ti hudhin mbeturinat shtazore deri në momentin e grumbullimit dhe të kenë kontrata valide me operatorin të cilat do të inspektohen nga komuna në mënyrë periodike.

Aktivitetet vetëdijësuese për ripërdorim dhe riciklim të mbeturinave:

Komuna do të organizoj fushata informative të komunikimit me publikun sa i përket ndarjes, ripërdorimit dhe riciklimit të mbeturinave komunale, dhe kategorive tjera.

Informimi do të sqaroj se si duhet të hudhen mbeturinat në kontejnerë / shporta të ndara, për dërgimin e mbeturinave në qendrën e grumbullimit dhe ripërdorimit, dhe të ngashme. Fushata do të organizohet që të targetoj institucionet shkollore për të ngritur nivelin e edukimit mjedisorë.

Tabela 37: Korniza strategjike e objektivit 3

Nr.	Aktiviteti / masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
			2022	2023	2024	2025	2026	2027
3.1	Mbulimi me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale	% e popullatës së shërbyer me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale	85 %	87 %	90 %	95 %	97 %	100 %
3.2	Plani i ri operativ për shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale	Plani operativ është hartuar / reviduar dhe miratuar	-	1				
3.3	Digjitalizimi i sistemit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave	Digjitalizimi i sistemit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave është zbatuar	-	-	1	-	-	-
3.4	Marrja përsipër e faturimit dhe arkëtimit nga komuna për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	Komuna ka marrë përsipër faturimin dhe arkëtimin	-	-		1	-	-
3.5	Zgjidhja e statusit të rasteve sociale	Pagesa e faturave për rastet sociale është zgjidhur	-	-	1	1	-	-
3.6	Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në shërbim të mbeturinave	Numri i ankesave të shqyrtuara në shërbim të mbeturinave		-	-	-	-	-

3.5 Objektiv i nr. 3: Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme të MM

Objektivi 3 ka të bëjë me komponentën e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale dhe kategorive tjera të mbeturinave nën kompetencë komunale. Ky objektivi synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve me theks të aspekteve të qëndrueshmërisë financiare dhe të kostos.

Në vijim jepen masat dhe aktivitetet kyçe të objektivës 3:

Zgjerimi i mbulimit me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Tabelat në vijim jep orarin e zgjerimit të shërbimit dhe të dhënat e popullatës janë marrë nga ASK. Komuna është e përkushtuar që të zgjerojë ofrimin e shërbimit në tërë territorin e saj. Strategjia e zgjerimit është që të ofrohet shërbim i plotë në zonën urbane si dhe mbulimi me shërbim edhe për zonën rurale.

Tabela 38: Strategjia e zgjerimit me shërbim

	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Mbulimi me shërbim	85 %	90 %	95 %	100 %	100 %	100 %

Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale

Komuna do të hartoj **planin e ri operativ** i cili do të bëjë planin e riorganizimit të shërbimit i cili do të rezultoj përmirësimin e cilësisë së shërbimit përmes

- Optimizimit të pikave të grumbullimit dhe frekuencës së ofrimit të shërbimit;
- Sigurimin e infrastrukturës adekuate për grumbullim dhe transport të mbeturinave komunale;

Komuna do të **digjitalizoj sistemin e grumbullimit të mbeturinave** i cili do të përmirësoj cilësinë dhe efikasitetin e shërbimit. Ky sistem do të ofroj informacionet për lëvizjet e kamionëve, informatat mbi lokacionin e kontejnerëve, nivelin e mbushjes dhe informatave tjera relevante si dhe i njëjti do të integrohet me databazën e kujdesit të konsumatorëve.

Komuna do të ndërmerr **kampanjë informative** për ti informuar qytetarët për mënyrën e re të grumbullimit të mbeturinave përfshi mënyrën e hudhjes së mbeturinave, frekuencën e shërbimit e të ngjashme.

Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave të vëllimshme

Komuna do të hap qendrën e grumbullimit dhe ripërdorimit të mbeturinave të vëllimshme dhe mbeturinave tjera të cilat për shkak të natyrës së tyre nuk guxojnë të hudhen në kontejnerë por të dërgohen në këto qendra.

Komuna do të zbatoj **fushatë informuese** përmes së cilës do të informoj qytetarët për këtë qendër, llojin e mbeturinave të cilat mund të dërgohen në këtë qendër, orarin e punës, etj.

Përmirësimi i efikasitetit operativ dhe të kostos

Komuna ka përcaktuar si objektiv përmirësimin e efikasitetit operativ dhe të kotos në funksion të përmirësimit të qendrueshmëris financiare. Shtyllat kryesore të këtij plani janë optimizimi i efikasitetit të stafit dhe harxhimit të naftës.

Përmirësimi i efikasitetit të stafit

Komuna duhet të planifikoj njërin apo kombinimin e aktiviteteve sa vijon për ta përmirësuar efikasitetin e stafit të ofruesve publik të shërbimeve:

- Kontrollin (ngrirjen) e regrutimit të stafit të ri administrativ dhe trajnimit të stafit ekzistues;
- Zgjerimin e zonës së shërbimeve
- Diversifikimin dhe zgjerimin e shërbimeve
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së efikasitetit të stafit

Zyrtarët e MM dhe personat tjerë të përfshirë në planifikim, monitorim dhe mbikëqyrje të menaxhimit të mbeturinave duhet të mbajnë një kontroll strikt të numrit të stafit sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 39: Efikasiteti i stafit						
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Stafi direkt	33	33	33	33	33	33
Stafi indirekt dhe administrativ	18	18	18	18	18	18
Amvisëritë (EF) e shërbyera	7447	7487-	7510	7540	7590	7610
Efikasiteti i stafit për konsumatorë të shërbyer	222.6	226.8	227.6	228.6	230	230.6

Ideja është që stafi administrativ të zvogëlohet karshi stafit direkt

Përmirësimi i efikasitetit kostos së grumbullimit dhe të harxhimit të naftës

Harxhimi i naftës është njëri ndër zërat më të lartë të kostove rrjedhëse të operatorëve të shërbimit rreth 15% të kostove rrjedhëse në nivel të sektorit dhe kjo i atribuohet në masë të konsiderueshme joefikasitetit operativ por edhe keqmenaxhimit.

Masat / aktivitetet e propozuara përfshijnë:

- **Planin e ri operativ (Riorganizmin e zonës dhe optimizimin e marshutave dhe frekuencës së grumbullimit**
- Zëvendësimi i kamionëve të vjetër me kamionë të rinj apo funksional (second-hand)
- Organizimin (infrastrukturen) e grumbullimit të ndar të mbeturinave
- Përforsimin e kontrollit të brendshëm
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së harxhimit të naftës
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së kostos njësi të grumbullimit dhe transportit

Përmirësim i performancës financiare të ofrimit të shërbimit

Komuna ka përcaktuar si objektiv përmirësimin e qendrueshmëris financiare të ofrimit të shërbimeve. Masat kryesore të përmirësimit të qendrueshmëris financiare janë:

- Kalimi i tarifave për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave mbi principet e mbulimit të kostos
- Marrja përsipër e faturimit dhe arkëtimit nga komuna
- Zgjidhja e pagesës së faturave për rastet sociale

Objektivi nr. 4: Eliminimi i deponive ilegale

Ky objektivi i referohet gjendjes aktuale në teren, ku për çdo vit evidentohet një numër i caktuar i vend hudhjeve ilegale të mbeturinave. Me qëllim të sanimit të gjendjes, komuna e Gllogocit do të angazhohet që për çdo vitë të organizoj pastrimin e këtyre lokacioneve të ndotura me mbeturina dhe vendosjen e shenjave informuese dhe ndërgjegjësuere joftuese për mos hudhjen e mbeturinave.

Tabela 40: Korniza strategjike e objektivit 4

Nr.	Aktiviteti / masa	Treguesi	Vlera bazë		Caku			
			2022	2023	2024	2025	2026	2027
4.1	Pastrimi i vend hudhjeve ilegale të mbeturinave	Pastrimi është realizuar	-	1	1	1	1	1
4.2	Fushatë informuese	Deponite ilegale reduktohen vazhdimisht	-	1	1	1	1	1
4.3	Inspektim dhe monitorim	Shqiptimi i gjobave		1	1	1	1	1

3.6 Objektivi 5: Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave

Tabela 41: Korniza strategjike e objektivit 5

Nr.	Aktiviteti / Masa	Treguesi	Vlera bazë		Caku			
			2022	2023	2024	2025	2026	2027
5.1	Miratimi i RrK të MM	RrK e MM është hartuar	-	1		-	-	-
5.2	Emërimi i zyrtarit / Formimi i njësitit	Zyrtari i MM është emëruar/Spektori është formuar	1	-	-	-	-	-
5.3	Kalimi i procesit tariforë	Tarifat e reja janë kalkuluar dhe miratuar	-	-	1	-	-	-
5.4	Kontraktimi i operatorit për grumbullim dhe transport të mbeturinave komunale	Operatori i licencuar është kontraktuar		1		-	-	-
5.5	Programi i trajnimit dhe mbështetjes së proceseve për komunën dhe operatorët	Programi zbatohet	-	-	1	-	-	-

- Hartimi dhe miratimi i planeve komunale të menaxhimit të mbeturinave

Plani i MM është i përfunduar dhe do të del për diskutim publik dhe pastaj drafti do të paraqitet për miratim asamblesë komunale për miratim sipas procedurave në fuqi. Komuna planifikon që ta miratoj planin gjatë muajit janar të vitit 2023 dhe plani ka vailiditet deri në vitin 2027, ku komuna parasheh ti nënshtrohet procesit të revdimit siq parashihet me ligj.

- Hartimi dhe miratimi i rregullores komunale për menaxhim të mbeturinave

Komuna e ka të miratuar rregulloren komunale të MM, por që të njëjtën e ka reviduar gjatë vitit 2022 për të përditësuar ndryshimet që dalin nga amendimet ligjore, dhe do të miratoj në vitin 2023.

- Emërimi i zyrtarëve komunal apo themelimi i njësitit për MM

Komuna e ka zbatuar këtë obligim me emërimin e zyrtarit komunal të MM.

- Emërimi i inspektorit mjedisorë

Komuna e ka zbatuar këtë obligim me emërimin e inspektorit mjedisorë të MM.

- Kalimi i procesit tariforë

Komuna e ka kaluar procesin tariforë dhe planifikon që ti nënshtrohet të njëjtë gjatë vitit 2024 për të reflektuar ndryshimin e kostove dhe parametrave tjerë relevant.

- **Kontraktimi i operatorit për grumbullim dhe transport të mbeturinave komunale.**

Komuna ka marrëveshje të nënshkruar me OE përkatësisht Kompanin KRM „ PASTRIMI“ për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave komunale, por nuk e përjashton edhe mundësin e angazhimit të OE të tjerë që janë të licencuar nese ky OE, nuk i plotëson nevojat për grumbullim e mbeturinave komunale.

- **Zbatimi i programit të trajnimit dhe mbështetjes së proceseve për komunën dhe operatorët**

Ky program do të dizajnohet që të i ngris kapacitetet në zbatimin e proceseve si revidimi dhe zbatimi i PKMM, amendimi i RrK të MM në ardhëmen, kalimin e procesit tariforë, draftimin dhe monitorimin e kontratave të shërbimit dhe partneriteti publiko privat, zbatimin e skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe skemës së kthimit të depozitës, ekonominë qarkore, riciklimin e mbeturinave e të ngjashme.

4 Plani i MM në kushte emergjente

Komunat duhet të bëjnë planifikimin e MM në kushte emergjente sipas kërkesave të Ligjit nr. 04/I-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, planit kombëtar të reagimit emergjent të Agjencisë për menaxhimin emergjent dhe ndonjë dokumenti tjetër relevant.

Fatkeqësitë sipas ligjit konsiderohen ngjarjet të shkaktuara nga forcat madhore të natyrës apo forcat tjera të pakontrolluara, të cilat rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve dhe pronave. Në fatkeqësi përfshihen: tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, zjarret, shpërthim i sëmundjeve infektive aksidentet që përfshijnë trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, zjarret, aksidentet ekologjike dhe industriale, lufta dhe gjendja emergjente, etj.

Ngjarja e fundit që ka kualifikuar për emergjencë apo fatkeqësi ka qenë pandemia Covid 19 dhe e cila na ka ofruar disa përvoja të dobishme.

Komuna do ta amendoj planin komunal të reagimit emergjent duke shtuar kaptinën për menaxhimin e shërbimit të mbeturinave në kushte emergjente!

5 Plani financiar, i veprimit dhe i monitorimit

Në tabelën në vijim janë paraqitur projektet kapitale që do mbështesin realizimin e objektivave të planit të financuar përmes buxhetit të komunës, bashkëfinansimit me komunat tjera apo me qeverinë si dhe projektet e financuara nga burimet e jashtme si qeveria donatorët, apo kapitali privat.

Tabela 42: Planit financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektiv 1 „Parandalimi dhe reduktimi“

Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjëse	2023	Afati i implementimit dhe buxheti	2025	2026	2027	Totali: 2023 - 2027	Burimi i finansimit
Riorganizimi i shërbimit								
o Plani i riorganizimit të shërbimit	DSHP		10,000 €	25,000 €	25,000 €		60,000 €	Komuna
o Sigurimi i infrastrukturës matëse			12,500 €				12,500 €	
Zbatimi i tarifave volumetrike			5,000 €	5,000 €			10,000 €	
o Kalimi i tarifave PAYT (procesi)			3,500 €				3,500 €	Komuna
o Përditësimi i softuerit të faturimit			10,000 €	1,000 €	1,000 €	1,000 €	13,000 €	Komuna
o Zbatimi i tarifave PAYT	KRM			X				KRM
o Fushata e vetëdijësimit dhe komunikimit me publikun			1,500 €	1,500 €	1,500 €	1,500 €	6,000 €	
Nxjerrja e pakos stimuluese për bizneset				1,500 €			1,500 €	
o Studimi i mënyrës së futjes së stimujve fiskal	DF			1,500 €			1,500 €	Komuna
o Pakoja e lehtësimeve fiskale	DF			X				Komuna
Shpërndarja e komposterëve për EF dhe restorante			1,500 €	1,500 €	1,500 €	1,500 €	6,000 €	50% komuna; 50% donacion
Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet e minimizimit		1,500 €	1,500 €	1,500 €	1,500 €	1,500 €	7,500 €	Komuna
o Fushata e vetëdijësimit		1,500 €	1,500 €	1,500 €	1,500 €	1,500 €	7,500 €	Komuna
Total objektiva 1 - Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave		3,000 €	47,500 €	40,000 €	32,000 €	7,000 €	129,500 €	

Tabela 43: Plani financiar, veprimet dhe monitorimi - Objektiv 2 „Ripërdorimi dhe riciklimi“

Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjëse	Afati i implementimit dhe buxheti					Burimi i financimit Komuna
		2023	2024	2025	2026	2027	
Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit të mbeturinave Ndarja dhe riciklimi i mbeturinave komunale			5,000 €				5,000 €
o Studim i fizibilitetit të ndarjes dhe operimit	DSHP		25,000 €				25,000 €
o Zgjerimi i mbulimit të ndarjes në burim	DSHP	2,000 €	2,000 €	3,000 €	3,000 €	2,000 €	12,000 €
o Kontraktimi i operatorit të riciklueshmeve	DSHP		5,000 €				5,000 €
o Zhvillimi i skemës lokale të kompostimit	DSHP		2,000 €	1,000 €	1,000 €	1,000 €	5,000 €
o Inspektimi i lokaleve gastronomike për vajërë	Inspektorati	x	x	x	x	x	
o Bashkimi i skemës ndërkomunal të kompostimit	DSHP		5,000 €	5,000 €			10,000 €
Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale			15,000 €				15,000 €
o Studimi i fizibilitetit	DSHP	15,000 €					15,000 €
o Ndërtimi i qendrave të grumbullimit/ripërdorimit ²⁸	DSHP			80,000 €			80,000 €
o Funkcionalizimi i qendrave	DSHP			10,000 €			15,000 €
Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtim demolimi			28,500 €				28,500 €
o Caktimi i lokacionit	DSHP						
o Kontraktimi i operatorit	DSHP		5,000 €				5,000 €
o Caktimi i tarifave	DSHP		3,500 €				3,500 €
o Rehabilitimi i qendrës së MND ²⁹	DSHP						
o Bashkimi i skemës ndërkomunale të menaxhimit	DSHP					x	
Menaxhimi i mbeturinave shtazore							
o Lehtësimi i kontraktimit të operatorit privat	DSHP	x	x				

²⁸ Për komunën e xx parashihet ndërtimi i tre pikave grumbulluese dhe një qendret të ripërdorimit. Buxheti përfshin infrastrukturën përcjellëse të qendrës si rrethoja, kamerat, bazamenti, kontejnerët, etj.

²⁹ Fizibiliteti, rrethoja, makineria dhe pajisjet e nevojshme për menaxhimin e qendrës

Hartimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturisë

o Inspektimi i zbatimit Menaxhimi i mbeturinave medicinale	Inspektorati	X	X	X	X	X
o Inspektimi i zbatimit Fushat e vetëdijësimit	Inspektorati	X	X	X	X	X
Total objektiva 2 – Riciklimi dhe ripërdorimi		17,000 €	97,000 €	100,000 €	1,000 €	4,000 €
					1,000 €	4,000 €
					5,000 €	223,000 €

Tabela 44: Plan i financiar, veprimet dhe monitorimi - Objektivi 3 „Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme“

Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjëse	2023	2024	2025	2026	2027	2023 - 2027	Burimi i financimit
Përmirësimi i cilësisë së shërbimit								
o Përditësimi i planit operativ	DSHP		6,000 €	30,000 €		6,000 €	12,000 €	Komuna
o Digitalizimi i sistemit të grumbullimit	DSHP						30,000 €	
o Furnizimi me shporta 120 l	DSHP	2,000 €	2,000 €	3,000 €	3,000 €	2,000 €	12,000 €	
o Furnizimi me shporta 240 l	DSHP	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €		20,000 €	
o Furnizimi me komposterë	DSHP	2,000 €	2,000 €	3,000 €	3,000 €	2,000 €	12,000 €	
o Furnizimi me shporta të rrugëve	DSHP		1,000 €		1,000 €	1,000 €	3,000 €	
o Furnizimi me kontejnerë 1.1 m3	DSHP		5,000 €	5,000 €		5,000 €	15,000 €	
o Furnizimi me kamionë	KRM		150,000 €	150,000 €	120,000 €		420,000 €	
o Projekte tjera kapitale për mbeturina	KRM		5,000 €	5,000 €			10,000 €	
Përmirësimi i performancës operative dhe financiare		2,500 €					2,500 €	
o Marrja përsipër e faturimit nga komuna								Komuna
o Zhvillimi i softuerit të faturimit								Komuna
o Zgjidhja e statusit për rastet sociale								Komuna
o Monitorimi i performancës			2,500 €					Komuna
o Kalkulimi dhe monitorimi i treguesit të naftës	DSHP						2,500 €	Komuna
o Kalkulimi dhe monitorimi i treguesit të arkëtimit								Komuna
o Monitorimi i treguesit të ankesave të klientëve								Komuna
o Fushata e vetëdijësimit dhe komunikimit me publikun	DSHP		2,000 €	2,000 €	2,000 €	2,000 €	8,000 €	Komuna

Hartimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave

Total objektiva 3 - Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme	11,500 €	180,500 €	203,000 €	134,000 €	18,000 €	547,000 €
--	----------	-----------	-----------	-----------	----------	-----------

Tabela 45: Plani financiar, veprimet dhe monitorimi - Objektivi 4 „Deponimi i sigurtë si mjete i fundit“

Masat dhe aktivitetet	Njësitë përgjegjëse	2023	Afati i implementimit dhe buxheti	2025	2026	2027	2023 - 2027	Burimi i financimit
Caktimi i tarifave të shërbimit të deponimit	DSHP			5,000 €			5,000 €	Komuna
Eliminimi i deponive ilegale	DSHP	13,000 €	3,000 €	3,000 €	3,000 €	3,000 €	25,000 €	Komuna
Inspektimi dhe masat detyruese	Inspektorati	x	x	x	x	x		Komuna
Total objektiva 4 – Deponimi i sigurtë si mjete i fundit		13,000 €	3,000 €	8,000 €	3,000 €	5,000 €	30,000 €	

Tabela 46: Plani financiar, veprimet dhe monitorimi - Objektivi 5 „Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për MM“

Masat dhe aktivitetet	Njësitë përgjegjëse	2023	Afati i implementimit dhe buxheti	2025	2026	2027	2023 - 2027	Burimi i financimit
Revidimi i Rrk të MM	DSHP		5,000 €				5,000 €	Komuna
Emërimi i zyrtarit / Formimi i njësitit	DSHP			3,500 €			3,500 €	Komuna
Kallimi i procesit tariforë	DSHP			5,000 €			5,000 €	Komuna
Kontraktimi i operatorit për grumbullim dhe transport të MK	DSHP	1,000 €	15,000 €	15,000 €	15,000 €	15,000 €	61,000 €	Komuna
Programi i trajnimit dhe mbështetjes së proceseve	DSHP		3,000 €				3,000 €	Komuna
Hartimi i planit të menaxhimit të shërbimit të mbeturinave në kushte emergjente si pjesë e planit të emergjencave të komunes.								
Total objektiva 5 – Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale		1,000 €	23,000 €	23,500 €	15,000 €	15,000 €	77,500 €	